



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 4 KORRIK 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 4. JULA 2013. GODINE**

**KORRIK - JUL  
2013**

### **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë,
6. Rekomandimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për procedimin e Projektligjit për transplantimin e organeve

### **Dnevni red**

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-165 o budžetu Republike Kosova za 2013. godinu,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-041 o administrativnim granicama opština,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o amnestiji,
6. Preporuka Komisije za zdravstvo, rad i socijalno staranje o procesiranju Nacrta zakona o transplantaciji organa.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar zoti kryeministër,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit të Qeverisë,  
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Fjalën e ka Zenun Pajaziti, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ZENUN PAJAZITI: Zoti kryesues,  
Të nderuar deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Zëvendëskryeministra,  
Ministra,  
Më lejoni që fillimisht të shpreh urimin për Ditën e Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sot bashkohemi të gjithë me festën e tyre.

Askush më shumë se ne në këtë regjion nuk e di më mirë vlerën e çmimit të lirisë dhe të pavarësisë. Vendi ynë do të mbajë mend përgjithmonë mbështetjen e madhe të popullit amerikan. Sot po ashtu, le të kujtojmë bashkërisht edhe të gjithë ata burra e gra amerikane që u flijuan për vendin tonë, për lirinë e popujve të shtypur në gjithë globin.

Para një jave ne patëm zhvillime jo të mira në Kuvendin e Kosovës, pati dhunë. Të shpresojmë që këto veprime të papjekura të mos përsëriten kurrë.

Shprehim keqardhje për dhunën dhe presionin e deputeteve dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës, në kryetarin e Kuvendit dhe sidomos mysafirët. Shprehim keqardhjen tonë sidomos për rastin e ambasadores Xhejkobson dhe diplomatëve e mysafirëve tjerë.

Zonja ambasadore,  
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare,  
Ju ftojme të vazhdoni dhe t'i mbështesni institucionet dhe shtetin tonë të ri. Prania juaj në hapësirat e institucioneve tona pasqyron jo vetëm kualitetin e transparencës, por edhe një siguri më të madhe për punën dhe qëndrueshmërinë e institucioneve tona.

Pavarësisht, përmirësimit jashtëzakonisht të madh të kualitetit- vetë performancës së institucioneve tona, ne ende kemi nevojë për përvojat më të mira dhe mbështetjen e BE-së, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

Të dashur kolegë deputetë të Kuvendit,  
Të dashur qytetarë të Kosovës,  
Java që po lëmë pas u shënuar me një ngjarje nga më të rëndësishmet për vendin tonë-hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, u shpërblye një angazhim i jashtëzakonshëm i popullit dhe i shtetit të Kosovës, i Qeverisë, Kuvendit, komunave, shoqërisë civile dhe shumë institucioneve kosovare. Do të jetë e shënuar kjo datë në historinë e rrugëtimit të Kosovës drejt BE-së.

Kosova tani po futet në rrugën e sigurt për një të ardhme më të sigurt, një të ardhme evropiane. Tanimë Kosova po vendos përfundimisht dialogun politik me BE-n. Në vijim do të ketë edhe më shumë punë edhe më shumë mbështetje në vazhdimin e reformave, në zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit, luftimin e krimit e të korrupsionit, Kosova nuk do të jetë tanimë vetëm në përmbylljen e obligimeve në procesin e liberalizimit të vizave.

Kjo arritje e madhe nuk do të ishte e tillë pa një frymë unike properëndimore në Kosovë, një unitet qytetar e politik, një përkushtim i gjithë shoqërisë kosovare. Ne e inkurajojmë Qeverinë dhe institucionet tjera në vazhdimin këmbëngulës të përmbushjes së obligimeve që dalin për ecjen përpara në rrugën drejt BE-së. I ftojme të gjithë spektrin politik të vazhdojë bashkëpunimin për interesat e përbashkëta të vendit tonë.

Të nderuar deputetë, me këtë rast më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, të falënderoj Parlamentin Evropian, Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, të gjithë shtetet dhe institucionet e Evropës për hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Ne shpresojmë, se do të gjejmë mbështetjen edhe më të madhe në periudhën në vazhdim. Kosova dhe populli i saj kanë nevojë të lëvizin lirshëm dhe të jenë pjesë e proceseve të rëndësishme zhvillimore të regjionit dhe të Evropës.

Ne nuk do të jemi barrë e askujt. Një gjeneratë e re e Kosovës që po zhvillohet shpejt, do të jetë vlerë e rëndësishme evropiane.

Më lejoni po ashtu t'i falënderoj presidentin e Këshillit të Evropës, Rom Pey, sekretarin e NATO-s Rasmusen, për vizitat e tyre dhe mbështetjen e treguar. Ata me vete sollën po ashtu edhe garancitë e tyre për mbështetje në proceset e rëndësishme nëpër të cilat po kalon vendi ynë.

Kosova ka nevojë për arritjen e një varg reformash dhe standardesh në rrugën drejt integritimeve në BE.

Mbetemi me shpresë që do t'i kemi afër gjithmonë miqtë dhe institucionet e rëndësishme ndërkombëtare dhe ne i sigurojmë ata që do të mbetemi të vendosur në bashkëpunimin, të vendosur në rrugën sfiduese të Kosovës drejt integritimit në BE, mbetemi të bashkuar rreth interesave vitale të vendit tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka nënkryetari i Kuvendit, zoti Glauk Konjufca, në emër të Grupit.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Më 27 qershor, Qeveria e kryeministrit Thaçi e ka vendosur Kosovën në një drejtim të qartë. Kjo është rruga e mohimit të vetëdijshëm dhe të qëllimshëm të të gjitha vlerave, sakrificave, mundit, vuajtjeve dhe përpjekjes së parreshtur kombëtare për liri nga Serbia dhe barazi mes kombeve tona.

Më 27 qershor, këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës u vendos padrejtësisht që Kosova karshi Serbisë, të përcaktohet si shtet vasal.

Ju keni vendosur për vasalitet. Mjafton t'i përmendim 4 elemente për ta argumentuar këtë marrëdhënie nënshtruese, e cila u institucionalizua me ratifikimin e Marrëveshjes mes Thaçit e Daçiqit.

Elementi i parë është emërimi në krye të Policisë së Kosovës, i njeriut që urdhrat i merr në Beograd, Nenad Gjuriqi, trupin e ka në Kosovë, por kokën e ka në Beograd.

Elementi i dytë, është karakteri serb i institucionit të veriut të Kosovës, që u sanksionua me këtë Marrëveshje. Përderisa në Prishtinë, nëse je serb mund ta dorëzosh kandidaturën tënde edhe për president madje, në veri të Kosovës nuk ke të drejtë as të kandidosh për komandant të Policisë nëse je shqiptar. Kjo ia jep Marrëveshjes një përmbajtje thellësisht antidemokratike dhe anti evropiane, sepse e kodifikon ligjërisht diskriminimin etnik në Kosovë.

Dërgojeni këtë Marrëveshje në çfarëdo gjykate evropiane të të drejtave të njeriut dhe me garanci të plotë them që ajo do të rrëzohej si diskriminuese nga aspekti i të drejtave të njeriut. Dhe, e njëjta mund të thuhet edhe për ndarje në dysh të Gjykatës së Apelit.

Elementi i tretë i vasalitetit është amnistia që po u jepet kriminelëve të cilët e kanë spastruar veriun e Kosovës nga shqiptarët, kanë ngritur barrikada dhe me forcën e dhunës e krijuan autonominë e veriut, e cila u bekua nga Qeveria e Hashim Thaçit. Me këtë ligj po shpëtohen edhe Veselinoviqi edhe miqtë e tij milionerë të politikës në Prishtinë.

Kurse, elementi i katërt i vasalitetit është caktimi i datës së zgjedhjeve tona nga Serbia. Daçiqi është ai e jo ne që e ka vendosur datën e zgjedhjeve të Republikës së Kosovës. Kur një qeveri, apo presidencë pajtohet që një shtet tjetër t'ia caktojë datën e zgjedhjeve e në këtë rast Serbia e cila është përgjegjëse për gjenocidin në Kosovë, plagët e të cilës janë ende të hapura, zonja e zotërinj, ky është dorëzim i sovranitetit.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare kjo quhet vasalitet. Këtu dinjiteti shtetëror është tretur, por kjo zaten nuk mund të ndodhte ndryshe, për sa kohë që vetë ata të cilët personalisht nuk kanë dinjitet politik e as publik, nuk mund t'ia japin shtetit një gjë që s'e kanë vetë.

Kosovës po ia kërkojnë ndryshimin e Kushtetutës dhe ligjeve, kurse Serbisë po ia kursejnë Kushtetutën dhe ligjet e saj. Kosovës po i preket territori dhe po i krijohet brenda një autonomi serbe me buxhet të ndarë, si dhe me kompetenca, duke filluar që

prej zhvillimit ekonomik e deri te drejtësia e policia, kurse shqiptarët e Luginës po i lëshojnë territoret e tyre, të shtyrë dhunshëm nga trajtimi çnjerëzor i Serbisë.

Serbisë po ia garantojnë fillimin e bisedave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, neve madje as liberalizimin e vizave dhe qarkullimin e lirë.

E si mund të thuhet pra, pas gjithë këtyre gjërave se kjo marrëveshje është evropiane dhe i kontribuon stabilitetit rajonal?

Jo vetëm që më 27 qershor u vendos vasaliteti i Qeverisë sonë ndaj Serbisë, por dëmet shkojnë shumë më larg se kaq. Më 27 qershor u vendos edhe vasaliteti i opozitës tonë në Kuvend ndaj pozitës. U bë fare e qartë se të ashtuquajturit deputetë opozitarë, kur e kritikojnë qeverinë aktuale e kanë sa për sy e faqe dhe e kanë falsitet, sepse interesat e tyre në prapavijë lidhen më fort se sa ndarjet e tyre teatrale në Kuvend dhe në televizor. Por, shyqyr që më në fund u bë e qartë se për një pjesë goxha të madhe të opozitës, qëllimi politik reduktohet në zëvendësimin e Thaçit, përbrenda të njëjtit projekt politik.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën, në emër të Grupit.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Përderisa komuna e Gjakovës ka kohë që ka ndarë pjesën e saj investuese, për ndërtimin e një parku të biznesit në këtë komunë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë edhe pse ishte pjesë e marrëveshjes të investimeve gjysmë për gjysmë, tash nuk çan kokën për këtë gjë.

Marrëveshja mes komunës së Gjakovës dhe ministres zonjës Kusari-Lila vitin e kaluar, ishte që të fillohet me ndërtimin e një parku të biznesit, ku do të investonin 50:50. Me një pompozitet mjaft të madh, vitin e kaluar zonja Kusari-Lila na kishte sjell një njoftim për hapjen e një parku të tillë, duke caktuar paraprakisht një afat prej 30 ditësh që t'i rregullojmë të gjitha procedurat.

Brenda këtij afati komuna i kishte kryer të gjitha obligimet e saja, përfshirë këtu matjet gjeodezike, ndarjen e tokës prej 15 hektarësh dhe aprovimin e këtij projekti në Asamblenë komunale. Zyrtarët e komunës së Gjakovës, tash e një kohë të gjatë kërkojnë takim me zonjën ministre Kusari-Lila, për të diskutuar lidhur me këtë çështje. Ajo në vazhdimësi u është shmangur takimeve. Ata janë të indinjuar për këtë sabotim të vetë ministres.

Unë do ta kisha pyetur se secili deputet nga secila komunë duhet ta arsyetojë votën që ka marrë, por para së gjithash të kesh edhe një ministër nga e njëjta komunë dhe ta injorojë në masë të madhe vetë komunën, kjo është e pashpjegueshme.

Komuna e Gjakovës është e shqetësuar për konkretizimin e kësaj marrëveshjeje, për ndarjen e mjeteve nga ana e kësaj Ministrie, me rishikimin e buxhetit për këtë vit. Sipas

marrëveshjes, Ministria ka për obligim të investojë në këtë objekt përcjellës edhe pasi që investimet janë paraparë të jenë, pra deri në një milion euro.

Në këtë park do të futen kompani prodhuese të cilat kanë për destinim tregun e jashtëm. Sipas ligjit, kompanitë të cilat do të futen në këtë park të biznesit do të jenë të liruara nga çdo lloj obligimi tatimor. Ligji mbi doganat thotë se të gjitha bizneset që kanë miratimin e komunës lirohen nga detyrimet doganore të importit.

Injorimi që i është bërë komunës së Gjakovës nga kjo Ministri, përkatësisht nga vetë zonja Kusari-Lila, unë sot për fat të keq nuk po e shoh këtu, prandaj do ta shfrytëzoj rastin e t'ia bëj edhe një pyetje, për t'i treguar se qytetarët e Komunës së Gjakovës presin shumë më shumë nga ajo, presin shumë më shumë nga të gjithë ministrat, por para së gjithash nga një ministre, që ka premtuar shumë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga SLS, fjalën e ka zoti Halili.

**MURSELJ HALJILJI:** Zahvaljujem, gospodine predsedavajući Skupštine!

Gospodo ministri,

Uvaženi potpredsednici Vlade,

Dame i gospodo poslanici,

Ovom prilikom želim da pokrenem jedno pitanje, koje je veoma goruče. Radi se o tome da je neminovno potrebno obezbediti još jedno prevozno sredstvo za korisnike dijelize sa teritorije opštine Dragaš.

Opšte poznata je činjenica da korisnici dijelize iz opštine Dragaš moraju da to čine ili tu uslugu da koriste u Bolničkom centru u Prizrenu. Postoji takođe i činjenica da je uvećan broj korisnika dijelize i naravno, dosta je između Dragaša i Prizreni postoji distanca koja je 80 kilometara u oba pravca.

Ja sam u razgovoru sa kompetentnim ljudima iz te oblasti video da postoji stvarna potreba za još jednim vozilom i zato molim i resornog ministra Aganija, da se malo pozabavimo sa tim pitanjem i da obezbedimo još jedno prevozno sredstvo kako bi korisnicima dijelize bilo podnošljivije. Znamo da je to veoma teška i zahtevna bolest, odnosno potreba.

U nacrtu zakona o izmeni i dopuni Zakona o budžetu za ovu godinu nešto sam posmatrao. Video sam da nisu dovoljno sredstva, koja su izdvojena za zdravstvo i u tom smislu mislim da nisu dovoljna da familjarni centar u Dragašu obezbedi sam takvo vozilo. Pa ovim putem upućujem zahtev ministru i nadležnima koji mogu da pomognu da se taj problem reši. Hvala!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Beqiri e ka fjalën.

**ISMET BEQIRI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sinqerisht, ky vend ka shqetësime më të mëdha se sa të merret, në këtë rast, “Vetëvendosja” me ne. Dhe, unë po e them me përgjegjësi të plotë se me disa veprime që

janë kah i bëjnë këta, po i bëjnë shërbim shumë më tepër Hashim Thaçit dhe PDK-së se sa e kundërta që u tha këtu.

Edhe njëherë po e them, shumë më shumë janë kah i bëjnë shërbim Hashim Thaçit dhe PDK-së, se sa ne LDK-ja e pjesa tjetër e opozitës. Nuk është mirë për t'u marrë me opozitën, po kur kërkon koordinim të veprimeve, kur kërkon gjëra, kjo nuk do të thotë që dikujt mund t'ia imponosh, por Qeveria është ajo, pozita është ajo me të cilën duhet të merret. Dhe, nuk është hera e parë, konsiderojmë që janë shumë të pasinqertë, janë shumë jo korrektë dhe thonë gjëra të pavërteta.

Dhe, historia as nuk ka filluar me "Vetëvendosjen", po as me ne, po as nuk përfundon me ta dhe me ne. Kjo është pak më e gjatë e do të jetë edhe në të ardhmen, sigurisht.

Prandaj, ju kisha sugjeruar që më shumë të merreni me veten tuaj, merrni me, sigurisht e keni edhe elektoratin. Ne i kuptojmë dëshirat, tendencat, pretendimet tuaja, janë shumë legjitime sikur që janë edhe tonat, ama bash hiç nuk qëndrojnë ato që i thoni në raport me Lidhjen Demokratike të Kosovës, sepse qysh herët është nisur ky projekt i formimit të shtetit dhe pjesë kreative dhe kryesore mund të thuhet e kësaj ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës.

Nuk është bërë shteti veç më 2008, ose atëherë është formalizuar, zotërinj të nderuar. Dhe, këtë kontribut që e ka dhënë LDK-ja, elektorati dhe qytetarët e Kosovës është kontribut i kahershëm dhe do të jetë edhe në të ardhmen. Interesat e vendit do t'i vëmë mbi interesat partiake edhe individuale. Ka shumëçka që e kemi thënë që mund të mos na pëlqejë, po më shumë që na pëlqen dhe që e dëshirojmë është shteti ynë, me ato të meta që i ka, të cilat dëshirojmë me t'ia përmirësojmë, t'ia eliminojmë. Por, jo me veprime dhe sjellje që dalin jashtë institucionit.

Ne këtë logjikë s'e kemi pranuar dhe si të tillë do të sillemi çdoherë edhe në të ardhmen. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Marinković e ka fjalën.

**GORAN MARINKOVIĆ:** Hvala gospodine predsjedavajući!

Poštovani zamenici premijera,

Poštovani ministri,

Poštovane kolege poslanici,

Godinama unazad prisutne su absurdne ideje o tome kako će neki ljudi promeniti svest, kako će se promenom svesti tih ljudi promeniti i ideje koje one zastupaju i koje će ih vratiti iz prošlosti njihovog nazadnog konzervativizma. Uzaludno iščekivanje takvih promena je da su te iste ideje postale vodilja nekih političkih opcija danas na Kosovu.

Upravo ovo govorim da bi smo shvatili situaciju kao i zlu nameru, koja se iza toga krije i koja je iskalirala 27.06.2013.godine, kada su srpski poslanici kao i ostali poslanici kao i najviši predstavnici međunarodne zajednice fizički napadnuti i to ispred zgrade Skupštine Kosova, ispred zdanja koja predstavlja najvišu instancu jedne zemlje.



Poštovani poslanici,

Postavlja se pitanje, mislim sasvim opravdano, šta su nalogodavci i akteri tih događaja ispred Skupštine Kosova hteli, koja je poruka bila i kome je bila namenjena?

Sagledavajući činjenice kao i prateći hrnološki događaje koji su se dešavali 27 kao i 28.06.2013.godine na Vidovdan, dolazimo do zaključka da su neprijatni događaji koji su se nizali jedan za drugim bili instruisani ne zbog toga što smo trebali da usvojimo Zakon o ratifikaciji sporazuma između Beograda i Prištine, već zbog proslave Vidovdana i molebana za pokoj duše za pokoj duše srpskih junaka, koji su izginuli u Kosovskoj bitci i gde se obeležavanje tog dana i na taj način čuvaju tradicionalne vrednosti srpskog naroda.

Poštovani poslanici,

Svom tradicionalnih vrednosti sobom nosi uništavanje duhovne vertikale čitavog naroda koji se generacijama gradio. Ukoliko bismo svesno ili nesvesno odbacili vrednosti na kojima počiva naše društvo, preostale bi nam dve mogućnosti:

- prvo da poteramo uništavilo i prihvatimo ostalo bilo kakvih vrednosti,
- a druga mogućnost bi bila da izgradimo potpuno nov sistem vrednosti na ruševinama starih.

Zato moramo poštovati tradiciju svih naroda na Kosovu, moramo poštovati zakone koje usvajamo ovde u visokom domu, moramo poštovati Ustav kao najveći pravni akt, koji je ova Skupština usvojila.

Poštovani poslanici,

Dali kada govorim o vladavini prava, da li se mi približavamo, da li mi kao poslanici poštujemo ono što smo u ovom visokom domu usvojili, ili smo mi upravo ti koji kršimo zakon i Ustav?

Ovom prilikom moram da naglasim da je 27 i 27.06-og u više navrata učinjena povreda Ustava Kosova i to u više članova. U članu 7, 19, 21, 24, 25, 29, i tako dalje...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Reci da si u ime grupe. Edhe dy minuta.

GORAN MARINKOVIĆ: I zato apelujem na nadležne organe da adekvatno i u skladu sa zakonom pronadu i kazne sve aktere demonstracija, kao i njihove nalogodavce koji su ugrozili bezbednost poslanika, kao i odgovorne koji su napali srpske vernike, koji su se vraćali sa proslave Vidovdana. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,

Kandidati për president mund të jetë edhe serb, po ai në Kosovë nuk mund të zgjidhet asnjëherë, derisa është kjo shumicë dominuese. Edhe Glauku mund të emërohet komandant, por kurrë komandë nuk mund të bëjë në asnjë qytet të veriut atje.

Edhe dy herë të tjera kam marrë shembull qëndrimin e Nolit ndaj Shqipërisë nga '45 deri në '65-ën. Nga viti '45 deri në '55 inspironte njerëzit për të mbështetur shtetin shqiptar deri të anëtarësohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ndërsa, pasi që u anëtarësua më '55, prapë iu kërkonte bashkëkohanikëve që ta mbështesnin shtetin shqiptar derisa të forcohet edhe ashtu si ishte, pa Zot e pa demokraci. Edhe përkundër që këto dy vlera i kishte përkushtim jetësor, edhe përkundër që shefi i shtetit, kryetari i Kuvendit dhe kryeministri nuk përkisnin fesë së tij kristiane, edhe përkundër mbështetjes që i jepte shtetit shqiptar në Amerikë, ai derisa ndërroi jetë më '65 nuk kishte vullnet ta vizitonte Shqipërinë, sepse konsideronte se ishte pa vlerat e tij të çmuara dhe inspiruese.

Pra, ishte i përgjegjshëm dhe çmonte mbi gjithçka integritetin e vendit të tij. A ka frymë noline ndërrë dhe a duhet të ketë? Te një pjesë e opozitës, po dhe te pjesa dërmuese e qytetarëve, po.

Çfarë po ndodh tani në Kosovë? Për herë të parë në ekzistencën e saj çlirohet nga okupimet e ndryshme dhe shpallet shtet i pavarur. Për herë të parë në ekzistencën e vet Kosova ka këtë përkrahje ndërkombëtare ushtarake dhe politike, duke investuar aq shumë përpjekje shtetet e ndryshme edhe para nga taksapaguesit e tyre, duke ndryshuar kaq shumë mjete tona dhe statusin e vendit tonë, sa nuk do të duhej të mungonte besimi dhe mirënjohja në këtë mbështetje, nga asnjë qytetar i përgjegjshëm i Kosovës.

Pse bëhen përpjekje nga origjina jonë, për t'ia vënë flakën Kosovës? Pse njerëzit e origjinës sonë duan ta fusin luftën civile ndërrë? Pse duan të rrënojnë institucionet e brishta të shtetit të parë, që nga ekzistenca e Kosovës? Një pjesë të përgjigjeve të këtyre pyetjeve i gjeni në fjalën time të 27 qershorit dhe një pjesë në disa fjalime të tjera në këtë Kuvend.

Nga që jam shërbyer me analiza dhe konkluzione, që në dëgjim të parë duken intuitive, por ato janë gjetur në një arkiv me eksperiencë empirike, që vërtetojnë katërçipërisht se krejt kjo gjurullti është skenar i shërbimeve inteligjente të Beogradit, për luftë speciale ndërrë, në mes nesh dhe qendrave që na kanë mbështetur për drejtësi e paqe deri tash. Që nga 16, 17, 18, 19 dhe 20 nëntori i 2004-ës, deri më 27 qershor 2013, gjithnjë të motivuara me interesa nacionale, shumë inspiruese për të gjithë njerëzit e devotshëm, por pa informacione të mjaftueshme, me motive fetare ku mund të gësh dhjetëra arsye, mijëra vetë ndërrë gatitu dhe me motive sociale, ku mund të skaliten skenarë me qindra arsye.

Por, logjika e shëndoshë dhe racionale, të tri këto motive do t'i konservojë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zelli i madh i shumë partive politike dhe i organizatave të tyre të partisë, për ta dënuar kundërshtimin që i bëri Lëvizja “Vetëvendosje” ratifikimit të Marrëveshjes, më ngjan me dënimet që dikur i bëheshin kundërrevolucionit të ashtuquajtur të demonstratave të vitit 1981, madje kujdeseshin shumë mirë që këtë kundërshtim dhe këtë dënim, që do të duhej t’i bëhej kundërrevolucionit të atëhershëm dhe të ashtuquajturve separatistëve dhe irredentistëve shqiptarë, do të duhej gjithsesi ta dëgjonte edhe Komiteti Qendror i partisë së atëhershme.

Pavarësisht dënimit politik e publik që i bëhet kundërshtimit të ratifikimit të Marrëveshjes me Serbinë, dënimi më i madh ka ardhur nga ky institucion. Dënimi më i madh për Kosovën ka ardhur nga deputetët, të cilët kanë votuar ratifikimin e Marrëveshjes me Serbinë.

Pra, ju deputetë të bindur, një ditë do të bindeni se para se ta dënoni kundërshtimin e Marrëveshjes, ju tashmë e keni dënuar Kosovën dhe të ardhmen e saj.

Ju e dënuat Lëvizjen “Vetëvendosje” publikisht dhe po vazhdoni ta bëni akoma, me gjasë edhe do të vazhdoni derisa të lodheni duke dënuar Lëvizjen “Vetëvendosje” për veprimet e kundërshtimit të ratifikimit të Marrëveshjes, por njëkohësisht ju e keni bërë tashmë dënimin dhe e keni dënuar dhe e keni dëmtuar shumë Lëvizjen “Vetëvendosje”. Ju duke e dënuar Lëvizjen “Vetëvendosje”, nuk e keni dëmtuar duke e dënuar, por Lëvizja “Vetëvendosje” ndihet shumë e dëmtuar, për shkak se ju e keni dënuar dhe keni dëmtuar interesin vital të qytetarit të Republikës së Kosovës.

Pra, dënojeni sa të doni Lëvizjen “Vetëvendosje”, por mos e dënoni më Kosovën, ashtu siç e bëtë me rastin e votimit të ratifikimit të Marrëveshjes me Serbinë.

Nga kolegët e mi deputetë opozitarë u dëgjua se ka shqetësime edhe më të mëdha, se sa ato që i ngrit Lëvizja “Vetëvendosje”. Unë them, ka shqetësime më të mëdha dhe pikërisht ai shqetësim është të cilin ne duam ta ndajmë me ju, por nuk po mund ta ndajmë me ju, për shkak se vërtet shqetësimi më i madh për qytetarët është ajo çfarë ne po e kundërshtojmë.

Atëherë, të nderuar kolegë opozitarë, bashkohuni me ne në shqetësimin e përbashkët tonin dhe as ju as ne nuk do të duhej ta ndihmonim këtë Qeveri dhe ne nuk po e ndihmojmë Qeverinë Thaçi, përkundrazi, po u thërrasim juve që ta rrëzojmë Qeverinë Thaçi.

KRYESUESI: Zonja Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,  
Të nderuar deputetë,

Ndërtimet pa leje nuk kanë të ndalur në Gjakovë. Departamenti për Urbanizëm nuk ka evidencë për ngarkesat e përfituesve pa leje ndërtimore, as gjatë këtij viti e as në vitin paraprak.

Ka pasur shumë shkelje e dallavere nga kryetari Palë Lekaj, gjatë vitit 2012. Më të theksuarat janë borxhet e painkasuara, lidhjet e kontratave pa zotim të parave, furnizim pa procedurat e prokurimit, e tjerë.

Probleme të mëdha komuna ka pasur edhe me arkëtimin e mjeteve të tatimeve dhe taksave tjera. Sipas raporteve financiare të komunës, në fund të vitit 2012 shuma e painkasuar nga këto llogari arrin shifrën rreth 4.9 milionë euro.

Të nderuar,

Këto që i përmenda janë vetëm disa shkelje në mesin e shumë parregullsive, që Auditori Gjeneral i ka paraqitur në raportin e vitit 2012 në komunën e Gjakovës. E deputetja Haxhiu, më mirë është të merret me këto parregullsi dhe ta qortojë kryetarin Lekaj e mos ta mbrojë ashtu siç bën gjithnjë, sesa të merret me premtimet e ministres Kusari-Lila, e cila atë çka premtonte gjithçka e realizon. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Dibra e ka fjalën.

**VALBONA DIBRA:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështjen të cilën dua ta ngre sot, kam planifikuar ta ngre në seancën e kaluar, mirëpo pengesa nga Lëvizja “Vetëvendosje” për të hyrë në seancë në mënyrë të rregullt, ishte e pamundur dhe na pengoi për t’i vazhduar punimet e seancës, pikat në fillim.

Dhe, tash dua ta ngre këtë çështje, ku në emrin tim personal dhe të votuesve të mi, shpreh indinjatën e thellë për vazhdimin e masës së paraburgimit edhe për dy muaj të udhëheqësve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një praktikë jo e zakonshme në drejtësi.

Është e papranueshme për neve, që sot djemtë të cilët luftuan për lirinë e Kosovës të mbahen në paraburgim, nën pretekstin se po ndikojnë tek dëshmitarët apo tentimit për arratisje, ku të gjithë ne e dimë që të gjithë ata që sot po akuzohen për krime lufte, gjithherë kanë treguar gatishmëri dhe bashkëpunim me organet e drejtësisë.

Është e vërtetë, që ne kemi kërkuar ndihmë nga EULEX-i për të hetuar krimet e luftës, të cilat janë të shumta, ku për ilustrim po i përmend vetëm disa nga masakrat që kanë ndodhur, si masakra e Likoshanit, Qirezit, Izbicës, Abrisë, Poklektut, Mejës, Reçakut, Studimes, Krushës dhe shumë masakrave të tjera, ku ende kundër askujt nuk është ngritur ndonjë akuzë për këto krime makabre, të cilat kanë ndodhur në Kosovë.

Prandaj, është e pakuptimtë që të bëhen akuza të njëanshme duke etiketuar një grup të caktuar dhe duke lënë kriminelët, që sot ende lëvizin të lirë.

Me këtë rast, më lejoni që në emrin tim dhe të elektoratit të kërkoj nga organet e drejtësisë që kjo praktikë e krijuar të ndalet sa më parë që është e mundur, në mënyrë që çlirimtarët të lirohen dhe t'u kthehen familjeve të tyre dhe detyrave të cilat ata i kanë ushtruar deri më rastin e arrestimit.

Kjo është papërgjegjësi, kjo është ofendim, kjo është e rrezikshme, sepse historinë tonë e shkruam me gjak dhe krenari dhe nuk lejojmë që kjo të njolloset për asnjë çmim, sepse lufta jonë çlirimtare ishte e pastër. Kjo pastërti është vërtetuar disa herë edhe nga Tribunali i Hagës.

Prandaj, për neve është e papranueshme, që dikush të tentojë t'i shkatërrojë vlerat tona të shenjta e ato janë - lufta jonë e pastër për liri, lufta e shenjtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Koha për deklaramë jashtë rendit të ditës përfundoi.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Për këtë seancë janë parashtruar shtatë pyetje parlamentare.

Deputetja e parë zonja Shaqiri-Berisha, pyetje për zotin Beqaj.

**AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI:** I nderuar kryesues,  
Të nderuar zëvendëskryeministra,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë,  
Pyetja ime i drejtohet ministrit të Financave, zotit Besim Beqaj.

I nderuar zoti ministër,  
Ditëve të fundit prodhuesit dhe përpunuesit e qumështit kanë kërkuar nga Qeveria, respektivisht nga Ministria e Financave që të zbresë TVSH-në zero për qumështin e freskët.

Kërkesat e tyre ata mendojnë që janë objektive dhe ligjore. Ata mendojnë që TVSH-ja po e ngritë koston e prodhimit dhe në anën tjetër kur dihet që në Kosovë ka shumë produkte të qumështit të importuara nga rajoni. Në anën tjetër, zyrtarët e Ministrisë së Financave kanë thënë se janë duke shqyrtuar mundësinë për t'u ndihmuar prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit.

Meqenëse, pyetja është bërë javën e kaluar, ndoshta është bërë diçka, ju lutem i nderuari ministër, a është bërë diçka në këtë drejtim? Dhe, cili është mendimi juaj, çfarë ka mundësi Ministria e Financave të bëjë në këtë drejtim? Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Beqaj, e keni fjalën.

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Afërdita Berisha-Shaqiri,

Sigurisht që është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme trajtimi i kapaciteteve prodhuese në Republikën e Kosovës.

Dua t'informoj qytetarët dhe deputetë e këtij Kuvendi se ne gjatë këtij viti kemi rritje të prodhimit në Republikën e Kosovës dhe kjo po shënon edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë brenda këtij viti rritje të eksporteve, falë politikave të mira qeverisëse, të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndërtuar.

Ne tani brenda këtij viti e kemi në rishikim plotësim-ndryshimin dhe realisht në përpunim ligjin për TVSH-në, i cili së shpejti do të hyjë në procedura të rregullta dhe do të shihet mundësia, se çka mund të bëhet, por dua t'ju them një çështje që është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe ajo është që kur flasim për heqjen e taksave duhet t'i kemi dy parime:

Një, taksë mund të hiqet vetëm për ata njerëz që janë të formalizuar dhe jo të punojnë në tregun e zi, nëse mund ta quaj ashtu dhe kjo çështje është diskutuar edhe me fermerët, përderisa ata do të jenë të gatshëm për të bërë orientimet e tyre që të formalizohen dhe të hyjnë në sistemin e rregullt të deklarimit të tyre, të gjithë punonjësit që janë të punësuar dhe të paguajnë taksat e rregullta, karshi shtetit të Republikës së Kosovës, ne do të shohim që të gjejmë politika të cilat do t'i favorizojmë prodhimet e tyre dhe do të jenë konkurruese në tregun e Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, kërkesë e tyre ka qenë edhe një tjetër, jo vetëm heqja e TVSH-së, ka qenë kërkesë që t'u sigurohet treg, por ju e dini që në ekonominë e tregut konkurrenca është e lirë dhe ata duhet të bëjnë shumë më shumë për cilësinë e produktit të cilin do ta bëjnë dhe për rritjen e konkurrueshmërisë së tyre.

Pra, ne e kemi në plotësim ndryshim dhe do të shohim cilat janë mundësitë, por që njëkohësisht kërkohet edhe formalizimi i tyre.

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zonja Berisha-Shaqiri. Regjia, fjalën zonjës Shaqiri!

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: I nderuara zoti ministër,

Industria përpunuese e qumështit ka në muajt e fundit sasi të madhe të qumështit, që ka reflektuar në krijimin e stokeve, ku në këtë rast ngarkohen prodhuesit dhe përpunuesit.

Çdo politikë që ju do ta ndërmerrni në përmirësimin e kësaj situatë do të ndikonte favorshëm sidomos në mbështetjen dhe përkrahjen e prodhuesve vendorë, qoftë edhe në ndryshimin e projektligjit apo forma tjera, të cilat ju i shihni të arsyeshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Beqaj, urdhëroni!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit!

Vetëm dua edhe njëherë deputetë të nderuar t'ju jap një shpjegim shtesë, se sa u përket kapaciteteve përpunuese të qumështit Kosova ka të ndërtuara kapacitete më të larta, se sa ka prodhim qumështi.

Është çështje komerciale mangësia apo le të themi faza e pranverës, e cila prodhon më shumë qumësht se sa në kushte normale, por kryesisht është problematika e harmonizimit të tyre në raportet komerciale me njëri-tjetrin. Dhe, ne nuk duam të ndërhyjmë në raportet komerciale. Shteti nuk mund të shërbejë si agjent tregtar i asnjë përpunuesi të qumështit, por ne do t'i ndërmarrim masat tona të cilat janë të parapara në bazë të mundësive buxhetore, por njëkohësisht edhe në bazë të ligjeve, por duke ruajtur parimin e konkurrencës dhe duke rritur mundësinë e tyre për të konkurruar në treg.

Por, duhet të themi edhe një çështje që cilësia është element thelbësor të cilin ata duhet ta trajtojnë dhe njëkohësisht ne do t'i trajtojmë të gjitha mundësitë që jo vetëm përmes heqjes së TVSH-së, por edhe përmes aktiviteteve tjera, sepse heqja e TVSH-së duhet të jetë përmes bazës ligjore dhe ligji duhet të merret nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetja e dytë është e zotit Krasniqi, pyetje për ministrin Ferid Agani.

HALIT KRASNIQI: Para dy javësh kam parashtruar tri pyetje dhe dy më kanë thënë se për seancën e kaluar, që është e mundur t'i lexojmë, t'i parashtrojmë dhe një për seancën tjetër. Dhe, unë i kam seleksionuar.

Për seancën e tashme e kam ndarë për ministrin e Bujqësisë, por meqenëse në seancën e kaluar nuk ka qenë ministri i Shëndetësisë, unë e lexova, por tash në mungesë të tij po detyrohem ta përsëritë edhe njëherë, sepse është një shqetësim i përditshëm dhe jashtëzakonisht i madh për trevën e madhe të disa komunave me epiqendër Malishevën, nga ethet hemorragjike, prej të cilave nga paslufta e deri më tash kanë pësuar 33 qytetarë të Kosovës dhe vetëm muajin e fundit 5, përkatësisht tash edhe fëmija i gjashtë ka rezultuar me vdekje nga ethet hemorragjike.

Dhe, ky shqetësim në cilindo meridian të botës, ku ka minimum të emancipimit, në cilindo shtet anarkik, që të ndodhte e jo në këtë shtet tonin ligjor dhe me këtë përkushtim të gjithëmbarshtëm të Qeverisë dhe të qytetarëve, për ta konsoliduar jetën e qytetarëve të Kosovës, nuk do të bëhej shqetësim sikur edhe tash që dua ta ngre dhe ta sensibilizoj opinionin. Zoti Agani gëzon respekt jashtëzakonisht në komunën e Malishevës dhe në të gjitha komunat ku është e shtrirë epidemia e etheve hemorragjike dhe kanë besim që në

përkushtimin e tij, në detyrat prioritare, imediate, do ta futin dhe do ta ketë prioritet në punën e tij të përditshme edhe zhdukjen e tyre. Duke...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Krasniqi,

Preokupimi me ethet hemorragjike në Republikën e Kosovës ka qenë preokupim nga ditët e para të mandatit. Siç e thatë edhe vetë, bëhet fjalë për një sëmundje, e cila në mënyrë endemike është duke u paraqitur nga viti në vit në katër komuna të vendit dhe Ministria e Shëndetësisë përkitazi me këtë e ka zhvilluar një aktivitet gjithëpërfshirës, duke u mundua t'u përgjigjet të gjitha obligimeve të saj ligjore në ballafaqimin me këtë problem tejet serioz shëndetësor. Bëhet fjalë për sëmundje vdekjeprurëse, e cila nuk është vetëm veçori e Republikës së Kosovës, por edhe e shteteve në rajon, edhe e Evropës dhe më gjerë.

Pra, një sëmundje tejet komplekse në natyrën e saj në mënyrën e përcjelljes dhe në mënyrën e ballafaqimit me të, duke pasur parasysh se nuk ekziston një bar kauzal, i cili do ta shkatërronte shkaktarin e sëmundjes, pra virusin e etheve hemorragjike krime-kongo.

Në këto përpjekje gjithëpërfshirëse, Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë masa në disa rrafshë. Fillimisht, jemi kyçur në nivelin ndërkombëtar me grupet e ekspertëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë të Komisionit Evropian, një Këshilli Pan-Evropian që merret me studimin e etheve hemorragjike. I kemi deleguar anëtarët tanë në këtë grup.

Si rezultat i përpjekjeve që ministria i ka bërë në vitet e kaluara, është izoluar virusi specifik që shkakton ethet hemorragjike krime-kongo në Kosovë, është emërtuar me emrin "Virusi - Kosova Hoti". Sot ky virus është subjekt i procedurave shkencore të përpjekjeve për ta gjetur vaksinën specifike me të cilën do të bëhej imunizimi kolektiv i popullatës dhe pritet nga dita në ditë rezultati pozitiv në këtë aspekt.

Përpos këtij angazhimi në rrafshin ndërkombëtar, kemi pasur angazhim sistematik të bartësit kryesor të aktiviteteve sa i përket shëndetit publik në vendin tonë, veçanërisht kur janë në pyetje sëmundjet ngjitëse, të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, i cili në mënyrë sistematike ka zhvilluar aktivitet të promovimit shëndetësor, informimin e popullatës, vetëdijesimit të rinisë shkollore dhe atë në mënyrë sistematike gjatë tërë vitit dhe duke iu falënderuar këtyre aktiviteteve ne duhet të themi se sivjet kemi pasur nga mbi 3 017 raste të pickimeve me rriqra, vetëm 17 raste me sëmundje të identifikuar, dhe, për fat të keq, prej tyre edhe 6 raste të vdekjes.



Vitin e kaluar, në rrethanat në të cilat Ministria e Shëndetësisë ka investuar më pak mjete financiare, kemi pasur 11 raste të sëmurë dhe 2 raste me vdekje. Sivjet, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë edhe buxhet të veçantë për këtë qëllim, për herë të parë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Krasniqi?

**HALIT KRASNIQI:** Zoti ministër, ju e shihni që me ta shtruar këtë temë më kapi vapa, më kapi temperatura, sepse është mjaft shqetësuese dhe mjaftë e bezdisshme. Sëmundja, krime-kongo si ju e quani, te ne është akceptuar dhe është emërtuar si “sëmundje e vdekjes”. Është hije shoqëruese e qytetarëve tanë për çdo ditë. Ju lutem, të kontaktoni me institute prestigjioze në Evropë, por edhe më larg, edhe në Amerikë që të marrim për mostër dhe t’i studiojnë dhe t’i analizojnë këto rriqra dhe këto insekte vdekjeprurëse. Prej punës dhe analizave të këtyre instituteve sigurisht që do të dalë ndonjë vlerësim, ndonjë diagnozë dhe do të përcaktohet ndonjë trajtim adekuat, gjë që ne shpresojmë se do të ndodhë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër, urdhëroni!

**MINISTRI FERID AGANI:** Zoti Krasniqi, siç e dëgjuat edhe në hyrjen e fjalës sime, mu kësaj iu adresova, sepse kjo është edhe zgjidhja përfundimtare e problemit dhe mënyra më adekuate për t’u ballafaquar me këtë problem - imunizimi kolektiv i popullatës. Ja po ju informoj tash: Sipas hulumtimeve që i kemi bërë, për momentin në vatrat endemike e kemi 10% shkallën e imunizimit kolektiv, ndërsa në tërë territorin e vendit 4% për shkallë shumë të ulët dhe këto mund të ngrihen vetëm me vaksinimin adekuat në momentin kur të gjendet vaksina.

Ta përfundoj, sivjet për herë të parë Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 160 mijë euro buxhet për mbështetjen e aktiviteteve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në këtë drejtim dhe të jeni të bindur që këto aktivitete nuk do të ndalen dhe do të jenë sistematike në vazhdimësi. I kemi siguruar gjitha barnat e nevojshme për trajtimin e kësaj sëmundjeje, edhe pse e thashë nuk ka bar kauzal, por terapi simptomatike.

Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare e Kosovës është duke bërë një përpjeke kolosale që të ballafaqohet me këtë sëmundje në mënyrën më të mirë të mundshme dhe ta them këtë se derisa në përmasa ndërkombëtare, letaliteti nga kjo sëmundje është 40 deri 50%, në Kosovë në këto 13 vjet pas luftës e kemi 24%. Pra, janë duke u bërë përpjekje të jashtëzakonshme, Ministria e Shëndetësisë po provon t’u dalë “zot” obligimeve të saj kushtetuese dhe ligjore, por po shihet se kjo përpjeke e kërkon një koordinim edhe më të lartë në nivelin qeveritar dhe për këtë qëllim e kemi iniciuar edhe themelimin e një këshilli ndërministror për parandalimin dhe luftimin e etheve hemorragjike në Republikën e Kosovës dhe unë pres që Qeveria e vendit do ta themelojë shpejt këtë këshill që t’i koordinojë aktivitetet në të ardhmen në mënyrë më efikase, besoj edhe më efektive. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Ndoshta nuk është mirë që unë të përzihem, por i kemi 10 vjet që merremi për çdo vit me ethet hemorragjike në Parlamentin e Kosovës dhe asnjëherë nuk e kemi një raport, i cili na sqaron nëse mund t'i luftojmë këto insekte, apo jo. Cila është kostoja dhe cila është mënyra e luftimit, që ta zhdukim këtë çështje nga diskutimet në shekullin XXI.

Besoj që edhe Qeveria, edhe ne si deputetë, do të miratonim çfarëdo lloj kostoje, nëse ajo i shërben shëndetit të popullit. Unë kisha pritur që edhe zoti ministër, edhe Qeveria, ta sjellin një elaborat të studiuar me koston përkatëse dhe të marrim vendim për ta bërë spërkatjen në nivel të Kosovës.

Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Agani.

**ALBANA GASHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe pyetja ime ka të bëjë me situatën që është shkaktuar kohët e fundit në Malishevë. Pra, ka të bëjë me ethet hemorragjike.

Ethet hemorragjike vazhdojnë të jenë një nga rreziqet më të mëdha me të cilat ballafaqohen qytetarët në më shumë se 35% të territorit të Republikës së Kosovës, zonë kjo që njihet si zonë endemike. Kjo sëmundje shumë e rrezikshme, me një shkallë të vdekshmërisë shumë të lartë vazhdon të jetë njëra nga sfidat më tragjike në këto zona, sidomos në territorin e komunave të Malishevës dhe Rahovecit. Në këto zona, rriqrat vitet e fundit janë shtuar në një masë të madhe, e si rrjedhojë edhe rreziku për pickime me pasojë sëmundjen dhe rrezikun me vdekje.

Pyetja për ministrin e Shëndetësisë është kjo: Zoti ministër, 5 qytetarë të Kosovës, tashmë janë bërë gjashtë, javën e kaluar e ka humbur jetën një foshnjë njëjavëshe, kanë vdekur pra nga ethet hemorragjike dhe disa tjerë janë në gjendje të rëndë akoma. Kush është përgjegjës për këtë dhe si mund të arsyetohet mungesa e produkteve bazë kundër kësaj sëmundjeje në kulmin e sezonit të rriqrave, duke e ditur përvojën nga vitet e kaluara dhe seriozitetin e kësaj sëmundjeje?

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën për t'u përgjigjur.

**MINISTRI FERID AGANI:** E nderuar, zonja deputete,

Unë ju thashë se Klinika Infektive e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës i është përgjigjur çdo rasti, i cili është paraqitur në këtë klinikë në pajtim me protokollet e trajtimit, të cilat ato i kanë pasur dhe çdo pacient e ka marrë trajtimin e nevojshëm, ashtu siç ka qenë e përcaktuar me këto protokolle të trajtimit.

Kush është përgjegjës për vdekjen e këtyre pacientëve? Përgjigjja do të ishte e njëjtë sikur të bëhej edhe në shtetet e tjera shumë më të zhvilluara, sepse kjo sëmundje nuk është veçori vetëm e Republikës së Kosovës. Thashë se është sëmundje vdekjeprurëse virusi i etheve hemorragjike krime-kongo që bartet nëpërmjet rriqrave është virus me letalitet që shkakton letalitet tejet të lartë dhe, për fat të keq, shkenca e mjekësisë ende

nuk ka arritur që ta zbulojë një bar kauzal që do ta shkatërronte këtë virus. Çdo terapi është simptomatike.

Besoj se pajtoheni me mua, rriqrat në Kosovë nuk janë problematikë themelore e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministria e Shëndetësisë nuk merret me shkatërrimin e rriqrave në Republikën e Kosovës. Është fakt se Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka ndërhyrë edhe në fushat, të cilat kanë qenë edhe jashtë kompetencave të tij dhe ka filluar të organizojë edhe dezinfektimin selektiv në zonat e caktuara. Kur është në pyetje mungesa e ilaçeve, unë them me përgjegjësi të plotë që në Klinikën Infektive në vazhdimësi ka qenë në dispozicion terapia adekuate simptomatike, e cila përdoret në këto raste dhe të gjithë ata që i kanë shfrytëzuar këto shërbime, përfshirë edhe rastet që kanë pasur përfundim letal, kanë qenë shumë falënderues për shërbimet e ofruara në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Pra, çdo rast e ka marrë trajtimin e duhur.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Gashi?

**ALBANA GASHI:** Zoti ministër, ju e keni neglizhuar gjatë tërë vitit këtë problematikë dhe e keni aktualizuar vetëm pasi e kanë humbur jetën qytetarët. Gjatë javës së kaluar, Ministria e Shëndetësisë dhe Klinika Infektive nuk ka pasur Ribavirinë, pra ilaçin kundër etheve hemorragjike dhe elementet tjera bazike. Pikërisht në rastin kur e ka humbur jetën pacienti i parafundit, pra më datën 22 qershor 2013, Klinika Infektive nuk ka pasur Ribavirinë.

Ju thatë që e keni pasur preokupim këtë çështje që nga ditët e para të mandatit tuaj. Pra, e keni pasur preokupim, kurse deri tash e kanë humbur jetën 6 persona. Merrini me mend çështjet tjera që nuk preokupoheni fare!

**KRYESUESI:** Ministër, urdhëro!

**MINISTRI FERID AGANI:** Zonja deputete, me preokupimin tonë vitin e kaluar ne kemi pasur vetëm dy raste të vdekjes, pra paskemi qenë shumë më të preokupuar vitin e kaluar se sivjet. Me këtë logjik të thjeshtë dhe bardh e zi nuk qartësohen këto gjëra.

Në Klinikën Infektive ka pasur në vazhdimësi në çdo moment preparat të Ribavirinës. E them këtë me përgjegjësi të plotë. Pacienti i parafundit ka vdekur brenda 24 orëve prej momentit kur është paraqitur në klinikën e sëmundjeve ngjitesë. Preparati i Ribavirinës mund të jepet në mënyrë parainterale, por mund të jepet edhe në mënyrë perorale, edhe nëpërmjet sondave përkatëse nazogastrike, prandaj pacientët në vazhdimësi kanë qenë në dispozicion të preparatit të Ribavirinës dhe të jeni të bindur që preokupimi i Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë më i madh se vjet. E pse vjet i kemi pasur vetëm 2 raste, e sivjet 6, këtu në këtë hapësirë e gjeni mungesën e njohurive që keni për këtë problematikë që nuk është për çudi se nuk jeni eksperte e fushës, por nuk është mirë që opinioni në asnjë mënyrë të manipulohet, ose të tentohet të dezinformohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja zonja Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeminstren Edita Tahiri. Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri ka informuar me shkrim që nuk mund të marrë pjesë në seancë, në qoftë se dëshironi ta bëni pyetjen, fjala është juaja. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Meqë kjo pyetje lidhet edhe me fushë veprimtarinë e ministrit të Drejtësisë apo zëvendëskryeministrit Kuçi, ndoshta edhe ky mund të na japë përgjigje lidhur me këtë.

Pra, përderisa në vazhdimësi e kemi dëgjuar këtë Qeveri të thotë se në negociatat me Serbinë nuk do të vihet deri te ndryshimi strukturor i sistemit të drejtësisë dhe rendit kushtetues ligjor të shtetit tonë, tash së fundi si rezultat i këtyre negociatave politike u arrit edhe Marrëveshja Thaçi-Daçiq, e cila u ratifikua fatkeqësisht në Kuvend, e përmbajtja e saj ka impakt juridiko-kushtetues. Për më tepër, kjo Qeveri ka praktikuar që t'i marrë me vete edhe drejtuesit më të lartë që e përfaqësojnë drejtësinë dhe institucionet e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës në negociatat me Serbinë.

Pyetja është se kush i detyroi përfaqësuesit e institucioneve të pavarura që të marrin pjesë në këto negociata dhe me çfarë baze ligjore, meqë kjo është shkelje flagrante e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra, me këtë akt është dhunuar një prej parimeve elementare të një shteti demokratik, e kjo është ndarja e pushtetit, si dhe marrëdhënia e llogaridhënies që kanë ato.

Pra, është jashtë çdo norme kushtetuese dhe plotësisht e paligjshme që kjo Qeveri t'i përdorë drejtuesit e institucioneve të pavarura të Kosovës në negociata me Serbinë. Madje, pjesëmarrja e tyre në procese të këtilla politike përbën jo vetëm tejkalim të autorizimeve të tyre ligjore dhe kushtetuese, por edhe një precedent tepër të rrezikshëm, për të cilin kjo Qeveri duhet të japë përgjegjësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyçi, pyetje për kryeministrin Thaçi. Kryeministri nuk është në sallë, dëshironi ta bëni pyetjen? Unë u kisha lutur, deputetë të nderuar, që të uleni dhe të mbani qetësi në sallë! Zotërinj deputetë të Lidhjes Demokratike, gjysma jeni në këmbë, në kushte normale do të duhej ndërprerë seancën. Zonja Bytyçi, e keni fjalën.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë kam dy pyetje, pyetjen e parë do t'ia parashtoj zotit kryeministër, meqenëse ai nuk është këtu, atëherë unë për hir të qytetarëve do ta parashtoj pyetjen. Vetëm kryeministri duhet të jetë më i ndërgjegjshëm, që të vijë këtu edhe t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve.

Zoti kryeministër, pronarët e pronave pyjore të zonave të Pejës, Istogut dhe Deçanit e kanë shfaqur pakënaqësinë e tyre lidhur me pamundësinë e shfrytëzimit të pronave të tyre në zonën kufitare me Republikën e Malit të Zi. Zoti kryeministër, a ka marrë ndonjë veprim Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me arritjen e ndonjë marrëveshjeje me

Republikën e Malit të Zi për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Nëse ka marrë veprime, a mund të na informoni se cilat veprime janë ndërmarrë në këtë drejtim, e nëse nuk janë marrë ende veprime, a mund të na informoni se cilat veprime planifikoni t'i ndërmerrni me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje për tejkalimin e kësaj gjendjeje? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyçi, pyetje për ministrin Agani.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër, gjatë vizitës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione në Spitalin Rajonal të Pejës është konstatuar se ka mungesë të madhe të barnave esenciale. Zoti ministër, a mund të na informoni pse ka mungesë të barnave esenciale, si për shembull të sondave për intubim në qendrën spitalore të Republikës së Kosovës? A mund të na informoni se cilat veprime do t'i merrni në evitimin e kësaj gjendjeje të rëndë që është krijuar në spitalet e Kosovës, sepse dihet mirë që mungesa e këtyre barnave mund të jetë fatale për pacientët, të cilët kanë nevojë për këtë medikament.

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit! I nderuar zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E nderuar zonja deputete,

E keni me siguri fjalën për sondat për intubim, jo për intubim. Këto nuk janë medikamente, por janë material harxhues, pra janë material shpenzues gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Janë lloje të ndryshme të këtyre sondave. Ministria e Shëndetësisë i siguron 90% të të gjitha llojeve të këtyre për nevojat e spitaleve. Është një lloj i sondave të ashtuquajtura “të armiruara”, të cilat nuk kanë qenë subjekt i kërkesave nga institucionet shëndetësore, por institucionet shëndetësore kanë buxhet të alokuar për blerjen e tyre në momentet kur ato u duhen.

Pse kemi mungesë të barnave në spitale, ose më mirë thënë pse kemi pasur në mënyrë më të theksuar muajt e kaluar, dhe po them nga dita në ditë gjendja është duke u përmirësuar në të gjitha spitalet. Do të ishte mirë të dihet edhe koha kur e keni bërë atë vizitë, më intereson kjo, por nga dita në ditë kemi përmirësim të situatës.

Pse? Për dy shkaqe themelore: shkak i parë është buxheti i cili ndahet për blerjen e barnave nga lista esenciale, pra të barnave dhe materialit harxhues. Kosova ndan për shëndetësi 2,3% të GDP-së së vetë, shtetet në rajon 5-7%, shtetet e Bashkimit Evropian 10%. Ky është një shpjegim.

Shpjegimi i dytë është: politikat jo të përpunuara dhe jo të sofistikuara mirë të planifikimit dhe të furnizimit me barna e material harxhues, të cilat i kemi reviduar në mënyrë të vazhdueshme gjatë këtij viti. Tani është bërë kategorizimi i listës esenciale të barnave dhe materialit harxhues sipas dy metodologjive ndërkombëtare, të ashtuquajtura “ven-metodologjisë” dhe “abc-metodologjisë”, të cilat i kanë marrë parasysh kriteret e

Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Dhe, sipas këtyre dy metodologjive, lista esenciale e barnave ka ardhur në vlerën prej 30 milionë euro. Ministria e Shëndetësisë disponon me 21,5 milionë euro si buxhet për barna për vitin 2013.

Edhe ky buxhet, pra edhe kjo kërkesë prej 30 milionë eurove, sa është vlera e listës totale të listës esenciale, pra të barnave dhe të materialit harxhues, është kategorizuar në tri kategori dhe atë për nivelin parësor, dytësor dhe tretësor, dhe sipas institucioneve shëndetësore. Pra, për herë të parë Ministria e Shëndetësisë është në situatë që t'i planifikojë në mënyrë të plotë nevojat e barnave vitale, ato që janë të domosdoshme dhe cilat mund të porositen nga institucionet shëndetësore. Pra, më nuk do të ketë mundësi që të kemi porosi nga institucionet shëndetësore për preparatet, të cilat nuk janë vitale, por reflektojnë interesa të tjera. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Bytyçi?

**KYMETE BYTYÇI:** Faleminderit, zoti ministër!

Ju thatë “nuk e di se kur keni qenë ju në vizitë në Spitalin Regjional të Pejës”. Sa për informim, ne kemi qenë para dy javësh dhe zoti ministër po më duket se nuk më dhatë përgjigje të saktë se nuk guxon, edhe një herë them, qysh guxon pacienti të hyjë në sallë pa këtë medikament, apo si i thoni ju këtij materiali, që kur të hyjë në operacion të mos e ketë sondën e intubulimit.

Këtë e ka cekur edhe vetë stafi i Gjinekologjisë.

**KRYESUESI:** Ministër, urdhëro!

**MINISTRI FERID AGANI:** Zonja deputete,

Si duket, nuk më keni kuptuar drejt, ose nuk më keni kuptuar plotësisht. Është e pamundur të hyhet në një intervenim kirurgjikal pa sondë për intubim, Ju thashë se Ministria e Shëndetësisë i mbulon 90% të nevojave të të gjitha institucioneve shëndetësore me këtë material harxhues. Ajo që ka ndodhur atë ditë, kur ju keni qenë, unë nuk mund të reflektojë në situatën specifike të ditës, por po ju them me përgjegjësi të plotë se çdo ditë kryhen me qindra operacione në të gjitha spitalet e përgjithshme të Kosovës, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nëpërmjet këtyre sondave dhe asnjëherë kjo nuk bëhet problem, prandaj nuk është mirë që nga një rast i izoluar të përgjithësohet situata.

Ajo që unë dua ta theksoj edhe një herë është se për herë të parë Ministria e Shëndetësisë këto ditë i ka politikat e reja të planifikimit dhe të furnizimit me barna nga lista esenciale sipas kategorizimit, i cili i pamundëson porositë adekuate nga institucionet shëndetësore dhe garanton mbulim 100% të listës esenciale në pjesën e saj vitale. Mendoj se kjo ka qenë njëra prej arritjeve më të mëdha që unë si ministër e kam bërë në këto 2 vjet e gjysmë. Rezultatet do t'i shohim në gjysmën e dytë të vitit dhe vitin që vjen, por mendoj se është bërë një lëvizje me të vërtetë cilësore në këtë aspekt.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

HALIT KRASNIQI: Zoti kryesues, faleminderit!

Para se ta bëj pyetjen, do të jua drejtoj një falënderim. Besoj që fjala juaj në mbështetje të preokupimeve të mia do t'i ngrohë qytetarët dhe do të mirëpritet jashtëzakonisht, sepse është një shqetësim i madh dhe e keni akceptuar drejt.

Ministrin Stavileci kam dashur ta kem në agjendën e ministrave që unë u kam parashtruar pyetje për arsye se kam dëgjuar nga ekspertë që përgjegjësinë kryesore duhet ta ketë edhe Ministria e Bujqësisë, dhe madje shqetësimet që janë në fushë, që janë në ara, që janë gjatë punës së fushës në zonën e rrezikshme nga epidemia e etheve hemorragjike, natyrisht që nuk mund ta amnistojnë ministrin e Bujqësisë dhe këtu duhet të jetë natyrisht i involvuar në ekipin e Qeverisë dhe besoj se ai do ta japë kontributin e tij. Në mungesë të tij, unë do t'ia parashtror një pyetje, të cilën do t'ia përcjellin bashkëpunëtorët e tij dhe besoj që ai në seancën e ardhshme do të na përgjigjet.

Cili është kontributi i ministrit të Bujqësisë në këtë ekip, për këtë shqetësim? Dhe, gjithashtu, edhe këtij i kërkojmë që ta japë një kontribut të përgjegjshëm, edhe si qytetar, edhe si ministër, por edhe si njeri që ka mundësi nëpërmjet fondeve të kontribuojë në zvogëlimin dhe në zhdukjen e kësaj epidemie të rrezikshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi!

Nuk ka tjerë të paraqitur, nuk ka pyetje tjera dhe konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës është shteruar.

Po hyjmë në pjesën e punës së pikave të miratuara nga Kryesia dhe kryetarët e grupeve parlamentare lidhur me një çështje që duhet ta votojmë. Fjalën e ka kërkuar kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për të gjithë,

Në vijim i kemi dy pika të rendit të ditës. E kemi në shqyrtim Projektligjin për rishikimin e Buxhetit të Kosovës, për të cilin kërkoj që seanca të votojë, meqenëse për një ditë nuk i përmbush afatet e parapara ligjore. Po ashtu, e kemi në lexim të parë edhe Ligjin për amnistinë, që për të njëjtën arsye propozoj që të hidhet në votim dhe të votojë seanca, për shkak të mos shkaktimit të ndonjë shkeljeje të mundshme procedurale. Faleminderit!

KRYESUESI: Domethënë, zoti Grabovci, propozimi juaj është që t'i votojmë për shmangie nga procedurat të dyja projektligjet përnjëherë, apo një nga një.

ADEM GRABOVCI: Pikërisht kërkoj që të votojmë shmangien nga Rregullorja e Kuvendit për shkak të mosplotësimit të afateve ligjore.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare për t'u shprehur lidhur me propozimin. Së pari do të kisha dëshirë që të jepet mendimi i grupeve parlamentare, a jeni që të votojmë për shmangie për të dyja ligjet përnjëherë apo veç e veç, e pastaj për mendimin tuaj? Zoti Beqiri e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Së pari po deklarohej se ne kërkojmë që veç e veç të bëhet deklarimi për shmangie për këto dy kërkesa.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Kryesues, vetëm të jua përkujtoj që për shmangie nevojiten 2/3 për të votuar. Sa u përket këtyre dy kërkesave, ne e kemi thënë që në mbledhjen e të hënës, dhe në mbledhjen e parë të së hënës, si Kryesi kemi vendosur që nuk kemi kushte për të mbajtur seancë tash këtë të enjte, prandaj edhe patëm vendosur për datën 11, e tash po dëshmohej kjo, gjë që e vë në pikëpyetje edhe mbledhjen e dytë të Kryesisë atëherë, edhe vendimin e Kryesisë. Sepse, jemi duke vendosur kështu në bazë të preferencave politike të disa grupeve parlamentare dhe të disa miqve ndërkombëtare, në mënyrë që t’i shkelim procedurat e Kuvendit.

Dhe, tash po dëshmohej se kjo kërkesë për shmangie, që të hënën nuk kemi pasur kushte për të thirrur mbledhje për sot, kështu që Lëvizja “Vetëvendosje” natyrisht që insiston që procedurat e Kuvendit të përfillen dhe këto dy ligje sot të mos diskutohen fare për shkak se nuk ka kushte për diskutimin e tyre, dhe madje-madje janë në kundërshtim të plotë me ligjet pozitive në Kosovë, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me çfarëdo ideje të rregullit institucional dhe çka është më me rëndësi janë në kundërshtim të plotë me rendin republikan, me barazinë e qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit, zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendojmë se nuk është ndonjë problem procedural që të votohen projektligjet, qoftë së bashku, qoftë veç e veç. Nëse ka pajtueshmëri që të votohen veç e veç, atëherë mendojmë se mund t’i votojmë veç e veç që të hyjnë në rend të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Selmani, kryetare e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovën e Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët,

Koalicioni për Kosovë të Re mendon që mund të bëhet shmangie nga Rregullorja për procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për buxhetin dhe Projektligjit për amnisti. Në rast se jemi të pajtimit, të shkojmë ligj për ligj, ose të dyja së bashku.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, zoti Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIČ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poslanička Grupa Samostalne liberalne stranke podržva predlog šefa poslaničke grupe PDK. Hvala!



KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, zonja Shinik.

MUFERA SINIK: Ayni şekilde “6+” Parlamentar Grubu da verilen öneriyi desteklemektedir. Teşekkür ederiz.

KRYESUESI: Zonja Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar “Zajednička Budućnost”.

BISERKA KOSTIČ: Zahvaljujem potpredsednice!

I Parlamentarna grupa “Zajednička Budućnost” saglasna je za odstupanje od procedura poslanika, i glasaćemo pojedinačno za svaki predlog. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, mendoj që meqenëse nuk ka konsensus që të votohen të dyja përnjëherë, i hedh në votim një nga një. Pra, kërkoj t’i hedhim në votim një nga një sipas propozimeve, disa ashtu, disa kështu. Meqenëse s’ka konsensus unë jam i obliguar t’i hedh në votim një nga një për t’u shqyrtuar.

Atëherë, e hedh në votim Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Edhe një herë e përsëris që për t’u shmangur nga procedurat duhen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm. Votojmë tash!

*(Ndërhyrje)*

Atëherë, më falni të nderuar deputetë, votojmë për praninë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”. Votojmë tash!

Në sallë janë të pranishëm 83 deputetë, fizikisht janë 89, por i kanë shtypur 83 veta. Kemi kuorum të mjaftueshëm, kështu që shkojmë në votim për t’u shmangur nga procedura lidhur me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, domethënë propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Votojmë tash!

Konstatoj që projektligji nuk kalon. Vazhdojmë me Projektligjin për amnistinë. Kërkoj që të votohet sipas kërkesës së grupit parlamentar, të arsyetuar për shmangie nga procedura parlamentare e rregullt për t’u votuar për shqyrtim të parë Projektligji për amnisti, si pikë e pestë e rendit të ditës për sot.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 63 vota për, 18 kundër, miratohet shmangia procedurale për Projektligjin për amnisti si pikë e pestë të rendit të ditës, kurse hiqet nga rendi i ditës Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 4/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 për të kaluar në procedurë të rregullt. Faleminderit!

Zoti Haziri e ka fjalën për rend të ditës.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër Grupit Parlamentar të LDK-së kërkoj që të hiqet nga rendi i punës edhe një projektligj, që është në shqyrtim sot, e që ka të bëjë me kufijtë komunalë, sepse Presidentja formalisht i ka dekretuar zgjedhjet. Sipas praktikave, tashmë vendimi i ministrit të sektorit u është dërguar komunave që periudhën kohore prej 6 muajsh, apo në procesin kur hyhet në proces zgjedhor nuk mund të ketë vendime që afektojnë, e prekin interesin e votuesve dhe kjo praktike sipas Konventës Ndërkombëtare për Qeverisje Lokale dhe qeverisjes së mirë e obligon Qeverinë që pas dekretimit të zgjedhjeve lokale nuk mund ta prekë interesin vital të komunave, që në këtë rast ka prek kufijtë komunalë.

Është e rrugës që, meqë këtu është Qeveria e pranishme, është zëvendëskryeministri që ta marrë këtë mocion, ta largojë ligjin dhe ta lërë që ligji të vijë pasi të kryhen zgjedhjet lokale, atëherë kur do të rishikohet funksionimi total i pushtetit lokal, kur do të analizohet e vlerësohet në tërësi nevoja e ndryshimit të kufijve komunalë dhe t'i paraqitet Kuvendit për miratim.

Kërkesë jona është që të hiqet nga rendi i ditës, sepse prek interesin e qytetarëve dhe vjen në një kohë kur tashmë ekziston dekreti i Presidentes për zgjedhje lokale. Natyrisht, që në parim, ne jemi deklaruar për komunat e reja, por procedurat nuk lejojnë më dhe kërkojnë një rishikim të funksionimit apo funksionalitetit të pushtetit lokal.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ju të gjithë e dëgjuat propozimin ose mocionin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Sipas procedurës, e kam për obligim që t'i pyes të gjitha grupet parlamentare dhe propozimin ta hedhim në votim. Lidhur me mocionin, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Ne si Grup Parlamentar kërkojmë dhe besoj se edhe për seancën është e nevojshme që të kemi sqarime shtesë nga Qeveria, përfaqësuesit e Qeverisë, ministrat, apo zëvendëskryeministrat që janë këtu se si të veprojmë më tutje, pastaj do të marrim vendim.

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, zoti ministër, është kërkesë e Grupit Parlamentar dhe është mirë që të jepni sqarime shtesë lidhur me propozim-ligjin, me qëllim që të kemi edhe ne informata sipas kërkesës. Zoti Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se poštovani predsedavajući!

Uvaženi narodni poslanici,

Poštovani ministri,

Ministarstvo Administracije lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatu, izradio je Nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-41 o administrativnim granicama opština na Kosovu.

Izmena i dopuna Nacrta zakona osnivanjem i dve nove opštine ima za cilj pružanje usluga građanima u skladu sa evropskim i međunarodnim standardima. Usvajanje ovog Nacrta zakona je veoma važno jer predstavlja pravnu osnovu funkcionisanja i organizacije ove dve nove opštine. Nacrt zakona o izmeni zakona broj 03/L-41 o administrativnim granicama, opština zadrži 10 člana, i dodatak jedan ispunjen katastarskih područja opštine Đakovica i Prizren, kao i određivanjem katastarskih područja novih opština Rogovo i Đonaj.

Sprovođenje Nacrta zakona o izmeni i dopunu Zakona br. 03/41 o administrativnim granicama opština, predviđene su budžetske implikacije iz budžeta Kosova koje su predstavljene o početnoj proceni finansijskog uticaja, izvršeno od strane Ministarstva administracije lokalne samouprave, konačne potvrde od ovog ministarstva. Važno je napomenuti da je pre početka procesa o izmeni i dopuna Zakona o administrativnim granicama, izvršen je beliki broj javnih konsultacija sa predstavnicima sela koja su obuhvaćeni izmenama, ali i sa predstavnicima opština na koje se odnose promene postojećih granica. Tokom ovih konsultacija, uzeti su i u obzir i njihovi zahtevi.

Dakle u okviru člana 5. Nacrta zakona o izmeni i dopuna zakona o administrativnim granicama je određena jedna dodatna odredba u kojoj je predviđeno da se inicijativa za izmenu administrativne granice opština može izvršiti predlogom odgovornog ministarstva i usvajanje od strane Vlade Kosova, kao i podneti pismenih zahteva od 10% građana sa pravom glasa. Dakle, Ministarstvo administracije lokalne samouprave očekuje usvajanje ovog Nacrta zakona od strane Skupštine Kosova, i spremna je da preduzme hitne mere u cilju sprovođenja dužnosti koje proizilaze iz ovog Nacrta zakona, i odmah nakon usvajanja od strane Skupštine Kosova objavljuje na svom službenom glasniku. Zahvaljujem!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Beqiri e ka kërkuar edhe një herë fjalën.

**ISMET BEQIRI:** Kjo që e thotë ministri, nuk është asgjë hiç. Ne nuk e thirrëm të na shpjegojë çfarë ka dërguar. Është fjala që të hiqet nga rendi i ditës, sepse nuk mund të jetë në rend dite, sepse është në kundërshtim me ligjin. Thuhet shumë qartë, janë shpallur zgjedhjet dhe të mos dalë dikush që 'ne jemi më shumë për të formuar komuna se këta tjerët, ose për të qenë afër qytetarëve'. Edhe ne jemi, por do ta kishim përkrahur po të mos ishin shpallur zgjedhjet. Janë shpallur zgjedhjet, prandaj mos e vini në rend dite, sepse na detyroni të marrim veprime tjera si grup parlamentar, që unë mendoj se nuk i del mirë seancës, sepse është në kundërshtim me ligjin dhe mos e futni në rend dite. Kjo është kërkesa jonë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Deklarim shtesë, zoti Grabovci.

**ADEM GRABOVCI:** Faleminderit, kryesues!

Ne si grup parlamentar vlerësojmë se aprovimi i këtyre dy ligjeve është në interes të qytetarëve të këtyre dy komunave, sepse përpjekja jonë është për t'u ofruar shërbime sa më të mira, sa më cilësore dhe për t'ua lehtësuar jetën qytetarëve të vendit tonë dhe është kërkesë e kamotshme e të dy këtyre regjioneve që të formohen këto komuna të reja dhe

është aprovuar kërkesa e tyre dhe ne nuk shohim ndonjë arsye që të dalim dhe të veprojmë kundër, të biem ndesh me vullnetin e qytetarëve të atyre dy regjioneve, që ne i vlerësojmë si regjione shumë të rëndësishme për vendin. Prandaj, ne kërkojmë që të procedohet më tutje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, kush e dëshiron fjalën? Zoti Ymeri, urdhëro!

**VISAR YMERI:** Faleminderit, kryesues!

Është shumë e qartë që edhe po qartësohet në secilin moment të kësaj seance që në fakt kjo seancë është thirrur vetëm për Ligjin për amnistinë. Për asgjë tjetër! Pra, të gjitha pikat tjera u hoqën, dhe kjo ka qenë edhe kërkesa e së hënës dhe po vazhdon edhe sot, dhe po shihet shumë qartë.

Sa i përket mocionit të Lidhjes Demokratike të Kosovës për ta hequr këtë, unë mendoj se kjo do të votohet edhe duhet të vihet në votim, domethënë vendos seanca për këtë punë, por vetëm një gjë po dua ta përsëris - atë që e kemi thënë disa herë, që në fakt këto që po duken formalisht si një lloj kundërshtimi ndërmjet partive të pozitës dhe partive të opozitës, janë në fakt sa për sa e faqe sepse pajtimi është në çështje të dëmshme për Kosovën.

Pra, këtu e pamë që ka pajtim për Ligjin për amnistinë. Këtu e kemi parë disa herë që këta nuk kanë pajtim asnjëherë për ta firmosur as komisionin hetimor për SHIK-un. Nuk kanë pasur kur gatishmëri të bëhen pjesë e një mocioni për ta rrëzuar këtë Qeveri, e tash po bëhem bashkë për ta amnistuar krimin me Ligjin për amnistinë dhe, në ndërkohë, na është shpërfaqen këso problemesh të paqena se a duhet një ligj të vijë në seancë këtë javë, apo jo.

Dhe, me cilin arsyetim, sepse ligji na qenka në kundërshtim me ligjet tjera. Po secili ligj, edhe marrëveshja që e kemi votuar këtu, kanë qenë në kundërshtim madje edhe me Kushtetutën e Kosovës. Edhe atë që do ta votoni sot është në kundërshtim me të gjitha ligjet dhe me Kushtetutën e Kosovës. Pra, këto arsye formale, në fakt, mendoj se duhet të bëhen, dhe këto grupe parlamentare duhet të bëhen të sinqerta njëherë e përgjithmonë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zoti Gjini e ka fjalën.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit,

Po më duket që Kuvendi i Kosovës duhet t’ia nisë të piqet, e jo të sillet si një kuvend që është konstituuar dje. Disa çështje duhet të merren vesh përpara, duhet të rregullohen përpara, në mënyrë që jo në seancë plenare të debatojmë për këto tema.

Nuk kam parë diku që ndodh kështu, e në anën tjetër mendoj që deputetët nuk kanë nevojë krejt kohën ta shpikin akullin. Po më duket që ka këtu deputetë që krejt kokën duan ta shpikin akullin. Nuk kemi nevojë të na tregojnë, e dimë ç’është akulli. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovën e Re, zonja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke marrë parasysh se ne në mbledhjen e Kryesisë, të mbajtur dy herë me radhë, nuk u theksua çështja e heqjes së këtij projektligji nga rendi i ditës dhe në bazë të procedurave të komisionit, Projektligji ka ardhur për seancë plenare. Unë nuk e di a është çështje fushatës, apo është çështje që duam ta realizojmë projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I poslanička grupa Samostalne liberalne stranke smatra da Zakon o administrativnim granicama opština treba da bude danas na dnevnom redu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga “Zajednička Budućnost”, Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” misli da je u interesu građana da se danas procesira Zakon o administrativnim granicama opština, i podržavamo zahtev da bude danas na dnevnom redu.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi “6+”, zoti Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa “6+” smatra da se ova tačka dnevnog reda odloži za neku narednu sednicu, jer smatramo da treba dobro proraditi o nekim nepravilnostima koje se rade u ovim odredbama od strane Vlade.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë nga grupet parlamentare. Zoti kryeministër dëshiron të japë sqarim në emër të Qeverisë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë dëshiroj të sqaroj rreth kësaj çështjeje diçka. E para, presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Jahjaga, i ka shpallur zgjedhjet më 3 nëntor, zgjedhjet lokale për komunat. Pastaj Ligji për kufijtë administrativë ka ardhur në procedura krejt të rregullta dhe në bazë të shpalljes së zgjedhjeve më 3 nëntor dhe vendimit të Presidentes, do të thotë zgjedhjet do të mbahen në komunat aktuale, por ne duhet të procedojmë për formimin e komunave të Gjonaj dhe të Rugovës, pra dy komunave të rajonit të Hasit, ndërsa në seancat e ardhshme unë pres që ne të procedojmë edhe për formimin e komunës së Zhegrës dhe Kodrës së Trimave - Vranjevcit, që është në procedurë nga Qeveria e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për sqarim shtesë, zoti Beqiri e ka kërkuar fjalën.

ISMET BEQIRI: Unë po ju them që nëse kjo hyn në rend dite, e nuk hiqet, na e lëshojmë seancën, e ju vazhdoni të formoni komuna jashtë ligjit. Urdhëroni, zoti Kryeministër, formoje edhe në Tophane një komunë, edhe këtu cirkuset tua që je duke i bërë, sinqerisht. Edhe në Burojë bëje një, edhe në Komoran bëje një. Nuk është mirë të bëhen shaka me këtë Kuvend, edhe me qytetarët, sepse ti e di fort mirë që janë gjëra që nuk janë asisoj. Shkon te Ligji për kryeqytetin, ti e di që kryeqyteti veçmas duhet të rregullohet, por po e lëmë në ndërgjegjen tuaj. Ne e lëshojmë seancën nëse nuk hiqet nga rendi i ditës, e ju vazhdoni pa ne.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kryeministër e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar zoti Beqiri!

Rendin e ditës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për sot e ka aprovuar Kryesia e Kuvendit, ku janë të përfaqësuar edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, e jo kryeministri i Kosovës. Prandaj, Kuvendi vetë le të deklarohet, e jo Qeveria.

Kjo nuk është agjendë që e ka përcaktuar dhe imponuar në asnjë rrethanë Qeveria e Kosovës. Është rendi i ditës që e ka aprovuar Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku jeni të përfaqësuar edhe ju zoti Beqiri, si kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe i nderuari zoti Sabri Hamiti, si nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Prandaj, ai vendim për këtë agjendë është vendim juaji, jo imi. Nëse ju dëshironi ta gjeni si shkas për ta braktisur seancën, urdhëroni, është vendim juaji, jeni parti në vete.

Ne jemi bashkëpunëtorë shumë të mirë. Për shtetndërtim do të vazhdojmë edhe në të ardhmen, do të punojmë bashkërisht në të gjitha agjendat ku përputhen interesat e shtetit, të rendit demokratik, të zhvillimit të demokracisë, perspektivës dhe konsolidimit të shtetit. Po ju njoftoj që ato vendime që i keni marrë vetë, vlerësoni vetë këtu në Kuvend. E ftoj edhe zotin Hamiti, edhe ju, që të jeni më transparentë me opinionin publik, që rendi i ditës është i përcaktuar nga Kryesia e Kuvendit, e jo nga Qeveria dhe unë personalisht. Prandaj, ju ftoj për mirëkuptim. Sido që të deklarohet Kuvendi, ne do ta respektojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Hamiti e do fjalën.

SABRI HAMITI: Përshëndetje për kryesuesin,

Për kryeministrin dhe kolegët deputetë,

Po ftohem të them çfarë kam thënë në Kryesi. Kryeministri ndoshta nuk është i informuar mirë, por edhe mund të mos jetë, fundi i fundit. Unë e marr një nderim, qysh do ta thoni ju, që ma përmendni emrin tri herë, pa arsyeshëm. Pse? Është e vërtetë që kam qenë në mbledhje të Kryesisë. Është e vërtetë që deri më tash, me votime në Parlament, po del se të gjitha ato që i kam shprehur në mbledhje të Kryesisë, faktikisht po i përkrah Parlamenti me votë të madhe.

Kështu që, nëse do të duhej të deklarohem këtu, atëherë po ju them menjëherë që unë në mbledhjen e Kryesisë nuk kam votuar, por kam qenë pakicë. Kaq! Kështu që jam kaq transparent, kaq konsistent që këtë edhe po e bëj për hatër të atyre që na dëgjojnë, sepse Kryeministri e di, më njeh mua që nuk kam mendime për dy orë, por kur i kam argumentet, i mbaj ato argumente, kështu që po ju them që unë qëndrim për vete nuk kam ndërruar bash për kurrgjë. Kështu, besoj që nuk kemi nevojë tutje të bisedojmë për këtë problem.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Kryeministër.

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Jo kundër-replikë, por sqarim. Është e vërtetë që unë nuk i kam lexuar procesverbalet e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit dhe nuk e di se kush çka ka deklaruar, por e di që është votuar. Aty ku votohet me shumicë, natyrisht se lëvizet përpara. Por, unë nuk jam ai i cili nxis largimin e opozitës nga Kuvendi, në asnjë rrethanë dhe me asnjë çmim.

Unë ju ftoj për mirëkuptim, edhe në kuadër të bashkëpunimit tonë që kemi në agjendat shtetërore, prandaj i lus të gjithë deputetët që për hir të agjendës së konsolidimit dhe të forcimit të shtetit tonë, të implementimit të marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve dhe implementimit të agjendës, që është e përbashkët, është e jona, për hir të bashkëpunimit të ngushtë ndërpartiak, dhe plotësimit të njëri-tjetrit në këtë agjendë dhe përgjegjësive të përbashkëta, e ftoj Kuvendin që këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjë për një ndonjë ditë tjetër, me kusht që edhe zoti Haziri, edhe zoti Beqiri,...

*(Ndërhyrje)*

Po, hiqe! Mirë de, hiqe! Ok-ej!

Unë ju ftoj edhe një herë! Ju ftoj edhe një herë, për hir të ruajtjes së unitetit të funksionimit të skenës politike kosovare, për hir të respektimit të agjendës shtetërore që e kemi të përbashkët, për hir të implementimit të agjendës dhe përgjegjësive të përbashkëta shtetërore që e kemi, për hir të thellimit të bashkëpunimit ndërpartiak që e kemi dhe unitetit politik e qytetar dhe përgjegjësive që kemi edhe para bashkësisë ndërkombëtare, të tregohet fleksibilitet në këtë drejtim, që të hiqet nga rendi i ditës, apo të hiqet, vendosni vetë ju të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Beqiri dëshiron prapë ta marrë fjalën.

**ISMET BEQIRI:** Zoti nënkryetar!

Unë kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet, edhe vendim i këtij Kuvendi duhet të jetë kjo pikë. Nuk mund të vijë më në rend dite, sepse janë shpallur zgjedhjet. Qëndrimi ynë është shumë i qartë. Qeveria e Kosovës, pas 6 muajve, kur të mbahen zgjedhjet, apo pas 4 muajve, kur të mbahen, le të formojë nëse mund edhe sa komuna normalisht me vendim të Kuvendit. Tash nuk ka mundësi ligjore që kjo të bëhet. Prandaj, ne kërkojmë që ky projektligj të tërhiqet dhe të mos silltet asnjëherë më në Kuvendin e Kosovës derisa të

kryhen zgjedhjet lokale. Nuk ka mundësi ligjore. Kjo është kërkesa jonë. Edhe një herë po e përsëris, ky është qëndrim yni ligjor dhe i drejtë.

**KRYESUESI:** Zoti Kryeministër e ka fjalën!

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** I nderuar zoti Beqiri, shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Propozimet e mia për formimin e dy komunave në rajonin e Hasit nuk kanë qenë propozime elektorale, por kanë qenë propozime për t'u shërbyer, për t'u ofruar qeverisje qytetarëve të rajonit të Hasit në bazë të vullnetit të tyre me dy komunat Gjonaj dhe Rugovë, siç do të bëjmë edhe propozimin për formimin e komunës së Zhegrës dhe besoj se zoti Haziri do të na mbështesë në këtë drejtim, edhe ju i nderuar zoti Beqiri, për komunën e Kodrës së Trimave. Prandaj, pajtohemi plotësisht. Hapësirë ligjore dhe politike ka të mjaftueshme por, pasi jeni vendosur për ta refuzuar formimin e këtyre dy komunave në Has, sido që të jetë unë përsëri pajtohemi që për hir të agjendës shtetërore që e kemi, të lëvizim deri pas zgjedhjeve dhe ta marrim këtë vendim duke nënkuptuar formimin e komunave të reja.

Asnjë problem elektoral në këtë drejtim nuk e kemi pasur, as nuk kemi pasur ndonjë ambicie elektorale. Ju e dini se edhe qytetin e Prizrenit do ta fitojmë, fort shpresojë me të parën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë mendoj që kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është e qartë. Debatimi është shteruar. Vetëm mund ta rritim tensionin në sallë. Unë besoj që është mirë ta votojmë mocionin dhe pastaj e themi rezultatin, se debati politik për këtë çështje mund të zgjasë...

*(Reagime nga salla)*

Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është që të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë dhe të shtyhet deri pas zgjedhjeve. Mirëpo, ne si Parlament realisht nuk mund t'ia diktojmë agjendën Qeverisë, por vendimin sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike unë e hedh në votim.

*(Reagime nga salla)*

Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

**KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:** Qeveria e Kosovës ka të drejtë ta largojë apo ta heqë çdo projektligj në çdo rrethanë dhe në çdo fazë. Prandaj, ne e tërheqim për këtë periudhë kohore deri pas zgjedhjeve lokale.

**KRYESUESI:** Faleminderit, zori Kryeministër!

Mendoj që tani vendimi i Qeverisë është shumë më fleksibil dhe i qëlluar mendoj.



Konstatohet që Qeveria e ka tërhequr Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave dhe vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë**

Projektligji për amnistinë, i hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është proceduar në Kuvendin e Kosovës më 27 qershor 2013 dhe të njëjtën ditë u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit.

Komisioni për Legjislacion e ka mbajtur një mbledhjen më 1 korrik 2013 e dhe e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDINI KUÇI:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush ta prezantoj Projektligjin për amnisti, por njëkohësisht besoj që sot do ta kemi një debat të hapur dhe besoj që është kënaqësi që Kuvendi i Kosovës e ka një kompetencë të tillë që sot të diskutojmë për çështjen e amnistisë, që nuk e ka pasur asnjëherë deri më tani në kompetencë të veten.

Po ashtu, jam i bindur që njerëzit e zgjedhur të këtij populli e kanë kompetencën e tillë për të vendosur për këtë institut juridik, për shkallën, për gamën, për fuqinë dhe për të gjitha të tjerat, që mendojmë që duhet të amnistohen.

Shkalla e amnistisë dhe gamës është çështje që vendoset nga ju, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ky projektligj po diskutohet për herë të parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe është e pritshme që të ketë pasur debate të tilla çfarë kanë ndodhur edhe në vendet e tjera, çfarë mund të ndodhë edhe sot në Kosovë dhe diku tjetër.

Çështja e amnistisë është shumë komplekse dhe e ka një këndvështrim që bart interesat e ndryshme në momentet e caktuara politike, sociale, teknike, juridike, e kështu me radhë.

Dhe, unë kam qenë i vetëdijshëm që nga koha kur e kam propozuar çështjen e amnistisë, në vitin 2011, që të hyjë si institut juridik në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që do të ketë edhe debate të tilla. Po ashtu, jam i vetëdijshëm që çështja e amnistisë ka filluar të diskutohet edhe para se unë të jem ministër, që të hyjë në ligjet tona dhe në Kushtetutë, por për arsye të ndryshme dhe, unë mendoj objektive, kjo nuk ka ndodhur më parë.

Që nga marrja e mandatit tim si ministër i drejtësisë kam premtuar që do ta bëjmë plotësimin e arkitekturës së drejtësisë, pra që të kemi ligje dhe institucione të drejtësisë, si çdo vend tjetër demokratik sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Në vazhden e shumë punëve që i kemi bërë, në reformimin e drejtësisë që nga viti 2011 e tutje, ne kemi proceduar edhe çështje të amnitisë, si institucion i veçantë dhe një institut, i cili tanimë në Kushtetutën tonë ka kaluar me sukses, pas pëlqimit tonë në Gjykatën Kushtetuese, dhe më lejoni i që të ju falënderoj, deputetë të nderuar të Kuvendit, që ajo kohë që keni votuar për një institut të tillë juridik. Ka qenë propozim i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe i mbështetur edhe nga ju, që kjo të miratohet me 2/3 në Kuvendin e Kosovës, për dallim prej shumë vendeve të tjera, të cilat e miratojnë këtë ligj me 51%, dhe kjo besoj se është e mirë edhe për sot, por edhe për të ardhmen, dhe askush nuk mund që të bëjë amnisti në këtë vend pa e ndërtuar në konsensus të gjerë politik. Kjo është e mira që nuk duhet t'i trembë qytetarët e këtij vendi, kjo është e mira që nuk duhet t'i trembë deputetët e këtij vendi, as subjektet politike, as shoqërinë civile, dhe kjo është e mira që këtu, edhe në të ardhmen në këtë vend, kjo çështje do të kërkojë konsensus të gjerë politik.

Më lejoni shkurtimisht të them se si kemi ardhur deri këtu. Pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese në Kuvendin e Kosovës, e kemi themeluar grupin punues për çështjet e amnitisë, ku janë konsultuar aktorët relevantë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë Këshillin Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit, ekspertë nga Fakulteti Juridik, të Ambasadës amerikane, të EULEX-it, të Zyrës BE dhe ekspertë e tjerë të fushave, e tanimë e kemi prezantuar një projekt në pajtueshmëri me gjithë të përmendurit.

Ky projektligj, nëse më lejohej ta them, ta jap esencën e tij, i ka dy pjesë kryesore, pjesën që lidhet me nenin 3, që është objekt diskutimi, por edhe pjesa që është me nenin 5, që ka qenë objekt negociimi me faktorin ndërkombëtar. Kam tentuar t'i reflektoj disa parime në këtë projektligj. Parimi i parë, që është thelbi i një demokracie të vendeve ku dominon ligji apo sundon ligji, është barazia para ligjit, dhe ky projektligj përmban atë që nuk e përmend asnjë pjesë të territorit të vendit tonë, apo një etnicitet të caktuar, për dallim prej shumë vendeve të tjera.

Ne i kemi marrë ligjet e rajonit. Nëse e merrni ligjin për amnisti që e ka bërë edhe Maqedonia, në raport me shqiptarët atje, edhe Serbia, por edhe Kroacia, ju e shihni që atje përmendet territori i caktuar dhe etniciteti i caktuar. Po ashtu, kemi qenë të kujdesshëm që të mos përfshihet kjo amnisti vetëm në balancën etnike, vetëm me serbët, apo vetëm me veriun, apo vetëm me shqiptarët, dhe këtu është dallimi ndërmjet nenit 3 dhe 5, që unë i shoh disa e mbështetin nenin 3, disa nenin 5, por ajo çka mund të them, më duket se ka një konsensus të gjerë për nenin 5, e kjo mua më gëzon.

Habitem me reagimet e disa ekspertëve, në veçanti kur ata mendojnë se etnicitetet tona duhet t'i trajtojmë ndryshe. Ajo çka duhet ta them si ministër i Drejtësisë nuk kam mundur t'ia lejoj vetes që të propozoj për herë të parë në Republikën e Kosovës Ligjin për amnistinë, që do t'i takonte vetëm veriut të Kosovës, apo vetëm serbëve, sikur që nuk

do ta propozoja në asnjë rast vetëm për shqiptarët. Por, po ashtu dua ta them, deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në ditën kur e keni propozuar, e keni miratuar amendamentimin e Kushtetutës për amnisti, duhet ta pranoni një fakt. Kemi menduar t'i amnistojmë ata që e kanë shkelur ligjin, jo burrat e mirë. Do të thotë, kështu duhet ta kemi ndër dije gjithmonë kur është menduar për amnisti, është menduar për këta njerëz.

Në anën tjetër, ky projektligj nuk ka përfshirë asnjë pjesë, e cila ka të bëjë me lëndime dhe vrasje. Ka pasur dilema për këtë qëllim, por duket se i kemi hequr. Ajo çka dua ta them, është paraparë një amnisti e pjesshme për veprat që nuk janë të rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe vetëm 20%, sikur e ka bërë edhe Sllovenia, që ka dikush ta marrë një shembull në mendje, dhe po ashtu edhe shtetet e tjera. Në këto raste tregohet mëshira e shtetit, e sovranit, dhe në këtë rast ju jeni përfaqësues të sovranit për ta treguar një çështje të tillë.

Dhe, kjo po ashtu ka rëndësi për mua, me të drejtat e të burgosurit që gjenden sot dhe dua ta them se nuk ka parti politike në këtë vend që nuk u ka premtuar amnisti të burgosurve, në cilindo fazë, që nga viti 99 e deri me sot. Bile edhe sot e kësaj dite ka njerëz që të kontaktojnë dhe ju japin premtime të tilla. Për mua, jam shumë i interesuar që të burgosurit t'i kenë të drejtat e plota, por ta respektojnë edhe ligjin. Për mua është shumë me rëndësi dhe për vendin tonë të risocializohen ata dhe të kthehen në shoqëri, por po ashtu mos harroni që kanë ndikim edhe në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

E, po ashtu, një rëndësi shumë më të madhe për mua dhe për ju, deputetë të nderuar, kanë viktimat e dëmtuara dhe në mendjen time asnjëherë nuk kam menduar që t'i lëndoj ata të cilët janë dëmtuar, përkundrazi kam ruajtur balancën dhe kam theksuar edhe në këtë projektligj, amnistia nuk i prek dhe nuk i lëndon palët e treta. Nëse ne duhet ta shohim se jemi shtet i konsoliduar dhe themi se veprat e rënda penale, që kanë të bëjnë me jetën dhe trupin, nuk janë objekt i amnistisë, dhe e lexojmë shumë qartë, këtu nuk përfshihet asnjë vrasje apo lëndim trupor për personat zyrtarë, apo për personat që ka pasur zëra të ndryshme të zyrtarëve politikë, që ka mundur të ndodhë pas luftë. Po ashtu, nuk përfshihet në asnjë rast as vrasja e Enver Zymberit, as e Selver Haradinajt, as nuk përfshihen rastet e tjerë të cilët kanë ikur nga drejtësia dhe nuk janë përgjigjur, përkundrazi thuhet se nuk jepet amnisti.

Më mbetet shumë merak që si ministër i Drejtësisë nuk kam mundur ta mbyll kapitullin e luftës dhe unë besoj se këtu duhet të ndihemi keq të gjithë. Nuk kemi pakt me kriminelët. Pas luftës nuk e kemi asnjë mëshirë në kuptimin personal me askënd dhe nuk kemi identifikuar individë të caktuar, subjekte politike apo diçka tjetër, përkundrazi kemi menduar ta tregojmë humanitetin tonë përballë qytetarëve, dhe nëse më pyetni mua, do ta bëja një amnisti 10% për të gjithë ata të cilët janë në vuajtje të dënimit, jo me emra dhe mbiemra, por ashtu ta themi nuk mund të bëjmë përjashtime për individë dhe vepra të caktuara.

Por, tek e fundit, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, ky projektligj që lidhet deri më datën 20 qershor të këtij viti, i ka dy gjëra pozitive. E ka të parën ata që kërkojnë

amnisti. Jo nuk e kam fjalën për pjesën jashtë veriut. Është hera e parë pas 14 vjetëve që kërkojnë amnisti dhe pse? Se po ndihet që dora e shtetit të Kosovës do të mbërrijë atje, por ndihet që Kushtetuta do të shkojë atje që gjyqtarët dhe prokurorët tanë do të jenë atje dhe do të fillojnë të bëhen hetimet e veprimet për ato vepra që i kanë bërë.

Por, po ashtu dua ta them - jam habitur edhe me rastin tjetër kur thuhet se nuk duhet të bëhet amnistia nga ndjekja penale. Ju e dini, të nderuar deputetë, sidomos ata që janë juristë, që amnistia në rastet e paskonflikteve ndikon drejtpërdrejt në pajtimet shoqërore dhe ndjekja penale është një prej atyre çështjeve, por jo për të gjitha veprat. Mos harroni se vendet e ndryshme, edhe Mbretëria e Bashkuar, kanë bërë veprime të tilla.

Por, çka mund të themi se mund të bëj unë personalisht? Neni 3, të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës, është i diskutueshëm, është i debatueshëm. Nenin 3 edhe mund ta hiqni sot, po e them në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Asnjë dhimbje për asnjë nen që është në nenin 3 nuk e kemi. Vetëm ta mendojmë ndjenjën humaniste ndaj qytetarëve tjerë.

Por, sikur unë ta kisha sjellë vetëm nenin 5 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e nderuara deputete Lama do të kishe thënë pse ke bërë vetëm për veriun? Unë e kam bërë një balancë politike, balancë etnike. Urdhëroni, veprimet më tutje. Cilindo vendim që e merr Kuvendi i Republikës së Kosovës, ne do ta respektojmë në tërësi. Neni 5 është i panegociushëm.

Nëse më lejohet zoti nënkryetar, të vazhdoj 2-3 minuta.

Pavarësisht fitimit që mund ta kenë njerëzit nga amnistia e caktuar, kemi qenë të kujdesshëm që pasuria e konfiskuar si rezultat i veprës penale të mos kthehet. Do të thotë, ata persona nuk kthehen. Nuk ka amnisti për veprat penale që lidhen me korrupsionin. Nuk ka amnisti për ata që kanë të bëjnë me trafikimin me qenie njerëzore apo tjetër dhe nuk ka për ata që kanë të bëjnë me vjedhjen e votave dhe nuk i gjeni këtu.

Nuk do të ketë amnisti në asnjë mënyrë me identifikime, qoftë politike, partiake...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Regjia, vazhdojani ministrit.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDINI KUÇI:** ...por ligji duhet t'i shohë të gjithë qytetarët në pozita të njëjta. Më lejoni të them që ne kemi menduar të bëjmë amnisti deri në 3 muaj për të gjithë qytetarët, edhe ata që janë në ndjekje penale, edhe ata që janë në vuajtje të dënimit. Këtë e ka bërë edhe Mali i Zi. Merreni ligjin!

Në anën tjetër, kemi menduar 50% për ata deri në 6 muaj. Të dyja palët, individët e caktuar, janë për vepra të rrezikshmërisë së ulët shoqërore. Kemi menduar për personat mbi 65 vet në moshë, e unë e them që nuk e di se në burgjet e Kosovës nëse është dikush që me këtë moshë apo jo. Por, është një mendim human, që shumë shtete në botë e

aplikojnë. Nuk është ky ligj i shpikur nga unë, apo nga ekspertët që e kemi punuar, por një ligj i krahasueshëm me vendet e tjera.

Po ashtu, duhet të them që ky projektligj parasheh edhe procedurat e qarta të amnistisë, duke përfshirë edhe obligimet të cilat i ka secili veç e veç. Më lejoni të jap disa përgjigje për shqetësimet që janë ngritur edhe nga partitë politike, edhe nga shoqëria civile, edhe nga disa ekspertë, po them ekspertë - po e zgjas pak, se habitem, se unë them njeriu mund të jetë zanatli i një pune, por tri gjëra nuk duhet t'i bëjë kur: nuk duhet kurrë ta dëmtojë shtetin, nuk duhet ta dëmtojë kurrë dinjitetin edhe familjar e s' duhet ta dëmtojë zanatin që e bën. Ata që janë ekspertë nuk flasin që ta dëmtojnë ekspertizën e tyre në dobi të ndonjë politike ditore.

Kam hasur dhe është thënë që ky projektligj do të vijë para se të vijë drafti për etnicitete dhe territor. Në asnjë vend nuk lexohet në këtë projektligj që thuhet, territori i kësaj komune ose për këta shqiptarë ose këta serbë do të jetë ndryshe.

Kam hasur reagime që amnistohen vrasësit e Enver Zymberit dhe çështjeve të tjera. Dhe e keni parë që në asnjë vend nuk amnistohen, as huliganizmi sportiv që ka rezultuar me lëndime trupore dhe me vrasje nuk amnistohet.

Kam hasur reagime që amnistohen vrasësit që mund të jenë pas lufte dhe e shihni këtu që nuk ka ndodhur në asnjë rast, përkundrazi.

Dhe kam hasur në reagime po ashtu që thuhet që individë ose njerëz të caktuar në emër të kësaj, në emër të ligjit ka vepra dhe është menduar në zyrtarë.

Ua jap fjalën e nderit dhe besoj të gjithë e dini, asnjë njeriu s'ia kam parë fotografinë e tij kush ka qenë dhe kush duhet të përfshihet në këtë ligj.

Hiqeni krejt ligjin nëse mendoni, aplauz do t'ju rrah. Shtini edhe 50 vepra, aplauz do t'ju bëjmë ne si Qeveri. Mos u bëni merak ju se ne kemi ndonjë pakt me dikë, apo në forma tjera.

Po nëse e lexoni përmbajtjen e ligjit ju do të shihni kush fiton më shumë, ata që kanë bërë rezistencë ndaj rendit kushtetues juridik fitojnë më shumë se sa të tjerët.

Ne po ashtu duhet ta pranojmë një fakt që ka pasur dhe kam hasur në lexime të gabuara të nenit 5. Neni 5 lidhet në tërësi me dy nenet tjera. Asnjë vepër nga neni 5, lidhet po them me nenin 411 që ka të bëjë me rezistencën e armatosur dhe neni 121 që ka të bëjë me rendin kushtetues. Do të thotë, duhet të lidhen edhe ajo amnisti fiskale që mendon edhe dikush tjetër.

Neni 5 ka qenë i negociueshëm edhe me partnerët ndërkombëtarë edhe me negociatat në Bruksel.

Neni 3 është çështje krejt tjetër, po e përsëris. Natyrisht unë kam parë që u bë debat. E kam vërejtur që Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrah nenin 5, më shumë ka dilema për nenin 3. Edhe unë pajtohem që ta debatojmë, të heqim, çkado që donë. Dhe do të marrë pjesë edhe në Komision apo edhe nëse nuk më thirrni do të pajtohem paraprakisht, po them, në emër të Qeverisë.

E kam hasur që dilemë të tillë ka edhe Partia Demokratike e Kosovës. Edhe sot ma kanë thënë deputetët në Grupin Parlamentar dhe e kam marrë me shumë seriozitet. Dhe unë i falënderoj për mbështetjen. Më keni lehtësuar, po them, shumë të drejtën, ju ftoj që bashkërisht të punoni në komisione, hiqeni nenin 3, bini zero-zero, ne do të pajtohemi.

Po ashtu dua të them një fakt. E kam vërejtur që Lëvizja "Vetëvendosje" ka telashe me nenin 5. Neni 5 është normale, unë e kuptoj Lëvizjen "Vetëvendosje" se është rrjedhojë e asaj që ka ardhur nga bisedimet. Dhe nëse një pasojë nga bisedimet është edhe kjo, këtë e kundërshtojnë, është logjikë politike, po s'kanë logjikë juridike.

Ju kam thënë edhe për Marrëveshjen, keni arsye politike ta kundërshtoni, por jo për arsye juridike. Dhe arsyeja e asaj që flasim, po dëgjoj, jo është shkelur Kushtetuta. Veç një organ në këtë vend tregon ku është shkelur Kushtetuta, vetëm Gjykata Kushtetuese. Mos i jepni vetes të drejtë të thoni çdo ditë, ky e ka shkelur, ky e ka shkelur. Për atë që dyshoni, i keni votat, nënshkrimet çoni në Gjykatë Kushtetuese, ata ju tregojnë a është shkelur apo jo. Nëse thuhet që është shkelur, hiqet ligji, s'ka kurrgjë të keqe. Ne krejt çka po bëjmë, po bëjmë një veprim që ta bëjmë përmes ligjit.

Dhe krejt në fund, më lejoni të them që kam takuar edhe familjarë të burgosurve, dje. Dhe kam hasur në dy qasje të tyre dhe kam takuar, po ashtu, edhe ndërkombëtarë, në ndërkohë, edhe dje edhe ditëve tjera. Personat e njëjtë që kontaktojnë në telefon me të burgosur, që u thonë që ministri u ka dhënë pak të drejta, po kontaktojnë me ndërkombëtarë dhe po u them që ministri ka dhënë shumë të drejta.

Vendosni të nderuar deputetë të Kuvendit për aq të drejta sa të doni ju, por unë mendoj se humanizmi edhe ndaj atyre që kanë bërë krim duhet të jetë në shkallë e caktuar. Nuk ka menduar kush amnisti 100%. Absolutisht, shikoni përqindjen, mateni vlerat dhe krejt.

Po e them edhe një fjali, me këtë ligj që është prezantuar momentalisht, ku do të përfitojnë më pak qytetarë të dënuar se sa kanë përfituar, vetëm në një rast nga faljet e presidentëve paraprakë.

Mbani mend çka po ju them. Do të përfitojnë më pak se sa, vetëm një rast. Hiç pjesën që ka të bëjë me rendin kushtetues, me veriun, por pjesën tjetër nuk përfitohen.

Edhe një punë dua ta them që Ligji për amnisti, unë jam shumë i lumtur që ka hyrë si institut juridik në Kushtetutë. E di edhe një fakt, kushdo që do të bëhet ministër i Drejtësisë, ndoshta çdo vit jo, por s'do t'i kalojë mandati pa e bërë nga një ligj për amnisti dhe amnistinë mos e shihni si rezultat i asaj që njerëzit kanë bërë veprime, por si rezultat i asaj të humanitetit. Ju e dini që historikisht edhe mbretërit edhe monarkët, edhe

dikush tjetër, ka dhënë ngapak falje, ka bë ngapak amnisti, kështu që s'bëhet kiameti nëse veproni ndryshe.

Por, vendimin tuaj e respektoj. Nuk insistoј në asnjë nen, në asnjë pikë që ta mbani në ligj. Përkundrazi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka nënkryetari i Komisionit Funkcional për Legjislacion, zoti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, në mbledhjen e 1 korrikut të këtij viti, ka shqyrtuar Projektligjin për amnisti dhe ka diskutuar në parim për projektligjin dhe rekomandon që projektligji të aprovohet në parim, i bindur se do të amendamentohet me dispozita të caktuara, të cilat ligjin do ta bëjnë akoma më të pranueshëm deri në fund të miratimit të tij përfundimtar.

Një minutë personalisht mendoј se ne duhet ta amendamentojmë projektligjin me qëllimin më të mirë që disa amendamente të diferencojnë akoma më mirë strukturat ilegale të cilat trajtohen në një mënyrë politikisht, sepse akti ka edhe karakterin politik, të diferencohen nga strukturat kriminale, aq sa është e mundur përmes amendamentimit.

Unë e kam të qartë se në veri është bukur vështirë që të diferencohen strukturat ilegale nga strukturat kriminale për arsyen e thjeshtë se kanë bashkëjetuar kohë të gjatë dhe janë ndihmuar reciprokisht, megjithatë unë e konsideroj që është e mundshme që të bëhet ky diferencim.

Dhe, çështja e dytë, mendoј se ky akt nuk ka diskutim, është edhe i karakterit politik dhe është detyrim nga marrëveshja dhe marrëveshja nënkupton procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë. Këtij procesi të normalizimit nuk i kishte bërë dëm nëse bashkësia ndërkombëtare kishte për të insistuar nga pala serbe që edhe ajo të bëjë një lloј amnistie për shumë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët i ndjek përmes Interpolit, e shumica prej të cilëve nuk kanë akuza konkrete, vetëm se janë në lista të Interpolit. Prandaj këtij procesi të normalizimit kishte për t'i ndihmuar edhe një lloј reciprociteti në amnistinë e ushtarëve të cilët janë në lista të Interpolit me kërkesën e Serbisë.

Pra, në parim do ta votoј edhe personalisht dhe jam i gatshëm që të marr pjesë në amendamentimin, me qëllimin më të mirë që të bëhet ligj akoma më i pranueshëm për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka zoti Halit Krasniqi.

**HALIT KRASNIQI:** Faleminderit, kryesues!

Në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike është debatuar jashtëzakonisht shumë dhe kemi ballafaquar mendimet edhe me ministrin e Drejtësisë, përkatësisht zëvendëskryeministrin. Ka pasur ide, propozime dhe qëndrime të ndryshme dhe ide insistuese që të bëhen ndryshime në këtë projektligj. Janë propozuar edhe ndryshime të caktuara, pjesë të projektligjit të cilat janë arsyetuar nga një numër i madh deputetësh në Grupin Parlamentar dhe në fund të debatit, sikur edhe në shumë debate të tjera për projektligje të mëparshme që kemi debatuar jashtëzakonisht gjatë, edhe në këtë kemi nxjerr një konkluzion që në parim ta votojmë sot dhe deri në leximin e dytë, anëtarët e Komisionit për Legjislacion, përkatësisht pjesëtarët e Partisë Demokratike që janë në këtë Komision, në bashkëpunim me kolegët tjerë aty, të bëjnë amendamentimin e ndryshimeve që e shohin të arsyeshme.

Natyrisht në këto qëndrime të ndryshme nga projektligji i kemi shfaqur edhe në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion. Dhe natyrisht që do të përpiqemi t'i arsyetojmë dhe t'i amendantojmë ndryshimet e reflektuara gjatë debatit në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike dhe trajtimeve që i kemi bërë në Komisionin e Ligjeve, kështu që Grupi Parlamentar në parim e aprovon, me rekomandimin që ndryshimet të cilat i shoh të arsyeshme Komisioni për Legjislacion do t'i mbështesë në lexim të dytë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka fjalën zoti Haki Demolli.

**HAKI DEMOLLI:** Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Fillimisht do të theksoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim përkrah aprovimin e Ligjit mbi amnistinë, aprovimi i të cilit ndër të tjera paraqet edhe njërin prej veprimeve të parapara në planin e veprimit për implementimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës e Serbisë e cila ditë më parë është ratifikuar nga ky Kuvend.

Mirëpo, Grupi Parlamentar i LDK-së, përkundër përkrahjes në parim të këtij ligji vlerëson se i njëjti ka mangësi të theksuara të cilat duhet eliminuar gjatë shqyrtimit të tij në Komisionin përkatës funksional, në grupet punuese apo në diskutimin eventual publik që do të organizohet lidhur me këtë draftligj.

Gjithsesi si njëra prej vërejtjeve kryesore që mund t'i bëhet këtij draftligji është numri i madh i veprave penale për kryerësit e të cilave parashihet amnistia. Përvoja e vendeve të tjera tregon se zakonisht ligjet e tilla përfshijnë një numër relativisht të vogël të veprave penale për të cilat ofrohet amnistia, kurse me këtë projektligj është paraparë që të amnistohen kryerësit e afro 100 veprave penale, gjë që nuk besoj se ekziston ndonjë ligj i tillë në botë, i cili afron amnisti për numër kaq të madh të veprave penale.

Pikërisht, përfshirja e numrit kaq të madh të veprave penale në amnisti ka bërë që në mesin e tyre të ketë edhe vepra penale për të cilat vlerësojmë se kryerësit e tyre nuk duhet amnistuar.



Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së konsideron se në fazat e mëtutjeshme të shqyrtimit të këtij ligji, duhet mirë e mirë të rishqyrtohet numri i tyre dhe të reduktohet në përmasa të arsyeshme.

Kështu, nga lista e veprave penale që do të amnistohen duhet të hiqen veprat penale me pasoja të rënda, pastaj veprat penale që kryhen me përdorimin e formave të ndryshme të dhunës si dhe veprat penale me të cilat cenohet siguria, pasuria dhe jeta e qytetarëve, numri i të cilave fatkeqësisht është duke u rritur prej vitit në vit në Kosovë.

Ndër veprat penale që duhet përjashtuar nga amnistia, gjithsesi është vepra penale e vrasjes në çast, shtrëngimit, kanosjes, sulmit, ngacmimit, vjedhjes dhe veprave të tjera penale të ngjashme, me të cilat janë cenuar jeta, pasuria dhe dinjiteti i qytetarëve të ndershëm të Kosovës, sepse tek e fundit obligim primar i këtij Kuvendi është mirëqenia, siguria e kësaj kategorie të qytetarëve tanë.

Më tutje, Grupi Parlamentar i LDK-së është tej mase i shqetësuar që në nenin 5 të këtij draftligji janë përfshirë për amnisti edhe një numër i madh i veprave penale të pastra ekonomike me të cilat është dëmtuar ekonomia e vendit e të cilat janë kryer nga kriminelët ordinerë të gjitha natyrave dhe që kanë bashkëpunuar dhe janë pasuruar në dëm të buxhetit dhe ekonomisë së popullatës së varfër të Kosovës.

Nuk besojmë që ka vend në botë i cili do të amnistonte kriminelë të cilët duke dëmtuar ekonominë e vendit, janë bërë milionerë, me çka do të amnistohet apo më mirë thënë, legalizohet pasuria milionëshe e krijuar mbi bazën e krimit dhe keqpërdorimeve të autorizimeve të ndryshme.

Veprat e kësaj natyre janë: keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, pastaj tregtia e ndaluar, shmangia nga tatimi, kontrabandimi i mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, shmangia mashtruese nga taksa e importit dhe akciza, si dhe vepra penale në lidhje me produkte në akciza dhe vepra të tjera penale të ngjashme.

Grupi ynë parlamentar vlerëson se është absurde të amnistohen kryerësit e veprave penale me të cilat në njërin anë është dëmtuar ekonomia e vendit e në anën tjetër janë pasuruar në mënyrë të kundërligjshme kriminelët e ndryshëm në kohën kur krimi dhe korrupsioni e kanë rrezikuar seriozisht funksionimin e shtetit të brishtë kosovar, për çka edhe Komisioni Evropian ka kërkuar prej shtetit tonë të aprovojë Ligjin mbi konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme, i cili po qe se miratohet ky draft ligj pa ndryshime, ka gjasë që për një kohë të gjatë të mbetet pa objekt dhe fushëveprim.

Ndonëse ky draftligj është sjellë në Kuvend si pjesë e implementimit të marrëveshjes Kosovë-Serbi, për t'i amnistuar kryerësit e veprave penale të grupit etnik serb, kemi përshtypjen se nga amnistimi i këtyre veprave penale do të përfitojnë më shumë kryerësit e veprave penale nga radhët e shqiptarëve të cilët kanë lidhje të caktuara dhe janë në bashkëpunim të ngushtë me qeveritarët tanë. Për shkak të këtij bashkëpunimi, Qeveria jonë përmes këtij projektligji, nen pretendimin e presionit të faktorit ndërkombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, synon t'i amnistojë kriminelët e të dy grupeve

etnike të cilët kanë vepruar nën direktivat dhe mbikëqyrjen si të Qeverisë në Prishtinë, ashtu edhe të asaj në Beograd. Madje- madje ka shkuar aq larg sa që amnistinë e disa veprave penale ia ka përshtatur disa prej zyrtarëve të lartë politikë nga radhët e partisë në pushtet, të cilët iu kanë shmangur vuajtjes së dënimit në forma të ndryshme.

Kurse sa i përket amnistimit të veprave penale të karakterit politik, të cilat janë listuar në pjesën e parë të nenit 5 të këtij draftligji, që kanë mund të kryhen ndër të tjera edhe në pjesën veriore të Kosovës, ku shteti ynë gjatë këtyre 14 vjetëve të ekzistimit nuk ka mund ta shtrijë në tërësi sovranitetin dhe pushtetin e vet e të cilën gjendje kanë mundur ta shfrytëzojnë qytetarët e këtij regjioni të Kosovës, vlerësojmë se me qëllim të integritetit të tyre në shtetin tonë, pastaj shtrirjes së sovranitetit edhe mbi këtë pjesë të territorit të vendit tonë, shteti ynë duhet të njëjtëve t'u garantojë se nuk do të ndiqen penalisht, andaj këto vepra penale duhet të jenë objekt i këtij ligji mbi amnistinë.

Krejtësisht në fund do të theksoj se ne si Grup Parlamentar do të përkrahim në parim këtë draftligj me kusht që deri në aprovimin final të tij në të do të inkorporohen edhe këto tri amendamente.

1. Amendamenti, me të cilin decidivisht do të përcaktohet që në amnisti të mos përfshihet asnjë kryerës i veprave penale kundër jetës dhe trupit. Pra, të mos amnistohet asnjë vrasës, me çka e garantojmë popullatën e Kosovës, familjarët e të gjithë të vrarëve në Kosovë si dhe elektoratin e partisë sonë se asnjë vrasës i aktivistëve dhe zyrtarëve të LDK-së si dhe të vrarëve të tjerë, nuk do të amnistohen.

2. Amendamenti me të cilin do të përcaktohet që asnjë zyrtar publik apo shërbyes civil i Kosovës, i cili me veprimet e kundërligjshme gjatë kryerjes së detyrës zyrtare është pasuruar në dëm të ekonomisë dhe pasurisë së Kosovës, nuk do të amnistohet. Dhe,

3. Amendamentin, me të cilin neni 3 i këtij draftligji do të fshihet në tërësi.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht më duhet të shpreh shqetësimin tonë për lojërat e ndyra që u bënë sot në këtë Kuvend, vetëm e vetëm për të kaluar pra Ligji për amnistinë.

Gjithashtu shprehim shqetësimin tonë për ngutin e miratimit të këtij projektligji në Komisionin për Legjislacion dhe tani në këtë seancë.

Pra të enjten me 27 qershor, Qeveria e ka sjell këtë projektligj në Kuvend, të hënën më 1 korrik, jemi thirrur në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, nga nënkryetari nga radhët e PDK-së, ndërsa sot e enjte po shqyrtohet në këtë seancë plenare, pra brenda vetëm 1 jave, ky projektligj i gjitha procedurat e parapara me Rregulloren e punës.

Kjo është shkelje flagrante e Rregullores së Punës së Kuvendit. Ky është degradim i Kuvendit, të nderuar deputetë.

Pra për interesat e Daçiqit dhe Serbisë, por edhe për interesat e zyrtarëve të korruptuar, po kalohen projektligje të tilla me nguti.

Projektligji për amnisti që na është sjellë në Kuvend përveç që e ka për qëllim amnistimin e strukturave kriminale në veri, i njëjti ka për qëllim edhe amnistimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe shkeljeve të tjera që janë bërë në kurriz të mirëqenies tonë.

Pra ka për qëllim edhe amnistimin e gjithë atyre të korruptuarve të kësaj Qeverie dhe atyre të mëparshmeve, por edhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Ky projektligj është kundër drejtësisë, kundër barazisë dhe kundër të drejtave të qytetarëve tanë.

Pra tashmë menjëherë filluan të dalin në pah dëmet e Marrëveshjes Thaçi- Daçiq, fillimisht me emërimin e Nenad Gjuriqit si komandant rajonal, që i kishte shërbyer me zell Milosheviqit dhe klikës së tij, më pas me shpalljen e zgjedhjeve lokale nga Daçiqi, pra 3 nëntorin dhe tash me Projektligjin kriminal të amnistisë.

Ky projektligj është tejet i dëmshëm dhe i njëjti e bën sistemin juridik të Kosovës anormal.

Amnistia është institut përmes të cilit kategori të ndryshme të personave të dënuar dhe kategori të caktuara të veprave penale, lirohen pjesërisht apo plotësisht nga vuajtja e dënimit.

Pra, amnistia është mekanizëm që shteti e përdor për t'u dhënë personave për vepra të caktuara penale amnisti, pasi që e kanë vuajtur një pjesë të dënimit dhe atë për dy arsye kryesore: për çështje humane dhe atë të kohezionit social. Por, ky projektligj nuk ka të bëjë as me njëjërën dhe as me tjetrën.

Fillimisht ka një shpërputhje të madhe ndërmjet memorandumit shpjegues të këtij projektligji dhe vetë projektligjit.

Pra te pika 5 e memorandumit thuhet që ky projektligj bazën kryesore e ka në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale dhe atë të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Por si duket, ju zoti Kuçi keni harruar që institutin e amnistisë e keni hequr tashmë nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës, edhe nga ai i Procedurës Penale dhe nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale. Pra instituti i amnistisë nuk ekziston më në legjislacionin penal të Republikës së Kosovës.

Tek neni 1 i projektligjit, ku flitet për qëllimin dhe fushëveprimin e tij, thuhet që amnistohen persona të cilët janë dënuar për një vepër penale. Pra, po amnistohen ata që tashmë e kanë marr dënimin, jo vetëm kriminelët, por edhe ata të korruptuarit.

Ky element ua mundëson të gjithë kriminelëve të Kosovës, qofshin ata të mëdhenj apo të vegjël, të korruptuar apo për krime tjera, që të aplikojnë për amnisti menjëherë pas miratimit të këtij projektligji.

Kur thotë kryeministri dhe zëvendësi i tij, pra zoti Kuçi që ky ligj nuk është vetëm për veriun, por edhe për pjesët tjera të Kosovës, i ka në mendje pikërisht këta kriminelë, këta të korruptuar që natyrisht vijnë nga strukturat aktuale partiake që e kanë pasur pushtetin, por dhe e kanë tashmë.

I njëjti nen, pra neni 1 thotë që do të amnistohen edhe personat të cilët janë nen ndjekje penale për vepra penale, apo personat të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale për vepra penale të kryera para 20 qershorit 2013.

Pra, po amnistohen ata që tashmë janë duke u hetuar e këta janë strukturat ilegale të Serbisë, strukturat e organizuara të një shteti që janë të instaluar në Kosovë dhe e kanë mbajtur nen okupim një pjesë të Kosovës për vite me radhë, në mënyrë që ta minojnë ekzistencën e Kosovës e që tash po marrin amnisti për këto krime.

Amnistia e vërtetë që po kërkohet këtu është për pjesëtarët e MUP-it dhe organeve tjera të aparatit represiv të shtetit të Serbisë, të instaluar në territorin e Kosovës, të cilat i kanë kryer të gjitha krimet ndaj shtetit dhe ndaj popullatës së Kosovës.

Për më tepër këtë e bën edhe më të rëndë fakti që kjo amnisti nënkupton edhe shlyerjen e te gjitha dëshmive dhe gjurmëve për krimet e bëra.

Gjithashtu në nenin 1 të Projektligjit thuhet që do të amnistohen personat të cilët mund të jenë objekt i ndjekjes penale. Pra, një grup i caktuar, në këtë rast serb, po amnistohen nga ndjekja penale.

Pra, ende pa nisur procedura e hetimit, identifikimit të krimit, identifikimit të kriminelit dhe dënimin të krimit.

Me këtë po amnistohen krimet që janë kryer ndaj shtetit të Kosovës dhe rendit kushtetues të saj, ndaj ekonomisë së Kosovës, ndaj pronës publike e private në Kosovë, me këtë ligj po instalohet pra padrejtësia e radhës në Kosovë.

Loja më ulët që është duke u shtyrë përmes këtij projektligji është përfshirja e veprave penale nga Ligji Penal i ish-Jugosllavisë. Këtë jeni duke e bërë me qëllim që të krijoni hapësirë për njohjen e vendimeve gjyqësore të strukturave paralele gjyqësore që kanë funksionuar për më se 14 vjet pra pas lufte.

Po thoni shumë prej jush publikisht se po ia falim krimet dhe shkeljet e rënda ligjore sepse do na njihet sovraniteti në atë pjesë.

E kundërta është e vlefshme. Që të forcojmë shtetin nuk i falim kriminelët, por i dënojmë ata.

Shtirirja e sovranitetit dhe falja e krimit përbëjnë lëvizje në kahe të ndryshme.

Kjo që po bëni ju është ta ndash sovranitetin me Serbinë, me strukturat kriminale në veri. Asgjë nuk ndryshon atje, përveç se veprimtaria kriminale nëse e votoni ju këtë projektligj nga sot e tutje është legale.

Meqë kjo është amnisti në pafundësi dhe pa kushte, në çdo çast që kriminelët në veri do ta ripërsërisin krimin po në atë moment, Ligji për amnisti do ta bëjë këtë krim të falshëm.

Pse duhet të heqin ata dorë ata nga sulmi mbi shtetin e Kosovës, kur një ligj ia garanton në çdo kohë faljen.

Pra, sovraniteti nuk po shtrihet, sovraniteti po dorëzohet, të nderuar deputetë.

Në fakt strukturat kriminale e ilegale të Serbisë në veri të vendit, nga miratimi i këtij ligji do të jenë struktura me sovranitet të plotë përmbi sistemin e drejtësisë së Kosovës.

Asociacioni përkufizon autonominë, amnistia përkufizon humbjen e sovranitetit në veri. Jo patjetër, prezenca e ndonjë policie përbën figurë të sovranitetit. Prezenca e Policisë së Kosovës, prezenca e FSK-së, e institucioneve të Kosovës aty, janë shenja që po ushtrohet sovraniteti.

Nëse Zvonko nuk quhet më kriminel sipas ligjit tonë dhe vazhdon të punojë për shtetin e Serbisë, kundër shtetit tonë, nuk është vënë sovraniteti i Kosovës në veri, por sovraniteti i Zvonkos në veri legjitimohet nga Republika e Kosovës.

Pra në bazë të Marrëveshjes aty mund të ketë edhe policë, por çështja qëndron se kujt do t'i binden ata. Pra, a do ta respektojnë kushtetutshmërinë tonë, pra a e mbrojnë ata interesin e Kosovës, apo interesin e Serbisë? Domethënë, a janë ata policë si Enver Zymberi që janë në gjendje të japin jetën për Kosovën? Sigurisht, që jo.

Ata tipat e llojit të Gjuriqit nuk do ta jepnin asnjëherë jetën për Kosovën.

Përfundimisht, të burgosurit, familjarët e tyre, qytetarët, shoqëria civile, pra KDI, KIPRED, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Lëvizja Fol, tashmë e kanë kundërshtuar fuqishëm këtë projektligj dhe kërkojnë nga ne që mos ta votojmë një projektligj të tillë kriminal, edhe ne si subjekt politik do ta kundërshtojmë fuqishëm këtë projektligj, pra do të votojmë kundër. Mirëpo ju bëjmë thirrje edhe juve që të votoni kundër këtij projektligji.

Edhe diçka për ata që shpresojnë, besojnë ose mendojnë që mund ta bëjnë amendamentimin në shqyrtimin e dytë, e kanë shumë gabim.

Ndoshta do të mund t'i ndryshoni pikat e presjet që janë tashmë gabime në këtë projektligj, por asnjëherë mos mendoni e shpresoni që keni për ta ndryshuar përmbajtjen e këtij projektligji të dëmshëm, meqë për këtë përmbajtje është perkujdesur tashmë Daçiqi. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, kryetari i Grupit, zoti Gjini e ka fjalën.

**ARDIAN GJINI:** Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se gjithçka është folur gjatë ditëve të kaluara për Projektligjin, ka pasur taborë, madje goxha të zorshme, po kemi dështuar të flasim për politikën e ligjit, kemi dështuar të flasim drejt, në dy ose tri raste është folur drejt. Kemi hezituar ose në shumës po flas, për të qenë korrekt, mirëpo është hezituar më mirë të them që të tregohet me të vërtetë pse po vjen ky ligj.

Sikur të mos kishte qenë problemi i veriut, sikur të mos kishin qenë bisedimet, nuk kishim ardhur deri te Ligji për amnisti dhe duhet thënë se nuk është as turp, as mëkat.

Dikush në veri ka kërkuar amnisti për ato që i kanë bërë deri tash, në mënyrë që tash e tutje të jenë subjekt i Kushtetutës dhe ligjit të Kosovës. Dhe ne si Aleancë, nëse kjo është ajo pjesë e projektligjit, nuk e shohim si problem. Mos harroni se dikush neve na kishte dhënë amnisti brenda 3 dite, nëse kishim pranuar diçka. Nuk po e shpjegoj më tepër, të gjithëve do të na kishte dhënë amnisti.

Mendoj se kjo pjesë e ligjit, kjo politikë e ligjit është krejt në rregull dhe Aleanca e mbështet, e mbështet për shkak se mendojmë se edhe qytetarët e Kosovës në veri edhe ne kemi nevojë për ditën 1 atje, për ditën kur do të fillojë të implementohet ligji, ku do të fillojë të sundojë ligji, ku do të fillojë të sundojë Kushtetuta e Kosovës dhe ata qytetarë vetë ta marrin këtë Kushtetutë dhe këto ligje dhe t'i implementojnë ato vetë. Ne mendojmë se Kosova ka nevojë për një ditë të tillë.

Me datën 1 korrik kur është mbajtur mbledhja e Komisionit, unë kam kërkuar që të jemi të kujdesshëm se ky ligj përfshin edhe elemente tjera të cilat mund ta prishin fabrikën e ndërtimit të shtetit dhe kjo ka të bëjë kryesisht me zyrtarët e shtetit, me njerëz që kanë dhënë betim. Ata bëjnë shkelje të dyfishtë, fillimisht kanë bërë krim, nëse kanë qenë të korrumpuar ose kanë abuzuar me pozitën, ose çkado tjetër e në anën tjetër edhe e shkelin betimin. Ne jemi betuar këtu e problemi im ka qenë se ne nuk guxojmë ta amnistojmë vetveten.

Të nesërmen edhe kryetari Haradinaj e ka përsëritur të njëjtën gjë në media dhe po duket që e gjithë kjo ka pasur efekt për shkak se sot po shohim që grupet parlamentare të cilat e mbështesin këtë projektligj, pra atë pjesën politike të tij, e kanë kuptuar se në këtë

karrocë që po e shtyjme me zor përpara, të gjithë ne, dikush ka provuar të hedhë plaçka të veta që i duhen vetëm atyre.

E kjo nuk është fer për shkak se nëse po e shtyjme bashkë përpara me mund, me shumë mund këtë karrocë, duhet pasur kujdes njerëzit të mos hedhin plaçka që iu duhen atyre, e të na lodhin neve të gjithëve me ato plaçka. Ky ka qenë problemi ynë.

Ne po bëjmë amnisti për ata që duhet të kthehen në rregull edhe është krejt në rregull. Ka qenë problem edhe për ne rritja e numrit të veprave penale që shihet aty që amnistohen dhe kush janë ata. Ka qenë problem për shembull t'i kuptojmë disa klasifikime sikur falja e veprave penale që lidhen me profitin jo proporcional, për shembull. Do të thotë, ata njerëz që kanë përfituar prej mundit të dikujt tjetër, që dikush ka qejf t' i quajë fajde e haraç nga kjo ana edhe ne kemi kërkuar që kjo pjesë të mos jetë aty.

Po ka dy arsye pse jo. E para është nëse po flasim për amnisti politike për serbët e veriut, askush prej veriut nuk ka ardhur të kërkojë haraç në jug. Ata u kanë kërkuar haraç njerëzve të vet. Dhe është e padrejtë edhe për ata për t' i falur. Do të thotë është e padrejtë për t' i falur edhe për ata edhe për pjesë tjera të Kosovës dhe mendojmë se kjo është e padrejtë dhe nuk duhet të ndodhë.

Çështja tjetër, është te zyrtarët publikë, u tha edhe më parë këtu, e kam thënë edhe në Komision, por po dua të ndalem vetëm pak për dy ose tri fjalë.

Betimi që e kemi dhënë para qytetarëve të Kosovës, nëse shkelet, nëse e amnistojmë vetveten, e prishim ndërtimin e shtetit në Kosovë. Nuk ka të bëjë kjo me amnisti politike në veri. Kjo ka të bëjë me atë se çfarë shteti po domi të ndërtojmë ne këtu.

Kjo e shkatërron atë që e kemi bërë deri më tani, e humb totalisht besimin e qytetarëve të Kosovës në shtetin që po e ndërtojmë.

Ne, të nderuar deputetë, mund të falim këndo. Ne mundemi me falë edhe një kriminel, por nuk kemi të drejtë të falim veten, nëse kemi bërë gabime, se ne jemi ata që e kemi çuar dorën dhe jemi betuar solemnisht këtu në Kuvend. Kryetarët e komunave janë betuar, Qeveria është betuar, asamblistët janë betuar, të gjithë jemi betuar, edhe zyrtarët publikë, administrata kanë nënshkruar kontratë me shtetin dhe janë betuar se do ta mbrojnë interesin publik dhe se do të menaxhojnë mirë me atë të përbashkëtën që u është besuar.

Mendoj se ajo pjesa e parë që e thashë për të hedhur plaçka në atë karrocën që po e shtyjme bashkë, është tendencë për të krijuar profit prej një procesi. Por nuk është vetëm Qeveria që provoi të krijojë profit prej një procesi, ka edhe elemente tjera në shoqërinë kosovare që po provojnë të krijojnë profit prej një procesi të mundimshëm dhe të zorshëm, që e dinë edhe vetë se duhet ta bëjnë.

Ata po bëjnë profit politik, dikush po bën profit tjetër. Është mirë në Kuvendin e Kosovës për të provuar të mos përfitojmë prej një procesi që është i zorshëm. Nuk është i lehtë, është me shumë kontraverse dhe që i bën shumë njerëz të ndihen keq.

Një çështje tjetër që nuk e kam parë në ligj, të paktën decidivisht, është tepër e rëndësishme.

Shikoni, nëse një person në veri, apo kudo qoftë, e ka uzurpuar një pronë të huaj, ne po vendosim që tash e tutje të mos e lejojmë ta bëjë një gjë të tillë, por çka ka bërë deri tash të mos e ndjekim penalisht. Ne po i themi, e ke uzurpuar, nuk po të ndjekim penalisht. Nuk guxojmë të gabojmë për ta përmendur taksativisht se prona që e ka uzurpuar duhet të kthehet. Do të thotë, kompensimi i dëmit që u është bërë njerëzve, gjithkund ku është e mundshme, duhet të bëhet në afat rekord. Njerëzit duhet të kompensohen. Ne nuk mund ta falim një njeri dhe ta falim edhe veprën që e ka bërë. Nuk mund të bëjmë ashtu.

Prona duhet të kompensohet, dëmi që u është bërë individëve, sidomos, duhet të kompensohet në mënyrë urgjente dhe kjo duhet të jetë diçka që është tepër taksative në Projektligjin për amnisti.

Në fund të fundit, më duhet t'ju them se Aleanca do ta votojë në parim Projektligjin për amnisti, për atë pjesën politike, po domi ta integrojmë veriu.

Por po ju garantoj se do të punojmë bashkë me ju që t'i bëjmë ato ndryshime për të cilat fola, nëse nuk ndodhin ndryshime ndërkohë po ju garantoj se nuk do ta ketë ky projektligj mbështetjen e Aleancës, nëse krimet ordinere të cilat i përmenda nuk do të fshihen nga kjo listë, nëse zyrtarët publikë nuk do të jetë taksativisht e qartë se nuk do të falen, ata që kanë dhënë betim dhe që kanë nënshkruar kontratë dhe nëse dëmet nuk do të jetë e qartë se do të kompensohen aty ku është e mundshme. Ne e dimë që jetët e njerëzve nuk mund të kompensohen, po ato dëme që mund të kompensohen duhet të kompensohen e ne e rezervojmë të drejtën që në lexim të dytë të mos e votojmë ligjin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Selmani e ka fjalën.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrat dhe deputetët,

Duke marrë parasysh se sot e kemi në rend të ditës Ligjin për amnisti, mund të themi se si Koalicion për Kosovë të Re do t'i japim përkrahje në parim, për arsye se ligji i cili do të miratohet sot, mund të themi se më shumë është ligj politik, ndërsa çështja e ligjit i cili na ka ardhur si deputetë të Kuvendit të Kosovës mund të themi se ligji duhet të ketë pastrime serioze. Synimi i ligjit duhet të jetë mundësimi i integritetit të veriut në jug dhe jo i jugut në veri.



Ideja është që të ofrohet amnisti për atë pjesë të Kosovës ku nuk ka pasur prezencë të rendit e të ligjit, ku gjykata dhe policia nuk kanë funksionuar. Por ideja nuk është që të amnistohet krimi dhe parregullsitë në vendin ku kemi pasur polici, prokurori dhe gjykata.

Me formën me të cilën është ligji, e përbuz punën dhe angazhimin tonë për një Kosovë me sundim të ligjit të mirëfilltë.

Si Koalicion për Kosovën e Re, insistojmë që ligji të pastrohet dhe t'i shërbejë qëllimit për të cilin është destinuar. Insistojmë që ligji të pastrohet apo të hiqet, ekskluzivisht neni 3.

Të ofrohet mundësia e prezantimit të ligjit në leximin e dytë në formën më kredibile dhe Kosova të konsiderohet vend dhe partner serioz ku rendi dhe ligji zbatohen, por edhe marrëveshjet ndërshtetërore zbatohen.

Ne po e përkrahim ligjin në leximin e parë, me kushtin e lartpërmendur, në të kundërtën, nuk do të jemi pjesë e procedimit të mëtutjeshëm.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar SLS, zoti Petar Miletic e ka fjalën.

**PETAR MILETIĆ:** Hvala gospodine potpredsedniče Skupštine!

Poštovani gospodine zameniče premijera Vlade, ministri,

Koleginice i kolege poslanici,

Razmatranje zakona o amnestiji, je dobra vest i za Kosovo i za kosovsko društvo. Amnestija je pravni mehanizam koji predstavlja dobru praksu, koju nam donosi savremeni svet kao uobičajenu meru za okončanje konflikta i uvođenje društva u pravne norme i definisana pravila ponašanja.

Dakle, zakon o amnestiji doneće pravni osnov da se ljudi koji bi mogli biti predmet sudskog gonjenja zbog postupaka u vremenima nerešenih odnosa i nepostojanja jasnih pravila ponašanja oslobode osećaja da mogu biti žrtve nečije političke odmazde, i to je dobro.

Sa druge strane, svaka amnestija ostavlja otvorena pitanja – da li će proći nekažnjeno i oni čija su zlodela i kriminalno ponašanje bili očigledni. To je nažalost boljka svake amnestije, ali i nesavršenosti prava uopšte.

U tom smislu kosovski konflikt nije specifičan i za to treba uzeti tuđa dobra iskustva koja u svetu postoje.

Specifičnost Kosova je u činjenici da post-konfliktni period traje gotovo 15 godina i umesto da se odnosi relaksiraju u ovom predugom periodu izgrađena su dva potpuno odvojena i suprotstavljena sistema. Interesi građana i logika svakodnevnog života učinili su da su danas za normalizaciju odnosa spremni i građani nego ti sistemi.

Mi zato danas plaćamo cenu višegodišnjeg odbijanja političkih faktora da se suoče sa problemom. Na ovom primeru se može videti da zamrzavanje konflikta ne postoji, jer

iako se prekine politička komunikacija i održava status-quo ne može se zamrznuti život. Ali je takođe nemoguće i zamrznuti zloupotrebe nepostojanja pravnog sistema. Naprotiv.

Porast krivičnih dela i jačanje svih oblika kriminala je u periodu zamrznutog konflikta najizraženiji.

Ako neko u ovoj sali ima lični motiv da glasa protiv ovog nacrt zakona, onda sam to ja. Ali da bi društvo krenulo napred i da bi napokon došlo do pune normalizacije odnosa, ne samo Prištine i Beograda, nego i odnosa na samom Kosovu, neophodno je da podržimo usvajanje zakona o amnestiji ali i briselski sporazum u celini.

Osim što donošenje zakona o amnestiji predstavlja realizaciju dogovora iz Brisela koji je time čini i ispunjenim preuzete obaveze, ono je dobro i poželjno za kosovsko društvo.

U svom prvom delu, zakon daje mogućnost ublažavanja zakonskih sankcija počinocima krivičnih dela i mislim da tu nema politike.

U drugom delu, zakon tretira amnestiju za postupke i događaje koji su posledica konflikta i tu je njegova najveća politička težina i razlog njegovog donošenja.

Mi iz Samostalne liberalne stranke sve vreme smo upozaravali da je pogrešno i opasno sve građane severa Kosova nazivati kriminalcima, jer oni to jednostavno nisu. Štaviše, najteža krivična dela poput trgovine drogom, oružjem, ljudima funkcionisale su u sprezi dobro povezanih kriminalnih grupa severno i južno od Ibra.

Donošenje zakona o amnestiji nije samo deo ispunjavanja obaveza i poštovanja zakona o implementaciji briselskog sporazuma koji smo usvojili. Politička težina ovog zakona je u tome da najširi sloj građana zaštitimo od moguće zloupotrebe straha od selektivne primene zakona Kosova i mi ćemo danas glasati za to. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+”, nuk ka të paraqitur. Nga “Zajednička Budućnost”, zoti Marinković e ka fjalën.

BOBAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine potpredsedniče! I Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” je mišljenja da se Nacrt zakona o amnestiji je veoma važan zakon i da se odnosi na sve građane Kosova i validan je na celoj svojoj teritoriji a ne samo za građane severa Kosova.

Poslanička grupa je analizirala Nacrt zakona o amnestiji i primetili smo dosta jezičkih grešaka, što ga čini pravno nerazumnim, i za to će Poslanička grupa “Zajednička Budućnost” radom u komisijama založiti da se zakon jezički ispravi i insistiraće na tome da se zvanična i uspravna verzija usvoji. I zato podržavamo u načelu usvajanje zakona o amnestiji.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe grupet parlamentare i dhanë qëndrimet e tyre, besoj se është koha për drekë dhe pastaj e vazhdojmë debatin pas dreke, në orën 15:00.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Ju lus t'i zëni vendet tuaja dhe të vazhdojmë debatin lidhur me shqyrtimin e parë të Projektligjit për amnistinë. Në radhë është zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Kolegë deputetë,

Ligji për amnisti është një nga ligjet që ka buruar nga marrëveshja politike e 18 prillit dhe si ligj kërkohet të amnistohen disa vepra të cilat janë kundër rendit kushtetues, kundër veprimeve kushtetuese të qytetarëve të Kosovës, që janë pjesë e veriut dhe mendoj se pjesa ku kemi të bëjmë me rendin kushtetues ia vlen të diskutohet dhe nëse jemi pjesë e raportit të kompromiseve, atëherë edhe ky është një kompromis. Pra, do të flas edhe në veten e parë, pikërisht nga paslufta si pengë që kemi qenë pjesë e Serbisë edhe unë jam liruar nga amnistia pikërisht nga këto rrethana në 2002, ku ka përfunduar një luftë e armatosur në mes Serbisë dhe shqiptarëve në Kosovë. Dhe ne, si përfitues të asaj të drejte, në atë kohë është debatuar pikërisht edhe në Beograd kjo çështje për amnistinë dhe lirim tonë.

Mirëpo, lirimi nga veprat të cilat kanë të bëjnë kundër rendit kushtetues është çështje dhe mund të them e arsyeshme të diskutohet dhe të lirohet, por veprat të cilat kanë të bëjnë me vepra të ndryshme kriminale, e po ashtu edhe ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë së Agjencia për Dëmtime të Pasurisë, zjarrvënia, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim të paautorizuar të armëve, moslajmërimi i veprave penale, dhënia e ndihmës kryerësve të veprave penale, kanosja e kandidatit, parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, tregtia e ndaluar, shmangia nga tatimi, kontrabandimi i mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme, asgjësimi ose dëmtimi i instalimeve publike, rrezikimi i trafikut publik, falsifikimi i dokumenteve, rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve, pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, sulmi ndaj personit zyrtar apo dispozitat tjera, pengimi i lëvizjes së automjete, të doganierëve e tjerë, mashtrim në taksa fiskale, në akcizë, mashtrues nga zbatimi i ndalesave, kufizimeve të veprimeve, pjesëmarrjen, e tjera, e tjera, janë vepra të cilat asnjë amnisti, askund, në asnjë vend, në asnjë shtet në botë nuk amnistohen.

Nëse ne konsiderojmë marrëveshje politike lirim nga rendi kushtetues, secili do ta kuptojmë qartë se kemi të bëjmë me një marrëveshje politike, ndërsa lirimi i këtyre bandave kriminele do të thotë prishje e rendit kushtetues dhe falje e atyre njerëzve që kanë shkaktuar pasoja të gjitha. Unë kërkoh edhe nga ministri që tani mungon, këto vepra penale të hiqen nga pjesa e nenit 5 dhe të mbesin vepra të cilat janë kundër rendit kushtetues dhe të cilën ky Kuvend, në bazë të rrethanave duhet ta kalojë.

Ndërsa, për nenin 3, nuk mund të flasim, sepse deri sa e kemi këtë pjesë në nenin 5, është e palogjikshme.

Prandaj, nëse në këtë amnisti nuk përfshihen njerëzit të cilët kanë luftuar dhe e kanë çliruar vendin, e kanë çliruar Kosovën nga Serbia dhe të kërkohet t'i amnistojmë banda kriminale, ndër të cilat është edhe pjesa e akcizës, kjo është një gjë që për mua, për dinjitetin e deputetit, për gjendjen tonë këtu që e kemi, është e paarsyeshme, e palogjikshme, e pakuptimtë dhe mund të them një paradoks i Kuvendit të Kosovës dhe vendit tonë nëse ne e miratojmë në forma të tilla.

Prandaj, unë them me plot bindjen se, nëse nuk hiqen këto dhe nuk kërkohet të hiqen këto, ose nuk i kthehet Qeverisë të hiqet kjo, në këtë gjendje unë jam kundër këtij ligji për amnisti, sepse nuk u mundëson qytetarëve tanë të jenë pjesë e një ndërgjegje të zhvillimit të vendit tonë, ndërsa ne kur e llogarisim këtë që njerëzit që kanë luftuar janë pjesë e burgjeve dhe ky ligj nuk i përfshin dhe nuk i amnistion, atëherë cila është arsyeja ta votojmë këtë ligj. Ne, në veten e parë, menjëherë e bëjmë diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit tonë.

Unë jam kundër këtij ligji, sepse nuk i plotëson kriteret dhe kërkesat për një amnisti. Ne jemi për të pasur falje, falje që do t'i bëjë presidenti ose presidentja për vepra të caktuara, për persona të caktuar të cilët kanë qenë pjesë dhe janë pjesë e burgjeve, që i kanë mundësuar ose i kanë përmirësuar kushtet apo sjelljet e tyre për vepra, apo janë penduar për veprat e tyre. Pra, këtu nuk kemi të bëjmë për çështje të amnistisë por këtu kemi të bëjmë me një ligj që do të legalizojë bandat dhe krimin, kështu që mendoj se ministri duhet të na sigurojë ne se kjo është një gjendje shumë e rëndë dhe ai duhet ta tërheqë ligjin, t'i heqë këto pika dhe atëherë ta bie ligjin në Kuvend dhe ta miratojmë.

Unë jam kundër këtij ligji në këtë formë që e ka sjell në Kuvend të Kosovës Qeveria.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qysh kur pati filluar diskutimi për ndryshimet kushtetuese që të lejohet amnistia si në kuadër të diskutimeve publike por edhe atë në Komisionin për Legjislacion dhe në kuadër të subjektit tim politik, kam shprehur rezervat e mia për atë se a duhet në këtë fazë, pas pavarësisë, me këtë sistem jo të mirë gjyqësor, me këtë shkallë aq të lartë të krimit dhe korrupsionit, me pushtet joefikas si dhe me një të kaluar të vështirë të tranzicionit të cilën e ka pasur Kosova që nga paslufta, të lejojmë amnistinë.

Fatkeqësisht, subjekte dhe individë nga partitë politike në emër të “humanizmit”, trumbetuan” aq shumë pa dhënë arsye të qëllimit apo ndonjë ekspertizë pse Kosova ka nevojë për amnisti.

Sot e kemi para veti një projektligj për të cilin tanimë kemi edhe vërejtje konkrete, dyshime për prapavijë etnike e politike, e deri edhe perceptimin nga shumica e qytetarëve

se ky ligj bëhet për të amnistuar pushtetarë që janë të dyshuar, por edhe ata të dënuar për vepra të ndryshme penale.

Projektligji amnistion shumë vepra penale, bile- bile ledhe në kundërshtim me programet politike e qeveritare institucionale, për zero tolerancë kundër krimit dhe korrupsionit. Aty amnistohen vepra të parapara me Kodin e ri penal, ish Kodin penal, ish Ligjin penal, po ashtu edhe veprat e dënueshme me disa rregullore të UNMIK-ut, me Kodin doganor dhe akcizat.

Ky projektligj, kështu siç është, pa marrë parasysh arsyet e ndryshme që janë dhënë për miratimin e tij, mendoj se duhet pasur shumë elemente parasysh të cilat duhet ndryshuar. Për të qenë të bindur se duhet votuar, e gjithë kjo, si rrjedhojë jo vetëm e atyre që i theksova, por për çështje që bien në kundërshtim me interesat e qytetarëve dhe interesin e përgjithshëm publik duhet të jenë në rend të parë.

Unë po e ngre një paralele të thjeshtë, por që përkon me përpjekjet jo vetëm pas lufte por edhe më herët të qytetarëve të vendit tim për një Kosovë ku mbizotëron rendi dhe ligji, ku respekti për institucionet nuk është vetëm obligim kushtetues, por edhe etik, ku pasuria e vendit nuk është pronë individuale, por është e mirë e përgjithshme, ku obligimi qytetar për pagesën e taksave dhe pagesat për shërbime publike, rezultojnë në zhvillim të vendit dhe ajo më e rëndësishmja ku jeta e njeriut është më e vlefshme se gjithçka, që është e drejtë e garantuar edhe me ligj, edhe me konventa ndërkombëtare.

Por, të nderuar kolegë deputetë, në kuadër të këtij projektligji parashihen të amnistohen shumë persona, të thjeshtë apo persona publike dhe që bie në kundërshtim të plotë me idealet dhe punën e qytetarëve të ndershëm të cilët vërtet e duan këtë vend dhe punojnë në çfarëdo forme me nderë dhe përgjegjësi.

Në kohën kur kërkohet miratimi i këtij projektligji tashmë është e qartë se është rezultat i Marrëveshjes së arritur në fund në mes dy kryeministrave, atij të Kosovës dhe Serbisë dhe kjo duhet të thuhet publikisht, me guxim dhe përgjegjësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Por, përfshirja apo zgjerimi edhe i shumë veprave që fare nuk kanë karakter human, duhet të rishikohen veprat penale të cilat fshihen gjoja në emër të kësaj marrëveshjeje apo me qëllim të integritetit, vepra të cilat kanë dëmtuar individë dhe të cilat janë kryer për përfitime individuale.

Unë po i përmendi vetëm disa vepra që nënkuptojnë arsyet që i theksova. Në Kosovën e pasluftës janë vrarë në mënyrë barbare dhe tinëzare intelektualë, deputetë, oficerë dhe komandantë, kryetarë komunash, inxhinierë, shkrimtarë, poetë, analistë, aktivistë, atdhetarë dhe cili do të jetë verdikti i gjykatave pas kësaj amnistie, a mos këto do të thuhën se janë bërë nga UDB-ja serbe apo nga gjendja e afektit mendor apo nga pakujdesia?

Pa një amendament që sanksionon qartazi se nuk do të ketë amnisti për këto vepra penale, unë mendoj që kjo nuk duhet të kalojë në këtë formë.

Financimi i strukturave ilegale që kanë vepruar në Kosovë dhe jo vetëm në pjesën veriore, është bërë nga bizneset e pista. Uzurpimet e pasurive shoqërore private, ku reketi, haraçi, gjobvënia, në formë edhe të financimit ilegal e gjysmë legal kanë dëmtuar rënd jetën e qytetarëve të Kosovës që nga paslufta e deri me tani.

Me amnisti të fitimit jo proporcional nënkupton që qytetarët e ndershëm t'i dënojnë të penalizuarit, viktimat të dënohen në emër të humanitetit.

Veprat tjera, që përfshijnë arsyet që nuk kanë kurrfarë karakteri human:

Vjedhja. Paramendoni se vetëm në këtë vit, statistikave të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, tregojnë për numra të vjedhjeve në Kosovë, ku numri i vjedhjeve është rritur dhe këtu kemi fare pak dënime ku qytetarët terrorizohen, tani kërkohet tu jepet amnisti.

Fshehja e tatimit. Për çdo ditë, Administrata Tatimore e Kosovës paraqitet edhe në media për rëndësinë e pagesës së taksave deri te ajo edhe më elementare kuponi fiskal, ndërsa, këtu kërkohet amnisti për të gjithë ata që për vite të tëra kanë fshehur, mashtruar, kontrabanduar, dëmtuar buxhetin dhe xhepat e qytetarëve të ndershëm e deri te konkurrenca e lirë në treg. Kjo jo që duhet të amnistohet, por edhe duhet të penalizohet edhe më tutje.

Kolegë deputetë, amnistia apo falja është akt moral, individual, por edhe grupor, është fisnikëri të falësh për dënimin, dhembjen personale që ta ka shkaktuar dikush ose ka mbetur në tentativë. Për të rehabilitosh krimin dhe kriminelët të cilët i kanë sjell torturë popullit të Kosovës, duke ia ekzekutuar bijtë më të mirë, duke vjedhur buxhetin e Kosovës, duke u pasuruar me mënyrë marramendëse, kjo është e pakonceptueshme për mendje të shëndosha. Është faj, është krim, sepse i rivret të vrrarët, lëndon shpirtrat e trazuar të familjeve për humbjet e bijve të tyre. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

**ALMA LAMA:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji për amnistinë mendoj që shënon pikën më të ulët në të gjithë procesin politik i cili lidhet me përpjekjet për të zgjidhur çështjen e veriut. Përpjekjet për rehabilitimin e komunitetit serb janë keqpërdorur me dinakërinë për të liruar nga ndëshkimi të gjithë kryerësit e veprave penale të cilat përgjatë këtyre viteve shkelën ligjin.

Janë shumë të njohura praktikatat ku pas një marrëveshjeje politike, kur pas një lufte apo një konflikti lidhet një marrëveshje paqeje e cila parashikon edhe amnistinë për palët në konflikt. Unë dyshoj fort se është lidhur ndonjë marrëveshjeje paqeje me Serbinë, dyshoj edhe për një fakt tjetër, sepse Serbia aktualisht nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të bërë gjithashtu një ligj të ngjashëm për amnistinë.

Por, sidoqoftë, t'i kthehem ligjit. I kam tri vërejtje themelore, të cilat e bëjnë këtë ligj të papranueshëm.

Së pari, nuk përcakton afatet kohore për amnisti. Është marrë data 20 qershor 2013 si datë e fundit, por i mungon një datë e fillimit e cila do të përkonte me situatën e jashtëzakonshme që ka mbizotëruar në atë territor të cilit i dedikohet ligji.

Në rastin konkret, ky afat kohor duhet të fillonte pas shpalljes së pavarësisë, pra me 2008, sepse pikërisht në këtë moment ka filluar edhe mosnjohja e rendit kushtetues dhe rrënimi i gjykatave në veri nga ana e komunitetit serb atje.

Nuk mund të pranohet ky projektligj pa datë fillimi dhe mbarimi, sepse do të ishte krejtësisht i pakuptimtë. Në rast se ky projektligj do të miratohet kështu si është, pra pa një datë të fillimit, atëherë i bie që do të amnistohen të gjitha krimet serbe të kryera në Kosovë, për shembull do të amnistohet djegia e rreth 200 000 shtëpive të shqiptarëve, do të amnistohet gjithashtu uzurpimi i pronave, i shtëpive.

Vërejtja je dytë është se këtij projektligji i mungon përcaktimi i saktë i kryerësve të veprave penale, të cilat duhet të lidhen vetëm me rendin kushtetues. Nuk mund të bëhet amnisti për të gjithë, sepse kështu legjitimohet krimi.

Në rastin konkret edhe në veri duhet të përcaktohen saktë me anë të këtij ligji ato grupe që kanë kryer vepra penale për shkak të bindjeve të tyre politike dhe jo kundër individëve me motive personale. Vetëm serbët në veri nuk e kanë njohur rendin kushtetues të Kosovës, prandaj ata duhet të jenë grupi që përfshihet në këtë projektligj.

Po kështu, në rast se ky projektligj derivon nga Marrëveshja, e cila është bërë pikërisht për veriun, atëherë si mund të shtrihet në tërë Kosovën.

Vërejtja e tretë themelore, ka të bëjë me përcaktimin e veprave penale për të cilat mund të jepej amnisti. Këto vepra nuk mund të jenë të tjera përveç atyre që lidhen me rendin kushtetues, që janë kundër një sistemi dhe rendi të caktuar, pra kundër shtetit.

Të gjitha këto vepra lidhen me bindjet politike të grupacionit të caktuar. Është e papranueshme që në projektligj janë përfshirë vepra penale kundër individëve. Kjo është gjithashtu në kundërshtim të plotë me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nen i cili ka të bëjë me të drejtën për mjete juridike. Po kështu, në Kushtetutën e Kosovës është e garantuar kjo e drejtë, si dhe epërsia e konventave ndërkombëtare mbi legjislacionin vendas në nenin 22 të Kushtetutës.

Pra, ky projektligj është shkelje edhe e Kushtetutës së Kosovës, edhe e konventave ndërkombëtare.

Të amnistosh krime të kryera kundër individit do të thotë të shkelës të drejtën e viktimave për mjete juridike, do të thotë që ti si shtet të mos i mbrosh qytetarët e tu, e në rast se shteti nuk i mbron atyre iu lind e drejta për vetëgjyqësi. Me një fjalë, t'i kthehen kanuneve të vjetra zakonore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Pse duhet të amnistohet vrasja pa qëllim apo vrasja në afekt, apo vrasja e foshnjave? Pse të amnistohen krimet e kryera në trafik, aksidentet, kërcënimet, fyerjet, shantazhet, korrupsioni e tjerë?

Vendosuni pak në vend të viktimave. A do të doni që vrasësin e të afërmeve të tu ta shihni të lirë, të pandëshkuar nga shteti, a do të doni që kërcënuesin tuaj, dhunuesin tuaj, fyesin tuaj ta shihni duke ju kaluar pranë pa e marrë ndëshkimin?

Përpjekja për të futur nën rrogë me dhjetëra vepra penale të dënueshme, të kryera kundër individit që e bën ky projektligj për amnistinë është përpjekje për t'i dëmtuar seriozisht viktimat, për t'i vrarë për së dyti ata që janë vrarë, për të vrarë për së gjalli familjet e tyre.

Kjo metodë e rrënon besimin në drejtësi, përcjell mesazhin se ligji bën të mos respektohet, sepse askush nuk ju ndëshkon, e shkatërron sistemin e drejtësisë dhe vendos precedent të rrezikshëm.

Prandaj është mirë që Qeveria ta tërheqë këtë projektligj dhe ta sjellë ashtu siç ishte dizajnuar në fillim, amnisti për veprat penale kundër rendit kushtetues. Nuk mund të bëhet ligji për miqtë e shokët, as ligj me qëllim për të përfutur votat të burgosurve.

Me thënë të drejtën, kjo llogari mizore më duket edhe e gabuar, sepse kushdo që pretendon të marrë votat të kryerësve të veprave penale, do të humbasë votat e viktimave, të cilat janë gjithësi më të shumta. Në fakt, viktimë është e gjithë shoqëria.

Kam dëgjuar këto ditë në Kuvend, në fjalime nga zyrtarët e ndryshëm politik të cilët janë shumë kontraverzë, marrin në mbrojtje edhe viktimat edhe viktimizuesit dhe këtë e bëjnë për hir të votave. Absurde, llogari e gabuar dhe kriminele do të thosha.

E dëgjova këtu zëvendëskryeministrin deri sa prezantonte ligin, zotin Kuçi i cili bëri një krahasim në mes amnistisë dhe faljes. Në fakt këto janë dy gjëra të ndryshme, falja bëhet për çdo emër, për çdo emër të ndëshkuarit i cili po e vuan dënimin, për çdo person dhe mund të jetë si shpërblim për një sjellje të mirë, ta zëmë, ndërsa amnistia bëhet për vepra penale. Mund të bëhet edhe për persona të cilët nuk janë të ndëshkuar, por që kanë kryer këto vepra penale brenda këtij afati i cili është përcaktuar.

Prandaj, mendoj që është jashtëzakonisht e gabuar që ky ligj, ky projektligj të miratohet kështu si është.

Do të doja gjithashtu që ta pyes kryesuesin e seancës që të na japë një përgjigje të saktë – 100% se si do të votohet ky projektligj? Në rast se sot do të votohet me 2/3, a do të jetë ky votimi përfundimtar, apo do të ketë mundësi që projektligji të amendamentohet dhe të votohet seriozisht? Ju lutem, zoti kryesues, sqaroheni për deputetët sepse ka një konfuzion të plotë.



Mundësia për ta amendamentuar mund ta përmirësojë projektligjin, por në rast se nuk amendamentohet ky ligj është tërësisht i papranueshëm. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Edhe në lexim të parë, edhe në lexim të dytë, duhet të votohet me 2/3, kështu që do t'i ketë dy lexime. Kjo është sa për informatë të gjithëve.

Atëherë, radha është tek Fatmir Xhelili.

**FATMIR XHELILI:** Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin,

Përshëndetje për deputetët e nderuar,

Motivi për të diskutuar për këtë temë me të vërtetë është motiv i arsyeshëm dhe motiv përmbajtjesor, pavarësisht ndoshta më duhet t'i përsëris shumë gjëra që i kanë folur parafolësit e mi. Mirëpo, domosdoshmëria për ta aprovuar këtë ligj, për shkak të derivateve të dala nga Marrëveshja me Serbinë besoj se është e arsyeshme dhe e përkrahim Qeverinë për propozimin e këtij Projektligji për amnistinë.

Edhe unë do ta votoj në lexim të parë dhe do ta përkrah Qeverinë në këtë drejtim për t'i përmbushur detyrat dhe obligimet që dalin prej Marrëveshjes.

Mirëpo, me leximin e kujdesshëm të këtij ligji, unë si jo jurist, i kam radhitur diku 45 paragrafe të nenit 3 që me të vërtetë janë paradoks në veti për arsye se nuk kisha mund ose s'po mund ta kuptoj se këto paragrafe janë të nevojshme, të domosdoshme dhe ndikojnë në përmirësimin e raporteve dhe marrëdhënieve me Serbinë, gjegjësisht normalizimin e saj.

Shpifja, vjedhja, krimet ordinere, kontraktimi i fitimit joproporcional, shitja e medikamenteve për shërimin e kafshëve, ushtrimi jo ligjor i shërbimeve shëndetësore, falja për deklarimin e rrejshëm të deklaratave për dogana, për akciza dhe për taksa, tregtia jo e ligjshme dhe mos t'i numëroj tjerat, të bëjnë për të menduar thellë se me këtë ligj cili është mesazhi dhe porosia që po ua japim qytetarëve, cili është mesazhi dhe porosia që po e japim të rinia jonë, të fëmijët tanë, cili është mesazhi që ata të punojnë, të kontribuojnë dhe të përkushtohen që nesër të jenë qytetarë të ndershëm e të arsyeshëm, të zbatojnë ligj, qytetarë që angazhohen të ndihmojnë instrumentet e shtetit tonë për i luftuar fenomenet dhe dukuritë negative.

Cili është mesazhi për instrumentet e shtetit tonë që me përkushtim janë munduar t'i ndjekin keqbërësit, cili është mesazhi për të gjitha ato investime që është duke i bërë shteti ynë dhe Bashkimi Evropian për të punuar në drejtim të parandalimit të fenomeneve e dukurive negative, krimeve, llojeve të ndryshme të krimeve, krimet të organizuar, çfarë kuptimi ka me këtë ligj të falen kontrabandues të ndryshëm e tjerë dhe sa me përkushtim do të vazhdojnë instrumentet e shtetit tonë të parandalojnë, ta luftojnë krimin, të krijojnë siguri për qytetarët, të ruajnë shëndetin, jetën, pronën e tjera? Cili është kuptimi për t'i falur falsifikuesit e dokumenteve zyrtare, cili është qëllimi për t' i falë ata që i fshehin dokumentet në arkiv, i asgjësojnë dhe shumë, e shumë krime tjera.

Unë jam për t'i amnistuar të gjithë ata që i kanë takuar strukturës së MUP-it të Serbisë dhe kanë vepruar në Kosovë, jam për t'i falë të gjithë ata që kanë punuar në struktura dhe institucione shëndetësore, në institucionet administrative, në mbrojtjen civile, në prokurori e gjyqësi dhe tjerë, por nuk jam për t'i falë ata që i kanë takuar strukturave tjera. Nuk po mundem kurrsesi të pajtohem posaçërisht me shpifjen, vjedhjen e tjera, se shpifjet dhe të gjitha ato kanë krijuar një çrregullim të vlerave në Kosovë dhe një çrregullim të kriterit të vlerave ku vërtetë jo vlerat tentojnë të prezantohen si vlera, dhe vlerat tentojnë të prezantohen si jo vlera, andaj kisha përjetuar si ofendim personal të jem pjesë e këtij ligji që amnistion ose më amnistion në forma dhe mënyra të ndryshme për të gjithë aktivitetin dhe veprimtarinë që e kam zhvilluar në drejtim, qoftë gjatë luftës qoftë pas luftës dhe tutje.

Amnistitë ndodhin edhe në shtetet tjera dhe kanë qëllime politike dhe rezultojnë me rezultate për përmirësim të jetës së qytetarëve, të normalizimit të relacioneve me shtetin e tjerë. Mirëpo edhe ky ligj kishte qenë dashur ta ketë një afat të kufizuar kohor, diku prej shpalljes së pavarësisë kanë filluar të jenë jashtë ligjit pjesa e qytetarëve në pjesën, kushtimisht po them, të veriut dhe vetëm prej 17 Shkurtit e këndeje deri në datën e caktuar që e ka propozuar Qeveria, kishte mund të ketë kuptim një amnisti, sepse deri në 17 Shkurt 2008 atje ka pasur zbatim të ligjit, edhe ashtu çfarëdo qoftë zbatimi, ka pasur zbatim të ligjit mirëpo jashtë ligjit ka qenë prej 17 Shkurtit 2008 e deri më tash.

Ka kuptim edhe një ligj i tillë të përcaktohet për një territor të caktuar, sikur që janë 4 komunat a 5 komunat, e tjerë. Pse të përcaktohet për krejt Kosovën dhe thellë do të mendohem në qoftë se nuk reduktohen këto paragrafe prej këtij neni, a ta votoj leximin e dytë apo jo dhe me siguri në këtë formë nuk e kisha votuar. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

**TEUTA SAHATQIJA:** Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se sa i përket ligjit të amnistisë, është një ligj i cili nuk është zbulim i Kosovës, është një ligj dhe procedurë e cila ka ekzistuar dhe vazhdon të eksitojë në shumë vende, sidomos pas luftës edhe për çështje tjera të cilat janë pjesë e amnistisë.

Por, në këtë rast, duke pasur parasysh se në çfarë mënyre na ka ardhur ky ligj i amnistisë e sidomos neni numër 3, atëherë fitohet përshtypja që ky ligj në fakt nuk ka ardhur këtu për të ndihmuar Marrëveshjen për normalizimin e raporteve në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë, por që është ligj i cili në krah të normalizimit të marrëdhënieve dhe marrjes së obligimeve ndaj partnerëve tjerë, në fakt tenton, sidomos përmes nenit numër 3, që të shfrytëzojë rastin edhe të amnistojë edhe çështje tjera të cilat në fakt nuk duhet të jenë pjesë e ligjeve të amnistisë.

Mendoj se Grupi Parlamentar i LDK-së ka qenë shumë i qartë në qëndrimet e veta dhe dua edhe njëherë ta përsëris atë që zoti Demolli e ceku se ky ligj nuk duhet aspak të ketë amnisti për vrasje, për lëndime trupore dhe për çështje të ngjashme. Gjithashtu në asnjë mënyrë nuk mund të amnistohen zyrtarët të cilët e kanë shfrytëzuar pozitën e tyre dhe sot

janë pasuruar në krah pikërisht të pozitave të veta dhe ajo nuk mund të jetë aspak në dobi të normalizimit të marrëdhënieve me shtetet tjera apo në dobi të marrëveshjes.

Dhe, prapë po e përsëris se neni numër 3 është neni i cili brenda vetit fsheh mjaft gjëra të cilat në kuadër të normalizimit të marrëveshjeve tenton që të shfrytëzojë rastin e amnistimit së shoqërisë së vet, të cilët e kanë shfrytëzuar. Është shumë e çuditshme kur shihet që vjedhja e shërbimeve komunale, lidhjet e paautorizuara në shërbime, ndryshimet e njehsorit e tjera që në fakt kanë të bëjnë se ndryshimi i njehsorit ka të bëjë me rrymë që amnistohen, ndërsa në anën tjetër e dimë që me privatizim është cekur që ato borxhe të vjetra duhet të jenë borxhe të cilat do të shkojnë dhe llogariten edhe më tutje. Prandaj, kjo bie bukur ndesh edhe me këtë. Pastaj shërbimet komunale janë shërbime edhe të ndërmarrjeve publike, janë shërbime të cilat nuk janë të shtetit dhe mendoj që ne me këtë ligj po tentojmë që të falim borxhet e huaja, pa u marrë vesh me ata se a janë të gatshëm që t'i falin apo jo.

Pastaj, pjesa tjetër e cila flet për pasurinë, siç është neni 3, 1.3.30 ku thuhet që marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, të paluajtshme apo dëmtimi i të drejtave pronësore të një personi tjetër apo cenimi i paprekshmërisë së banesave çfarë është te neni 3, 1.1.9, janë çështje të cilat duhet të hiqen dhe nuk duhet të amnistohen duke pasur parasysh se cenohet prona private e personave, e qytetarëve.

Përveç këtyre, mendoj që janë edhe mjaft gjëra tjera të cilat patjetër se kërkojnë që ky ligj të amendamentohet, një pjesë bukur e madhe të hiqet dhe që në fund ky ligj të përngjajë me ligje për amnisti dhe të shkojë në dobi të normalizimit e jo që të shfrytëzohet rasti i amnistimit të veprave të pahijshme të cilat kanë ndodhur këtu dhe të cilat aspak nuk kanë të bëjnë me amnisti. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

**GLAUK KONJUFCA:** Faleminderit!

Këtu në Kosovë nëse shumë gjëra janë konfuzë dhe të paqarta, një gjë është shumë e kthjelltë po sikur drita e diellit dhe kjo ka të bëjë me faktin se këtu në Kosovë është krijuar një grup i njerëzve të politikës të cilët janë bërë milionerë vetëm për një arsye, as për arsyen se këtë pasuri e kanë fituar me djersë apo në mënyrë të ndershme, as se këtë pasuri ua ka lënë baba, por për shkak se kanë pasur rastin të jenë në qeveri dhe në pushtet.

Po në vend që të forcohet drejtësia dhe këta njerëz të përballen me drejtësinë, këtu po ndodh pikërisht e kundërta. Goditja e parë drejtësisë iu dha me Ligjin skandaloz për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, meqë ligjit iu heq efekti retroaktiv, këta njerëz ia siguruan vetes paprekshmërinë e pasurisë së tyre marramendëse të krijuar deri në momentin e hyrjes të ligjit në fuqi.

Por kjo siç duket u mjaftoi këtyre njerëzve, sepse kjo ka të bëjë vetëm me mënyrën e krijimit të pasurisë e këtu problemet janë edhe tjera. Si t'ia bëjmë me uzurpimin e banesave dhe lokaleve, si t'ia bëjmë me haraçin dhe me reketin, si t'ia bëjmë me djegien

e arkivave të RTK-së? Si t'ia bëjmë me djegien e dokumenteve të AKM-së, të cilat e argumentojnë krimin e organizuar në Kosovë, si t'ia bëjmë me zhdukjen e provave të krimit në dhomat e dëshmimeve dhe si t'ia bëjmë me djemtë e politikanëve që rrahin policë?

Për të gjitha këto këta e kanë një zgjidhje shumë të thjeshtë, të gjitha këto krime duhet të amnistohen.

Nëse kjo ndodh, zonja e zotërinj, besoni që drejtësia dhe fjala drejtësi në Kosovë më nuk do të ketë kuptim.

Nëse kjo ndodh në vendin tonë, nëse kapërcen një ligj i tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, atëherë Qeverisë i mbetet vetëm edhe një gjë tjetër për ta realizuar.

Meqë po mund t'i bëjmë kaq kollaj këto 2/3 e deputetëve për Serbinë tash ka mbetur vetëm edhe ndryshimi i Kushtetutës dhe me 2/3 Kosova të shpallet nga Republika parlamentare në sulltanat të trashëgueshëm të PDK-së ku do të qeverisin nipat dhe stërnipat e tyre.

Nuk është se Lëvizja “Vetëvendosje” po thotë e vetmja që ky ligj e fundos drejtësinë në Kosovë. Kjo nuk është çështje partiake. Shumë organizata të shoqërisë civile kanë argumentuar në mënyrë shumë të qëndrueshme se ky ligj nuk bën të miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Bile edhe qytetarët po protestojnë jashtë në shesh duke kërkuar që zëri i tyre të dëgjohet.

Dëgjojeni një herë të vetme në jetën tuaj thirrjen e qytetarëve dhe të shoqërisë civile kundër këtij ligji.

Natyrisht se ky ligj i cili, ne në vend që këtu në Kuvend të Kosovës të miratojmë ligjet që e ndalojnë kontrabandën, këtu po miratohen ligje që i kontrabandojnë kriminelët. Dhe po ashtu, është për të ardhur keq se si në mënyrë krejt të papërgjegjshme shfrytëzohen raste të tjera të pjesëve të kombit shqiptar për ta barazuar luftën tonë çlirimtare e cila është zhvilluar edhe në Maqedoni, edhe në Luginë të Preshevës, për t'i barazuar dëshmorët tanë të kombit me kriminelë të veriut. Këtë e bëri edhe zoti Kuçi edhe zoti Selimi më herët. Kjo është e papranueshme. Kësaj është pak t' i themi gabim trashanik. Ky është përcaktim shumë i qartë antikombëtar.

Të thuash që Maqedonia e ka amnistuar Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare, prandaj ne po u dashka amnistuar kriminelët e veriut, kjo është një barazim me të vërtetë i pafalshëm dhe i pakuptueshëm. Ose mund ta kemi mirë ne si komb dhe i kemi zhvilluar luftërat çlirimtare e ato përnjëmend kanë qenë çlirimtare dhe kjo nuk mund të barazohet me atë që po ndodh në veri, sepse ata janë kundër sovranitetit të Kosovës, me veprime të tyre të qarta kanë qenë të kontrolluar prej Serbisë, e cila e lufton sovranitetin dhe lirinë e Kosovës, kurse ne luftërat i kemi bërë të drejta çlirimtare se përndryshe as nuk do t'i kishim nisur, as nuk do t'i kishim bërë fare. Kjo është heqje dorë prej atyre luftërave, heqje dorë prej dëshmorëve të kombit dhe deklaratë shumë e dëmshme që me thënë se

njëjtë siç janë amnistuar luftëtarët e luftërave tona çlirimtare do të amnistohen edhe ata të veriut.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Bajrami, e keni fjalën!

**ARSIM BAJRAMI:** I nderuar, nënkryetar i Kuvendit,  
Zëvendëskryeministër, ministra,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj se futja e institucionit të amnistisë në Kushtetutën e Kosovës është një e arritur për shkak se amnistia është një e drejtë kushtetuese e garantuar edhe me konventa ndërkombëtare.

Projektligjin që sot po e diskutojmë duhet ta vështrojmë nga këndi i nevojave të Republikës së Kosovës në luftimin e krimeve të ndryshme dhe në përpjekje për vendosjen e një shteti ligjor që është edhe një nga kriteret kryesore për integritet tona evropiane.

Në këtë segment unë mendoj se ne duhet këtë debat ta bëjmë krejtësisht racional dhe ta zhveshim nga sfondi patriotik dhe duhet të shohim e çka është interes shtetëror i Republikës së Kosovës të përfshihet në këtë moment, 5 vjet pas shtetësisë së Kosovës, çka është e nevojshme të përfshihet me Ligjin për amnistinë në një shtet ku s'është vendosur standardi i studimit të ligjit, në një shtet ku krimi nuk është në suaza normale të shteteve të Bashkimit Evropian dhe nga ky kënd të shohim se cili është interesi shtetëror i Republikës së Kosovës. Për shkak se instituti i amnistisë së bashku me institutin e faljes janë dy institucione penale shumë të rëndësishme, të cilat i praktikon çdo shtet, varësisht nga interesat e shteteve, sepse është interes i shtetit risocializimi dhe integrimi i çdokujt, edhe atij që ka bërë krime dhe ne duhet parë çka është interes i Republikës, a është një amnisti gjithëpërfshirëse çfarë është në ligj, apo është një amnisti e kontrolluar çfarë për momentin është interes i Republikës së Kosovës.

Kështu që unë, personalisht mendoj se projektligji që është i ofruar kërkon një rishikim substancial, kërkon një amendamentim substancial në mënyrë që ligji të vendoset në kontekstin e nevojave që ka, sepse nuk mund ne tash të bëhemi agjeneroz që të miratojmë një ligj me amnistinë me të cilin përfshijmë një numër të madh të veprave penale.

Të nderuar kolegë, kjo do të ishte një rrezik i madh për të cilindo shtet të Bashkimit Evropian, që nuk e kanë problem sundimin e ligjit, e le më për një shtet të ri i cili pretendon të bëhet një shoqëri ligjore dhe që ka shfaqur si prioritet luftën kundër krimit dhe kriminalitetit të organizuar. Mendoj se arrijmë efekte krejt kontraproduktive. Cili do të jetë motivimi ynë që të arrijmë standarde më të larta në luftimin e kriminalitetit në qoftë se ne vetëm 5 vjet bëhemi kaq gjeneroz? Kështu që unë mendoj se e tha ministri i Drejtësisë dhe zëvendëskryeministri që është plotësisht neutral, i hapur, në rishikimin e nenit 3 të Projektligjit dhe mendoj se zëvendëskryeministri duhet edhe ta rikonfirmoj këtë qëndrim në fjalën përfundimtare që neni 3 është plotësisht i hapur për rishikim, për amendamentim dhe le t'i lihet një diskutimi transparent, një diskutimi profesional në Komisionin e ligjeve dhe një debati publik që ne të shohim nevojat e Republikës së

Kosovës sa i përket kësaj amnistie të përgjithshme, sepse amnistia realisht është institucion që aplikohet në tri momente historike në çdo shtet. E para, në momentet e periudhave të pasluftës, gjë që ka munguar kur ka qenë në pyetje lufta çlirimtare; në momentet e arritjes së paqes, pjesë të marrëveshjes për paqe janë edhe amnistitë politike, amnistitë e padhunshme dhe në momentin e implementimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Tani projektligji ka rrëshqitur prej këtij misioni, ka rrëshqitur edhe për shkak të faktit se është dashur t'i shmanget diskursit se amnistia do të jetë selektive. Kështu që unë mendoj që ne në këtë drejtim kemi shumë punë në Komisionin e ligjeve dhe jam i sigurt që ligji kërkon rishikim substancial, kërkon një diskutim të hapur të gjitha partive politike në mënyrë që ne të arrijmë një konsensus se cili është interesi i Republikës së Kosovës në këtë fazë: a të amnistohet kriminaliteti ordiner, a të amnistohet kriminaliteti ekonomik e financiar që po e minon çdo ditë Kosovën, apo amnistia të jetë tipike siç aplikohet në të gjitha shtetet tjera - të jetë një amnisti politike, për aktet e padhunshme politike në mënyrë që ne të krijojmë një sistem, sistem të bindjes ligjore dhe kushtetuese në një pjesë të Republikës së Kosovës e cila nuk i është bindur Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. Dhe ne duhet të bëjmë krejtësisht racional të zhveshjeve edhe nga emocionet që zgjojnë këto debate dhe të shohim si deputetë çka është interes i Kosovës në këtë fazë.

Për shkak se unë mendoj se akt i mëshirës, akt i mëshirës së shtetit është falja e cila fatkeqësisht te ne s'po funksionon. Herë po funksionon jo mirë, herë po bllokohet krejtësisht. Në fakt, përmes faljes ekziston mundësia që secilit që ka arritur standardin e mundshëm për integrim të dobishëm në shoqëri, t'i falet dënimi, t'i zbutet dënimi, kurse amnistia duhet të ndodhë, të nderuar kolegë të nderuar një herë në 30 vjet, por atëherë kur ndodh duhet të ndodhë shumë kujdesshëm në mënyrë që të arrijë efektet e veta.

Unë po e ftoj edhe një herë Kuvendin e sidomos ministrin i cili ishte shumë korrekt në fjalën e vet që të rikonfirmohet edhe njëherë gatishmëria që ligji të amenamentohet substancialisht në Komisionin e Ligjeve ku ne duhet të kyçim profesionistë, edhe ata që kanë qenë pjesë e hartimit të ligjit, por edhe ata që s'kanë qenë dhe të gjitha partitë politike, të gjitha grupet parlamentare me një debat pak më të qetë, më racional dhe të shohim çka është interesi i Kosovës.

Për shkak se edhe pse kjo është një temë e cila bëhet në vigjilje të debatit që e kemi pasur rreth Marrëveshjes, unë po shoh se të gjitha grupet politike kanë problem me këtë qasjen gjeneroze sa i përket amnistisë dhe e pashë edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pati vërejtje serioze tek neni 3, siç patën edhe të gjitha grupet parlamentare. Nëse është kështu, atëherë Parlamenti le ta marrë përgjegjësinë që i takon me Kushtetutë, Parlamenti është organ ligjdhënës.

Qeveria e ka nisur këtë nismë, por Parlamenti le të vendoset në funksion kushtetues dhe ta riparojë ligjin, për shkak të detyrimeve ndërkombëtare nuk mund të kërkojmë që ligji të tërhiqet. Por, nëse neve zëvendëskryeministri na thotë se unë jam i hapur, jam shumë në rregull të bashkëpunoj me Komisionin që të rishikohet, sidomos neni 3, pjesërisht edhe neni 5, ka gjëra që nuk duhet të jenë në nenin 5, ka të aktet që atje po na fshihen për

amnisti dhe që nuk duhet të parashihen për amnisti, sepse nuk parashkruhen ekonomike në veri, nuk parashkruhen disa krime të tjera aksesore.

Atëherë, ne do të kemi një siguri më të madhe si Parlament që ligji do të bëhet me standarde ndërkombëtare. Ligji duhet, më duhet ta sqaroj, sepse e dha sqarimin shumë mirë nënkryetari, më duket kolegja Lama e bëri pyetjen, ky është një ligj i rëndomtë, i cili kalon në dy lexime dhe i cili i nënshtrohet procedurave të rregullta të amendamentimit dhe unë po besoj që Komisioni Legjislativ menjëherë do të merret me këtë ligj.

Kam biseduar edhe me kolegun Gashi, me të cilin kemi qenë jashtë vendit në kohën kur është diskutuar, por mendoj se ne duhet të bëjmë menjëherë një agjendë dhe të fillojmë të punojmë, që të vihet një amendamentim substancial, në mënyrë që ky ligj të bihet me standarde ndërkombëtare dhe Kosova ta bëjë një ligj të qëndrueshëm. Pra, një ligj i cili realizon detyrimet që kemi marrë si Parlament, karshi ratifikimit të Marrëveshjes ndërkombëtare, por nuk krijon efekte të dëmshme për drejtësinë penale, për drejtësinë tranzicionale, por na siguron që jemi brenda standardeve ndërkombëtare, sepse askush nga bashkësia ndërkombëtare nuk po e kërkon këtë prej nesh, nuk po kërkon që ne tani të bëjmë gjëra që s'i bëjnë ata në shtetet e tyre.

Duhet të jemi të kujdesshëm që të mos krijojmë pritje të paarritshme për qytetarët. Unë i kuptoj emocionet e qytetarëve, por interesi i shtetit, interesi i Republikës është mbi të gjitha dhe ai nuk duhet të dëmtohet, nuk duhet të dëmtohet për individin apo për grupet e interesit apo për grupet e presionit dhe ne se deputetë jemi të thirrur në këtë organ kompetent që të mbrojmë këtë interes shtetëror, në mënyrë që të jemi në detyrë të përgjegjësive dhe detyrës kushtetuese që kemi. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit!

Do të mundohem ta parafrazoj ministrin dhe t'i nxjerr edhe në pah ato çka i tha në fjalën e tij të fillimit. Ky ndoshta nuk do të pret, por megjithatë në ndonjë pikë edhe mund të dakordohemi, por me motive të ndryshme.

Ministër,

Ju thatë, që ky ligj apo deputetët nuk do të duhej t'i trembeshin miratimit të këtij ligji. Po, pikërisht këtu është problemi, ndoshta ka deputetët që do të duhej të trembeshin dhe ju po ia hiqni atë frikë. Dhe po ashtu, zoti ministër, ju thatë që nuk ka parti politike që nuk u ka premtuar amnisti të burgosurve politikë.

Tash, nuk e dimë a është edhe ky një premtim që e keni bërë dhe, nëse e keni bërë këtë premtim kur e keni bërë dhe a e keni bërë në vendin që më së shumti ia dedikoni këtë amnisti për veri?

Por, nuk do të mund të pajtoheshja që kjo amnisti do të duhej t'i atribuohet, siç thotë Qeveria në rast të kohës së siç u quajt "pas konflikteve". Ne nuk jemi tashmë në kohën postkonfliktuale dhe po ashtu jemi në një periudhë që së paku Lufta Çlirimtare që është

bërë në Kosovë nuk do të quhej nga Qeveria si “konflikt”, por do të duhej t’i referoheshim si luftë.

Pra, në këtë rast, nuk do të duhej t’i referoheshim që amnistia po bëhet në raste postkonfliktuale, sepse këtu po bëhen dy gabime:

E para, lufta e UÇK-së, lufta e popullit shqiptar të Kosovës, nuk po konsiderohet në këtë rast si luftë, por si konflikt dhe e dyta, që është më e rëndësishmja, nëse është në kohën e pas konfliktit, po bëhet amnistia për veprat që i kanë bërë gjatë konfliktit apo pas konfliktit, për shkak se nuk po merret vesh? Si në kohën pas konfliktit, siç i referohet Qeveria këtu, po bëhet amnistia dhe amnistia po bëhet për kohën jo të konfliktit.

Nëse bëhet amnisti për kohën çfarë kanë bërë ata njerëz në kohën gjatë konfliktit, që ne e quajmë luftë, gjatë luftës, atëherë le të referohen se po bëhet amnisti për ata çfarë kanë bërë gjatë luftës dhe do të dihet çka t’ ju falim. Por, ky është gabimi i dytë, që unë e kam hasur dhe jo i fundit.

Kolegu deputeti Behar Selimi në kohën kur iu drejtua Kuvendit edhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit për Legjislacion, por edhe në cilësinë e tij personale dhe në cilësinë e tij si deputet i PDK-së tha që kjo amnisti mund të pasojë edhe me amnistinë e mundshme, që mund të bëjë Serbia ndaj listës së emrave, nëse kam mundur ta parafrazoj shumë mirë, listës së emrave që Serbia e ka dërguar në Interpol. Pra, nëse ka qenë kështu për afërsisht.

Pra, nuk e di a ka menduar mirë kolegu Selimi apo s’e ka menduar, por ka shumë edhe njerëz që janë këtu deputetë, që janë në atë listë emrat e deputetëve që janë në atë listë. Në mesin e tyre jam edhe unë, që Serbia i ka dorëzuar Interpolit si njerëz të kërkuar dhe kurrë nuk do të doja që Serbia të ma falte, të më amnistonte, atë çfarë kam bërë gjatë kohës, për shkak se unë nuk i kërkoj falje Serbisë dhe rrjedhimisht përderisa nuk ndihem fajtor, s’ka edhe çka të më amnistoj.

Pra, nuk do të duhej as të nxirren në këtë kontekst që ky ligj paska edhe këtë përfitim, të cilin unë nuk do ta konsideroja si përfitim. Dhe, në anën tjetër, nëse është ky reciprociteti i PDK-së le ta thonë përballë Serbisë, por nuk do të duhej që PDK-ja ta kishte këtë lloj reciprociteti përballë Serbisë, duke amnistuar krimin që ka ndodhur brenda territorit të Republikës së Kosovës në kohën e pasluftës dhe duke kërkuar amnisti për ata të cilët Serbia akoma i mban në listat e veta dhe si të tilla ia jep Interpolit.

Nga falja apo amnistia e mundshme, mendoj që ka përfitim edhe Qeveria. Nëse parashihet që me këtë amnisti, në këtë rast amnistia, të kishte edhe amnisti edhe mashtrimi, normalisht që do të amnistohet dhe do të përfitonte Qeveria dhe Partia Demokratike e Kosovës, për shkak se pikërisht ky është një ndër aktet që ka bërë Partia Demokratike e Kosovës edhe përballë votuesve dhe do të kërkonte të përfitonte me amnisti.

Po ashtu, nëse është tentuar që me këtë ligj për amnistinë të falej edhe spiunazhi, këtu do të përfitonte SHIK-u, për shkak se SHIK-u ka ushtruar një aktivitet spiunazhi edhe gjatë



kohës së pasluftës. Por, nëse do të kalonte ky ligj dhe do të amnistohet në këtë rast kontraktimi i përfitimit jo proporcional material, atëherë do të përfitonin këto të dyja.

Por, më lejoni të kthehem edhe njëherë në temë. Ne jemi kundër për shkak se mendojmë që kjo lloj amnistie e krimit në kohën përderisa ndodhë krimi, atëherë kjo nuk është amnisti, por është stimulim për krimin.

E dyta, amnistia pa gjyq sikur pretendohet të bëhet këtu, është i barabartë pothuajse edhe me dënimin pa gjyq dhe në këtë rast, falja e krimit e dëmton viktimën. Njëkohësisht, amnistia nga ndjekja penale është drejtpërdrejt heqje dorë nga drejtësia dhe kurrë nuk do të duhej që ne të heqim dorë paraprakisht nga drejtësia, për të bërë amnistinë, sepse nuk ka amnisti pa drejtësi. Amnistia do të duhej ta pasonte drejtësinë, nëse ka ndodhur ndonjëherë në këtë vend.

Mendoj që është bërë edhe një tendencë për manipulimin e fatit të njerëzve, të cilët sot janë të dënuar, të cilët tash në këto momente po na dëgjojnë nga greva e tyre që janë në Burgun e Dubravës. Mendoj që nuk do të duhej, së paku të manipulojë as me ndjenjat dhe as me fatin e tyre, për shkak se atyre iu është thënë që ju do të përfitoni nga kjo amnisti dhe nuk besoj që ndonjëri ndër ata të cilëve rrjedhimisht u takon drejtësia, u takon edhe amnistia deri në shkallën çfarë atyre u takon, nuk do të duhej që këtë drejtësi ne t'ua ofrojmë atyre me logjikën e katapultimit të votimit të këtij ligji, përmes fatit të tyre. Pra, edhe ata nuk do të duhej të pranojnë që të barazoheshin me krimin dhe njëkohësisht, as të faleshin në këtë rast, nga Qeveria barabar me kriminelët.

Amnistia atyre u takon, por jo duke qenë çmim edhe falja për krimin që ndodh në Kosovë. Kosova rrjedhimisht ka nevojë për Ligjin për amnisti, për një ligj shumë të mirëfilltë, por nuk ka nevojë që të heqë dorë nga drejtësia, sepse nuk do të duhej të zëvendësohet e drejta për amnisti me heqje dorë nga drejtësia, respektivisht me padrejtësi.

Në këto momente kur ne po flasim, nëse do të ishte e sigurt që ky ligj do të kalonte, atëherë rrjedhimisht edhe Kosova është për momentin “zonë e lirë e krimit”, për shkak se cilido do të mund të kryente një krim sot duke ditur që nesër do të amnistohet.

Mbyllja e gjykatave dhe e burgjeve, sipas kësaj logjike do të ishte rrjedhë logjike pas aprovimit të këtij ligji për amnisti, për shkak se një rresht kaq i madh i faljes së krimit është thjeshtë tendencë për ta riformatizuar gjithë atë çfarë po ndodh në Kosovë, për t'ua kthyer në pikën zero dhe rrjedhimisht, nuk është ndihmë për drejtësinë.

Shqiptarët dhe të gjitha nacionalitetet tjera në Kosovë, në këtë rast kanë nevojë për drejtësi, por kjo nuk është drejtësi për shkak se me një falje të krimit vetëm sa po simulohet krimi, prandaj ne e kundërshtojmë këtë heqje dorë nga drejtësia dhe rrjedhimisht, kërkojmë drejtësi, gjë që nuk e shohim në Ligjin për amnisti që ka ofruar Qeveria e Kosovës sot për miratim.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Replikë, zoti Xhelili.

FATMIR XHELILI: Në fjalën time, më herët thashë se nuk ka nevojë për amnisti të SHIK-ut, as personalisht për mua, por tash po them për SHIK-un. SHIK-u ka kryer një detyrë kombëtare dhe ka ushtruar aktivitet të vet, krejt duke iu përmbajtur parametrave ligjor. Disa deputetë këtu që kanë fituar zgjedhjet duke përmendur SHIK-un dhe duke folur fjalë të këqija për SHIK-un, mendojnë që tash ka filluar fushata zgjedhore, prapë të fillojnë me avazin e vjetër për të folur keq për SHIK-un, e për të mundur t'i fitojnë votat, apo është ndonjë xheloz ndaj ish-pjesëtarëve të SHIK-ut, që me të vërtetë kanë kontribuar deri te arritja e qëllimit final të shpalljes së Pavarësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Pa tendencën për t'u përballur me kolegun Xhelili në kundër replikën time, ai tha që SHIK-u ka kryer punë ligjore. Pikërisht këtë gjë e kemi kërkuar sa e sa herë, se kush ka qenë baza ligjore e aktivitetit të SHIK-ut dhe do të doja, që së paku kjo të merrej si përgjigje ose si fillim i një përgjigjeje, për të cilën ne kemi kërkuar tash e sa ditë. Dhe njëkohësisht, nëse SHIK-u ka kryer punë të tjera dhe nuk e ka pasur në agjendën e vet, në punën e vet, në manualin e vet ditor spiunazhin, atëherë le të na thotë që nuk ka bërë spiunazh.

Thjesht, SHIK-u si organizatë e tillë edhe spiunazhin e ka pasur metodë të vetën dhe do të duhej ta argumentoni të kundërtën.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga AAK- ja, fjalën e ka zoti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Shkurtimisht, nuk po dua t'i përsëris shumë prej këtyre që u thanë deri më tash prej kolegëve deputetë, por definitivisht besoj se ky draftligj ka disa të meta vërtet të mëdha, ose disa probleme madhore, për ta kaluar në këtë formë sikurse është tash.

Dhe, po filloj prej elementit të parë sipas bindjes sime, që është një lloj tendence për balancim edhe fshehje të qëllimit politik i cili po besoj për të gjithë neve është i qartë, se është akomodimi ose integrimi i pjesës veriore të Kosovës, i cili si qëllim është definitivisht i qëndrueshëm dhe i nevojshëm.

Elementi i dytë, pra nuk ka nevojë, thjesht nuk ka nevojë për një lloj fshehje të tillë ose një lloj frike, që ta themi tepër direkt.

Elementi i dytë, në bindjen time është se mungojnë parimet e qartësuara, mbi të cilat po ndërtohet ky draft-ligj dhe qëllimet e qartësuara politike, mbi të cilat është ndërtuar ky draft-ligj. Një element që është tepër i rëndësishëm, që është parim në amnistitë dhe kjo është edhe në dokumentet që OKB-ja i ka nxjerr si udhëzues të përgjithshëm për amnistitë nëpër botë, është që asnjë qytetarit nuk guxon t'i hiqet e drejta që ta ketë një mjet juridik.

Një mjet juridik, të cilin mund ta përdorë dhe kjo është po ashtu e precizuar qartë edhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, fundamentale të Njeriut. Kjo konventë po ashtu, ka supermaci në aspektin e provizioneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës kjo konventë, saktësisht përmendet si pjesë e asaj që njihet si e drejta për mjet juridik ose për korrigjime.

Nuk po dua t'i listoj shumë vepra të cilat janë paraqitur, pavarësisht se në draftligj paraqiten si vepra të cilat do të falen deri në 20% dhe jo sikurse është dhënë në opinion, besoj se është manipuluar dhe spekuluar në opinion, se do të jetë 100% dhe të gjitha veprat e tilla do të falen ose do të amnistohet, ko sipas draftligjit është në 20% , por vërtet janë të pakuptueshme.

Besoj që vjedhja nuk mund të amnistohet, nuk ka pse të amnistohet, as vjedhja e shtëpive, as vjedhja e veturave, as thyerja e veturave për të vjedhur elemente. Si amnistohet? Pse duhet të amnistohet?

Shtrengimi, haraçi, është totalisht e pakuptueshme që në vend se atyre njerëzve t'u rritet dënimi me Kodin Penal, e dimë ne kemi qenë mjaft entuziastë kur kemi thënë se ky Kodi i ri Penal parasheh masa më të mëdha për ata që bëjnë vepra penale, ndërkohë, që shtrengimi tash paraqitet në këtë nenin 3 për ulje të dënimit në 20%. Kontraktimi i fitimit joprofesional ose përgjithësisht ku futen fajdetë, nuk ka kurrfarë logjike. Vjedhja e shërbimeve komunale, prezantimi i rrejshëm, rrezikimi i komunikacionit, për shembull, janë dy vepra penale të cilat lidhen me rrezikimin e komunikacionit. Tash, paramendoni për ta bërë krejt më banale, sepse rasti është banal.

Nëse është 50 kufizimi i shpejtësisë dhe një qytetar ka vozitur 60, dënohet, se është kundërvajtje, ndërkohë nëse ka vozitur 120, amnistohet. Domethënë, kjo të paktën në bindjen time, s'ka kurrfarë kuptimi. Ajo që shihet, besoj se prokurorët jo punëtorë që i kemi në Kosovë të çlirohen prej ngarkesës që e kanë pasur, për punën që s'e kanë bërë deri tash, për punën që është dashur ta bëjnë.

Thjesht, kjo në njëfarë forme, mund të jetë si nisje prej fillimit, një rinisje e gjithëçkahit, të cilën në bindjen time ka pasur periudhë më herët, ndoshta kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës do të ishte momenti më i mirë që të ketë këso rinisje, por jo definitivisht tash.

Ajo që në përgjithësi edhe në fund po dua ta them si pyetje, kryesisht për zotin zëvendësministër Kuçi, e tha tepër qartë, se është i gatshëm që t'i marrë të gjitha vërejtjet e deputetëve dhe të gjitha këto të hiqen. Pyetja imë është, pse janë përfshirë, pse është dashur të përfshihen, që tash të vini e të thoni: "po mirë, hiqini" Cila është arsyeja pse janë përfshirë?

Besoj se arsyetimi që u dha në fillim i tendencës për balancimin e këto janë të paqëndrueshme. Tash nëse jeni i gatshëm edhe besoni që është mirë të hiqen për shkak se

përafërsisht të gjitha grupet parlamentare po e thonë këtë, arsyeja pse kanë hyrë besoj që është pyetja e cila kërkon përgjigje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj për amnisti në thelbin e tij ka dy nene, nenin 3 dhe nenin 5. Pa dashur t'i përsëris të gjitha ato që i thanë parafolësit e mi, e në veçanti ato që i tha deputeti Xhelili, sidomos ato pika që janë të përfshira në nenin 3.

Meqenëse shumica e pikave nga neni 3 janë paradoksale dhe të papranueshme, për një shtet që pretendon të luftojë krimin dhe të zbatojë ligjin, unë mendoj se do të kishte qenë mirë që të mos ekzistojë fare neni 3 dhe propozoj të hiqet nga Projektligji për amnistinë.

Ndërsa, propozimi i nenit 5 i këtij Projektligji për amnistinë del nga Marrëveshja politike në Bruksel, prandaj e mbështes edhe unë, sepse ligje të tilla kanë miratuar edhe shtetet në rajon e më gjerë. Nenin 3 nuk do ta përkrah në leximin e dytë, ndërsa për nenin 5 e jap votën.

Edhe njëherë e ftoj Kuvendin, që ta votojë nenin 5 dhe t'i hapë rrugë amendamentimit të tij gjatë shqyrtimit në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Normalisht, amnistitë kudo në botë bëhen për motiv humanizmin. Dhe, kjo ndodhë kryesisht në vendet ku ndodhin ndryshimet shoqërore dhe këto ndryshime shoqërore përcillen me amnisti, pasi që edhe të dënuarit dhe shkelësit e ligjit trajtohen si viktimat e sistemit.

Pra, me vetë ndryshimet që ndodhin shteti mban përgjegjësi dhe tërhiqet nga e kaluara, e cila u ka krijuar kushte individëve që të bëjnë krime dhe të bëjnë shkelje. Dhe, rrjedhimisht ky është ai motivi human, ku shumëkush që ka bërë shkelje deri edhe te krimet, lirohet pjesërisht me përqindje të caktuar për atë që e ka bërë dhe kjo gjithmonë lidhet dhe është derivat i ndryshimeve, që ndodhin në një vend.

Edhe ky Ligji për amnistinë që po e trajtojmë është pasqyra e marrëveshjes rrjedhimisht, pasqyrë e ndryshimeve që kanë ndodhur në vendin tonë me këtë ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Pra, deputetët të cilët e kanë ratifikuar Marrëveshjen dhe e kanë bërë këtë marrëveshje tash të ratifikuar, njëkohësisht janë ata që e kanë sjellë edhe këtë, kanë hapësirën që të vijë edhe ky Projektligj për amnistinë.

Pra, shteti në njëfarë mënyre kur bën amnistinë e mban përgjegjësinë për periudhën që ka kaluar. Kërkon falje për atë që kohë më parë e ka krijuar hapësirën që të ndodhin krimet dhe jo larg nga kjo duhet shikuar edhe ky projektligj për amnistinë sot.

Por, sot kur po flasim këtu kemi një aspekt të diskutimit, ku neni 3 po bëhet temë diskutimi dhe përmes nenit 3 po kamuflohet komplet Projektligji për amnistinë. Pra, nga njëra anë pranohet neni 5 dhe bëhet diskutabil neni 3. E, çka ka neni 3 e çka ka neni 5, ku është dallimi në mes këtyre dyve? Nëse flasim për humanizmin dhe për aspektin human të amnistisë, atëherë kjo lidhet me nenin 3, nëse flasim për krimet e bëra, të cilët i bëjnë individët individualisht, pra ka të bëjë kjo me nenin 3.

Neni 3 lidhet me individët, ndërsa neni 5 lidhet me strukturat. Krimet të cilat përfshihen, shkeljet të cilat përfshihen në nenin 5, janë shkelje të cilat kryesisht i bëjnë strukturat e organizuara, ndërsa te neni 3 janë individët.

E për shoqërinë, shumëfish më të rrezikshme janë dëmet dhe krimet, të cilat i bëjnë strukturat, se sa individët. Dhe, ne tash këtu po flasim për hajnat e vegjël, mund të flasim për ndonjë vrasës aty-këtu, i cili ka mundur të jetë pasojë e sistemit dhe ai nuk trajtohet, sepse trajtohet si kriminel, ndërsa strukturat të cilat kanë nxitur dhe krijuar vrasje në veri apo kanë bërë kontrabandë, këtu ato jo që amnistohen me përqindje, por ato falen krejtësisht. Dhe, çka ndodh këtu? Tash, këtu po flitet për nenin 3, sepse neni 5 na qenka disi i padiskutueshëm, ai po u dashka të pranohet kështu si është!

Pra, flitet se si nuk paskan për t' u amnistuar vrasësit e Enver Zymberit dhe Selver Haradinajt e nga ana tjetër amnistohen strukturat, të cilat i kanë vrarë po të njëjtit. Kush po mbetet fajtori këtu? Po mbetet një individ, të cilin po qe se e kapëm, nuk do t'ia falim a apo?

Po amnistojmë komplet strukturën dhe po e fajësojmë, po e arsyetojmë këtë farë pune, që nëse rastësisht ne ndonjëherë do ta zëmë vrasësin e Enver Zymberit apo të Selver Haradinajt, e ata ne nuk do t'ia falim! E njëjta gjë vlen edhe për të tjerat.

Nga deputetët e LDK-së më herët u tha se ne do ta përkrahim nenin 5, po do ta amendamentojmë asisoj, që vrasësit për vrasjet e pasluftës nuk do të amnistohen. Edhe njëherë po e them, kjo është e njëjta gjë, sikur për situatën në veri. Po amnistohet struktura dhe nëse amnistohet struktura dhe krejt kjo kamuflohet me një doras, që po qe se e gjetëm diku, atëherë atë nuk do ta falim, atëherë kjo është komplet në kundërshtim me logjikën dhe retorikën e deritanishme që e ka bërë ky subjekt.

Pra, pse duhet tash të amnistohen strukturat, është çështja tjetër? Pse shteti do që t'ia amnistojë strukturat e nuk e çanë fort kokën a ndoshta do të duhej të amnistoheshin individët, të cilët sot vuajnë burgun për krime të caktuara ordinere në Dubravë? Sepse, strukturat në krimin e vet të organizuar janë ato të cilat takohen me shtetin, nuk janë individët. Dhe, janë strukturat të cilat i shfrytëzojnë hapësirat të cilat ua krijon shteti dhe pushtetet, që të mund të ekzistojnë ato si të tilla. Pra, strukturat ekzistojnë meqë gjejnë hapësirë tek pushtetet. Dhe, natyrisht që këtu tash pushteti drejtpërdrejt në njëfarë mënyre

është i rrezikuar edhe nga vetë këto struktura, sepse për të ekzistuar ato është dashur të bashkëpunohet me to.

Po u hetuan strukturat mirë, ato çojnë edhe në pushtet, prandaj, duhet amnistuar strukturat, sepse kësisoj pritet rruga deri tek pushteti. Dhe, e tëra kjo nuk është e paqëllimshme dhe e tëra, në fakt nuk bën asgjë tjetër, përpos krimin e organizuar e bën përjetësi në Kosovë, përderisa të ekzistojë kjo logjikë kësisoj me këto ligje të amnitive dhe me këto marrëveshje politike, të cilat janë. Ju faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Unë ju njoftoj që janë edhe 7 diskutues, u bë i teti, në qoftë se dëshiron dikush të paraqitet për diskutim, le të paraqitet që të mos paraqiten në fund, me qëllim që ta caktojmë një orë, orën 17:00 për votim dhe deputetët të jenë në sallë, meqenëse duhen 2/3-at, ata që duan të jenë. Tani u bënë 10 diskutues. Mendoj që 10 diskutues nga 10 minuta bëjnë 100 minuta. E lëmë orën 15:30 për votim. Në orën 17:00 le të jenë deputetët këtu, e pastaj në qoftë se zgjatet edhe pak, s'prish punë. Fjalën e ka zoti Arben Gashi.

**ARBEN GASHI:** Të nderuar kolegë deputetë,  
Ne sot kemi një vendim të rëndësishëm para nesh, për të cilin duhet të vendosim dhe për të cilin janë bërë shumë spekulime, spekulime dhe diskutime deri edhe në akuza dhe kërcënime, për disa edhe personale. Dhe, sidomos anatemi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anatemi i paarsyeshëm dhe bartje e përgjegjësisë në një mënyrë të palogjikshme, në mënyrë të qëllimshme tek Lidhja Demokratike e Kosovës.

Unë po e marr guximin sot, që të jap disa nga fragmentet e diskutimeve në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të shqetësimeve, që aty janë përballur. Aty ka pasur një shqetësim me perceptimin e krijuar se me këtë amnisti ne po japim amnisti për njerëzit të cilët kanë kryer vrasje në Kosovë, për njerëzit që kanë kryer dëmtime trupore në Kosovë, për njerëz të cilët kanë vrarë njerëz të pafajshëm në Kosovë. Kjo nuk është e vërtetë.

Dhe, për këtë arsye Lidhja Demokratike e Kosovës ka propozuar amendament pas nenit 5 të futet neni 6, i cili thotë se veprat penale kundër trupit, jetës dhe shëndetit nuk janë objekt i këtij ligji. Pse ka ndodhur kjo?

Në diskutim po jap edhe disa elemente të rëndësishme, të cilat janë bërë aty. Ka pasur deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, të cilët janë personalisht të dëmtuar, para, gjatë apo pas luftës dhe pasojat e atyre dëmtimeve fizike apo lëndimeve trupore i bartin edhe sot. Ata kanë thënë se janë të gatshëm që pasojat që i bartin vetë, t' i falin, por nuk mund t' i falin njerëzit e idealit të cilët janë vrarë, nuk mund t' i falin njerëzit e idealit të cilët janë masakruar për idealin që e kanë pasur, për besimin në demokraci, për besimin në shtetin e së drejtës. Për këtë arsye ne kemi kërkuar që amendamenti i cili parasheh, që të mos amnistohen edhe pse nuk parashihen, të jemi korrekt, nuk parashihen në Ligjin për amnistinë, mirëpo për shkak që të jemi më eksplisit, për shkak të krijimit të perceptimit, ne kërkojmë që të jemi eksplisit që veprat penale kundër trupit, jetës dhe shëndetit nuk amnistohen.

Ky ka qenë qëllimi, të cilin ne e kemi thënë, sepse ka njerëz që janë prekur personalisht, ka njerëz që familjarë të tyre janë vrarë, ka njerëz bashkëluftëtarë të cilëve janë vrarë, për shkak se kanë hetuar vepra të rënda kriminale në Kosovë. Ka njerëz bashkëluftëtarë të cilëve janë masakruar në Kosovë, sepse kanë hetuar krimet e organizuara që janë bërë në Kosovë, sepse kanë hetuar krimet e organizuara ndaj njerëzve të cilët kanë besuar në liri, ndaj njerëzve, të cilët kanë besuar në vlera të kësaj shoqërie demokratike.

Prandaj, ne kemi vendosur që të kemi guxim dhe të marrim vendim. Të marrim vendim, mirëpo vendimi jonë të jetë vendim i arsyeshëm dhe në interes të shtetit dhe të mos falet asnjë vepër penale, apo të amnistohet asnjë vepër penale kundër trupit, jetës dhe shëndetit edhe pse, po e përsëris, nuk është objekt i këtij ligji.

Po ashtu, ka pasur një qëllim tjetër Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar edhe një amendament tjetër, i cili ka të bëjë me nenin 3 të ligjit, i cili kërkon që të hiqet neni 3 fare, sepse është krijuar perceptimi i rrejshëm te qytetarët, se reketimi, kërcënimi, vrasja nga pakujdesia, e tjera, amnistohen. Aty flitet për një amnisti rreth 20% për këto lloj veprash penale, mirëpo për shkak të perceptimit të krijuar, ne duhet ta heqim fare dhe neni 3 të mos ekzistojë. Dhe, të shohim edhe disa elemente tjera.

Njerëzit që kanë abuzuar me pushtetin dhe shtetin dhe në kuadër të pushtetit dhe shtetit kanë përfituar grupe të caktuara kriminale ose jo kriminale, individë të caktuar kanë bërë përfitim duke abuzuar me shtetin dhe pushtetin, as ata të mos amnistohen. Dhe, këto janë elementet mbi bazën e të cilave ne sot angazhohemi, këto janë elementet mbi bazën e të cilave ne kërkojmë që të jenë pjesë substanciale e këtij ligji dhe këto janë kushtëzimet, mbi bazën e të cilit ne e përkrahim këtë ligj.

Prandaj, unë dola këtu që të marr fjalën sot dhe të garantoj të gjithë njerëzit e mirë të këtij vendi, se ne nuk kemi për qëllim ta amnistojmë askënd, e përsëris askënd, që ka kryer veprën penale kundër trupit, jetës dhe shëndetit të njeriut. Nuk amnistohen dhe nuk janë objekt i amnistisë së këtij ligji dhe nuk duhet të jenë. Dhe, po ashtu elemente tjera të rrezikshme ne do t'i ndalojmë, ju kam thënë edhe në seancën e kaluar kur e kemi ratifikuar marrëveshjen, se ne jemi këtu për të garantuar interesin e qytetarëve të Kosovës dhe ju them edhe sot, se ne jemi këtu për të garantuar interesin e qytetarëve të Kosovës dhe do ta bëjmë detyrën tonë me nder. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Halit Krasniqi e ka fjalën.

**HALIT KRASNIQI:** Faleminderit, kryesues!

Jo, unë isha në emër të grupit parlamentar dhe aty paraqita gjithë gjendjen, debatin që ka qenë brenda grupit parlamentar edhe shqetësimeve, të cilat janë manifestuar gjatë mbledhjes së fundit dhe mbledhjeve tjera, që kemi pasur për këtë ligj dhe nuk kam pasur rastin që t'i shfaq mendimet e mia, të gjitha ato mospajtime, shqetësime kanë qenë të grupit parlamentar, nuk kanë qenë personalisht të mijat. Dhe madje, aty ka pasur edhe më shumë se sa unë i përshkrova, se edhe një pjesë e grupit parlamentar atakohen nga ky ligj, që do të bëhet dhe një pjesë që e

konsiderojnë veten të dëmtuar kanë qenë mjaft të argumentuar në arsyetimet e tyre gjatë debatit që kemi pasur brenda.

Unë personalisht tash do shfaq shqetësimet e mia, një pjesë nga këto i kam numëruar në Komisionin e Legjislacionit dhe natyrisht që një pjesë tjetër pastaj e kam thënë edhe për media, përkatësisht për një televizion që e di se është emetuar dhe edhe në këtë debat tash nuk mund t'i fsheh shqetësimet e mia.

Amnistia si institut është i njohur dhe i pranuar dhe edhe ne nuk e nënçojmë dhe nuk e përjashtojmë, por ajo duhet të ketë kritere edhe duhet të diskutohen cilat duhet të jenë ato kritere.

Neni 3 i amnistisë duhet të rishikohet në Komisionin, në grupet punuese, por në qoftë se s'arrijmë konsensus të përbashkët edhe po ta lëmë për një rast tjetër, ndoshta do të ishte më mirë dhe do të krijonte siguri për qytetarët dhe jo të kundërtën e asaj që ne dëshirojmë.

Por, në rast se ne vendosim për ta hequr nenin 3, nuk mund ta lëmë nenin 5 pa një ndërhyrje që nga fillimi. Në nenin 3 thotë: të gjithë kryerësit e veprave penale në vijim, të kryera deri më 20 qershor 2013, e tjera, e tjera.

Domethënë, nëse ne shkojmë pa i ndryshuar nenin 3 dhe nenin 5, ose nëse e heqim nenin 3 dhe nuk bëjmë ndryshime, ndërhyrje në nenin 5, atëherë do të krijojmë një konflikt, do të krijojmë një paradoks dhe do të krijojmë një përçudnim të shtetit ligjor, sepse njëri prej atyre që na krijon shqetësime është asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, zjarr vënia.

Në qoftë se ne nuk e përcaktojmë kohën, për cilën kohë i amnistojmë këto veprime të paligjshme dhe këto vepra penale, atëherë mund të nënkuptohen që edhe zjarr vënia edhe asgjësimi e dëmtimi i pasurisë gjatë luftës përfshihen në këtë, sepse s'ka kufizim. Ky nuk është qëllimi i Ministrisë, ky nuk është qëllimi i Ligjit për amnisti, por në qoftë se nuk e themi qartë, në mënyrë eksplicite dhe nuk e qartësojmë, lëmë mundësinë që të keqinterpretohemi dhe të keqkuptohemi dhe natyrisht, që të mos e ketë funksionin e vet ky ligj, përkundrazi ta ketë të kundërtën e kësaj.

Madje, unë për veten time, jam për ta ndarë edhe territorialisht, ashtu siç ministri shumë hapur, në mënyrë transparente e arsyetoi që ai nuk ishte për ta ndarë zbatimin e këtij ligji në aspektin territorial, por ne për të shpëtuar nga ky debat i brendshëm që kemi, nga këto shqetësime që kemi në mes nesh dhe nga shqetësimet reale që janë në publik, do të duhej që të plotësojmë një kriter nga marrëveshja që kemi me Serbinë. Dhe, kjo kërkohet që për qytetarët e Kosovës ne veri, prej pasluftës e këndeje që kanë bërë vepra penale, të përshkruara në nenin 5 dhe të tjera, që mund t'i propozojmë, të hiqen nga ndëshkimi, nga ndjekja për arsyen se ata tash duan të bëjnë marrëveshje, pakt me shtetin e ri të Kosovës dhe të jetojnë të lirë dhe pa shqetësime në të ardhmen.

Nëse është kjo, unë për veten time, jam dakord që kjo të bëhet dhe neni 5 të kalojë në unanimitet të përbashkët të gjitha grupeve parlamentare këtu dhe pastaj ne në një kohë



tjetër, dalëngadalë ta përpunojmë nenin 3 dhe edhe për këto vepra penale për amnistim, që i parasheh neni numër 3, të rishikohen, të plotësohen ose një numër sosh të hiqen fare.

Por, ngaqë Ligji për amnistinë është produkt dhe kërkohet që të plotësohet për marrëveshje me Serbinë, një nga kriteret e marrëveshjes, atëherë të shkojmë edhe në mënyrë territoriale dhe t'u themi hapur qytetarëve tanë se ne po amnistojmë qytetarët të kaq komunave, këtyre komunave në veri të Kosovës, për arsyen e caktuar, se duam të bëjmë marrëveshje dhe pakt me ata qytetarë, të cilët kanë qenë të shtyrë nga Beogradi dhe ata tash duan ta njohin Republikën e Kosovës dhe duan t'i zbatojnë ligjet në të ardhmen.

Unë për veten time, do t'u them, do t'ju kujtoj se çka kam shkruar para 23 vjetësh. Tekstualisht, telegrafikisht po lexoj shumë shpejt. Është: "idealin tonë të lirisë nuk mund ta shtypë asnjë dhunë". Është në shtypin periodik të Prishtinës që ka qenë dhe që lidhet me këto shqetësime. "Terrori policor në Kosovë po shkallëzohet çdo ditë. Dhuna është ngritur që kur në sistem, ajo zbatohet të mbrohet nga "shteti juridik", i cili rrahë, vret e vjedhë, plaçkitë natën e ditën. Pasiguria është rritur dhe tashmë shqiptari maltretohet, të rrihet e të vritet për të vetmin faj, se është shqiptar.

Edhe këto ditë, përveç dhunës që ushtron Policia nëpërmjet formave të veta të egra barbare që u takojnë kohërave të vjetra, edhe rastet e linçimit janë shtuar. Kështu, politikat euro-antishqiptare të udhëheqësve shpirtërorë të serbëve dhe udhëheqësve shtetërorë të Serbisë, jo vetëm që po thellohen e zgjerojnë varrën e këtij pushteti të dhunës, që është vendosur në Kosovë, por me helmimin shpirtëror që po bën, që i kanë bërë e po i bëjnë masat serbe-malazeze në Kosovë, po ua varrosin të ardhmen e tyre në Kosovën e nesërme të lirë. Jo sepse institucionet e saj juridike do të merren me ndëshkimin e tyre, jo sepse shqiptarët do t'i ndjekin nga Kosova e lirë, por ata s'do t'i lërë të qetë e do t'i ndjekë kompleksi i fajit për mënyrat e ndryshme të linçimit, të kryera me verbëri fëmijërore, e me egërsi kriminale gjatë kësaj kohe të okupimit.

Dhe, ne e dimë, gjatë asaj kohe janë bërë pastaj, pas kësaj periudhe, në kohën e luftës, edhe shumë krime. Në rast se ne nuk e caktojmë kur duhet të lirohen veprat penale me këtë formulim, që e kemi deri më 20 qershor, nënkuptohen për disa dekada dhe sidomos veprat penale të rënda gjatë luftës, gjatë trupit, gjatë njeriut, gjatë jetës, trupit dhe shëndetit, dhe gjatë pasurisë së çmueshme të Kosovës natyrisht se ne do të bëjmë një gabim të pafalshëm. Kështu, përmbledhtazi, me pak fjalë, në Komisionin për Legjislacion duhet ta bëjmë një grup punues dhe të vendosim bashkërisht me një konsensus ndërparlamentar dhe të dalim me një qëndrim, duke e shfrytëzuar edhe fleksibilitetin e ministrit të Drejtësisë, gatishmërinë e Qeverisë për të bërë ndryshime në Ligjin për amnisti.

Unë mendoj që nuk duhet të kemi kompleks ta ndajmë edhe për një territor të caktuar, sepse është gjynah, është mëkat. Afro 100 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sot janë nëpër burgje për motive, të cilat lirisht do të mund të futeshin në këtë listë për amnistinë, por ne nuk kemi mundur t'i përfshijmë këtu, nuk kemi mundur t'i marrim në mbrojtje ata as me këtë Ligj të amnistisë, dhe tani ta bëjmë këtë lëshim nuk na falet.

Kështu që ne dalëngadalë mund ta bëjmë për muajin tjetër, brenda një muaji, brenda dy muajve, të shkojmë me një amnisti tjetër të përgjithshme, ndërsa konkretisht për ta plotësuar kriterin për marrëveshjen të shkojmë me ndarje territoriale për ato vepra penale, të cilat nuk përfshijnë vrasje, siç tha ministri i Drejtësisë, nuk i përfshijnë të gjitha ato që ne, si deputetë dhe si qytetarë të Kosovës, jemi të shqetësuar në qoftë se lëmë dilema se po i amnistojmë.

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Florin Krasniqi e ka fjalën.

**FLORIN KRASNIQI:** Faleminderit, kryesues!

U tha shumëçka, prandaj mendoj se të gjithë, në një mënyrë, ose një tjetër, nuk pajtohemi me formulimin e këtij ligji, por unë do të isha ndalur në nenin 5, në dy pika të veçanta.

E para, është ‘amnistohet kryengritja e armatosur’. Për cilën kryengritje të armatosur është fjala? Në qoftë se është fjala për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën çlirimtare, nuk mendoj se ka nevojë për amnisti, ka nevojë për vlerësim. Në qoftë se konsiderohet kryengritje e armatosur ajo çka serbët bënë me rastin e shpalljes së pavarësisë, atëherë nën këtë nen çdo aktivitet kriminal mund të mbulohet me të. Kështu, është keq që nuk është zoti Kuçi këtu, por besoj po na dëgjon. Kjo do të duhej të fshihej tërësisht, se kryengritje të armatosur këtu nuk ka pasur pas Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që ka qenë luftë çlirimtare. Në qoftë se ka pas, na tregoni. Unë nuk e di. Pse është futur ky nen?

Tjetra është spiunazhi. Vetëm me një fjalë është thënë ‘spiunazhi’. Cili spiunazh? Kush? Kundër kujt? Mua më vjen shumë keq se këtu u ngrit edhe çështja e SHIK-ut dhe padashur të paragjykoj ose ta fyej dikë, edhe një herë - unë i kam lutur kolegët e respektuar deputetë të LDK-së për të m’i dhënë nënshkrimet për hetim parlamentar. Ju më keni thënë, “këtë çështje do t’ia lëmë drejtësisë”. Juve, në veçanti, e ne të gjithëve, në përgjithësi, drejtësinë na e tregon Haradini me amnisti. Prapë po ju them, krejt çka po duam - një hetim. Mos t’i nxjerrim gjërat jashtë kontekstit. Unë prapë jam për një amnisti, por jo të kësaj forme, se kjo amnisti i bën dy gjëra shumë të këqija: një, i fyen viktimat, që të paktën në qoftë se ne si shtet, si republikë nuk kemi mundur ta vëmë drejtësinë në vend, pse po i fyejmë të paktën? S’mundëm ta vëmë drejtësinë në vend, pse po i fyejmë? Edhe e dyta, është e stimulon krimin tepër shumë.

Të gjithë ata që janë të interesuar të pasurohen në forma kriminale, ose të arrijnë qëllimet e tyre në forma kriminale, e kanë një stimulim të veçantë pse mundësia është shumë e madhe për një amnisti tjetër. Andaj, duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Mendoj se qëllimet të grupit tonë parlamentar janë të njohura, prandaj ju ftoj të gjithëve, kolegë deputetë, që një ligj për amnisti të kalojë, po ta mendojmë mirë, ta punojmë mirë. Të mos bëjmë kesi ligji. Ky nuk është ligj. Ky është një brutalitet ndaj viktimave dhe një vlerësim për kriminelët. Shpresoj se nuk do të kalojë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Desha ta përshëndes zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, por nuk qenka këtu. Po përpiqem ta kuptoj pozitën e tij dhe shpesh ia kam lakmi, por kësaj radhe nuk ia kam lakmi pozitën e tij.

Është një pozitë e rëndë për të, por ç'është e vërteta, Qeveria me ligjin që na e ka sjellë përsëri na ka vënë edhe ne në pozitë, dikush do të thoshte - në opozitë të vështirë, të rëndë dhe për ta evituar çdo keqkuptim, që në fillim, në parim jam për amnisti. Jam ish i burgosur dhe s'mund që një ish i burgosur të mos ketë mirëkuptim për një nevojë të tillë, aq më tepër që për ne do të ishte pune shumë e mirë po të kishin krijuar kushtet që të vepronim siç porosiste Çerçili, që pasi të dëshmonim në luftë forcë e qëndresë, në humbje, shpërfillje, në fitore të dëshmonim shpirtmadhësi.

Por, çështja është nëse i kemi krijuar ata parametra që ne t'i qasemi në këtë mënyrë një çështjeje të tillë aq delikate? Dhe, a është ky motivi i vërtetë?

Amnisti kanë bërë të gjitha vendet përreth, por asnjë nuk e ka bërë si Kosova. Asnjë nuk ka në memorandum të ligjit, siç është thënë, edhe opsionin e rekomanduar të bashkësisë ndërkombëtare. Dhe, ky fakt që silltet këtu shumë politikë, dhe vazhdimisht faktori ndërkombëtar si njëfarë super-faktori, që ndikon në procesin edhe të ligjvënies, edhe në çështje të tilla, vërtet po e cenon seriozisht funksionimin demokratik të këtij tempulli të demokracisë. Unë, prandaj, që në fillim, për të mos mbetur në fund, ndoshta për të kërkuar kohë shtesë, kështu siç është, megjithatë, ligji nuk më del se është i përkrahshëm. Mendoj që Qeveria do të bënte mirë ta tërhiqte në ripunim, që vetë ajo t'i merrte parasysh vërejtjet që janë bërë dhe të na e sillte të ripunuar, të përmirësuar dhe të përshtatur me momentin që po kalojmë.

Do të përpiqem ta arsyetoj së paku ndonjërin nga segmentet e tij. Çështja e amnistisë gjithkund është inkorporuar si pjesë e drejtësisë tranzicionale. Në Kosovë është insistuar vazhdimisht që edhe ne t'i qasemi këtij dimensionit, si të thuash të tranzicionit demokratik. Nuk ka pasur mirëkuptim dhe sa herë nuk e kemi ndjekur rrugën e rregullt, kemi hyrë pastaj në lojëra të të tjerëve dhe nuk kemi dalë mirë. Është insistuar këtu, ta zëmë, që të procedohet Ligji për lustracione. Sido të ishte tash për çështje amnistisë po ta kishim trajtuar këtë çështje me kohë, siç na ka sugjeruar, ta zëmë UNDP-ja e ka pasur një program të posaçëm dhe e ka ofruar, por te ne kanë hasur në vesh të shurdhër.

Tani jemi vënë para një sfide, ta miratojmë kështu siç është, ne mund ta shesim se është pjesë e normalizimit, por pakkush nga ne beson. Unë nuk besoj se ata rekomanduesit besojnë se kjo i kontribuon normalizimit, aq më pak bile besoj që autorët e ligjit, disa juristë me alamet kualifikime e tituj, e edhe reputacion, megjithatë mund të jenë të bindur se kjo është qasja që i duhet Kosovës. Jo, unë jam i bindur se ata e dinë dhe privatisht e thonë.

Është krijuar një gjendje, të gjithë e thonë privatisht, 'e dimë, keq është, shkret është, por po na imponojnë, s'kemi çka të bëjmë' etj. A nuk është jodinjitoze kjo qasje në të cilën e keni vëmë veten? Dhe, po e kultivojmë njëfarë mossinqeriteti për të.

Në preambulë të ligjit është thënë shprehimisht se synimi i ligjit është krijimi i kushteve, i kriterëve dhe i procedurave për aplikimin e amnistisë. Nuk e kemi pasur. Dhe, si i tillë nuk do të kishte gjë të keqe, por përnjëherë vërehet që në të vërtetë halli nuk është aty. Ne nuk e bëjmë një ligj për amnistinë si institucion, si praktikë, kush do duhej ta donte, në çfarë rrethanash do të duhej ta donte, si do të duhej të ishin procedurat? Kush, cilat janë limitet etj., dhe ky është edhe sugjerimi im. Po të ishte një ligj i tillë, s'do të kishte gjë të keqe. Le ta bëjmë njëherë bazën parimore, një ligj bazik dhe mbi këtë bazë pastaj, si vendet tjera, ta bëjmë edhe aktin e amnistisë. Edhe amnistisë së përgjithshme. Pse jo?

Bile për mendimin tim, pa pasur nevojë t'i ndajmë në baza etnike. Por, duke e liruar nga politizimi i ditës, që shpesh është me sherr, me marifete, e shesim ndryshe, e dimë që është ndryshe, para të huajve e paraqesim ndryshe, para milletit tonë ndryshe, dhe nuk besoj që në këtë mënyrë bëjmë ligj të qëndrueshëm.

Thuhet që ligji është përafuar me standardet e Bashkimit Evropian, me *acquis communautaire*, por thuhet, vini re, 'me frymën e ligjeve'. Si me frymën e ligjeve? Le të ma thotë dikush, ku ka një ligj për amnistinë si ky yni? Ku ka amnisti në Bashkimin Evropian për veprat që i kemi listuar këtu dhe u përmendën sa e sa herë? Pastaj, thuhet që ligji duhet ta ketë deklaratën e ndikimit financiar. A e kemi deklaratën e ndikimit financiar? Do të thuhet me siguri që nuk ka? Por, mua më del se nëse zbatohet kjo, ka që ç'ke me të.

Ne kemi, ta zëmë, një ligj për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme. Çka po bëjmë me këtë? A po i falim fajet, apo po e falim ligjin? Po i anulojmë fajet, apo po e anulojmë veç ligjin? Dhe jo veç një ligj, por edhe shumë ligje tjera, në të cilat jemi thirrur.

Ju kujtohet, ta zëmë, në sa ligje në Kushtetutë, gjithkund e kemi nxitjen e urrejtjes ndërnacionale si diçka të palejueshme, më të rëndën, më të dënueshmen. Kurse këtu, fët e fët, ne e hoqëm këtë dhe i amnistojmë edhe ata që janë dënuar për nxitje të urrejtjes nacionale, fetare e racore. Po, a na vë kjo në kundërshtim me standardet evropiane, në obligimet që kemi nga raportet e shumta ndërkombëtare, të cilat ne këtu i miratojmë, i përkrahim, përgjërohemi në to, e kur vjen puna këtu me lehtësi pastaj i anashkalojmë dhe për më tepër edhe me firmën e do rekomanduesve ndërkombëtarë.

A bën të kërkojmë edhe prej atyre rekomanduesve ndërkombëtarë, aman le të na e sqarojnë cilat janë standardet që po na i ofrojnë. Se andej na kërkojnë do standarde tjera, këndeja na imponojnë pastaj të kundërtën e tyre, e si të gjendemi, si të veprojmë me to?

Kolegë deputetë,

Ju bëtë diskutime të shumta dhe i përmendët disa herë anomali të, sidomos në vepra. Unë e kam nja 20-30, s'po i lexoj për të mos përsëritur, veç vërtet është e pakuptueshme si i shërbyeka normalizimit të raporteve ndëretnike, integritit të veriut, duke amnistuar veprat që janë, ta zëmë, si vrasjet e para, që fillon në afekt, ose në gjendje të tronditur shpirtërore. Kështu disi. Po, çdo vrasje mund të prezantohet, sidomos në luftë, ose pas luftës, se është bërë në gjendje të eksituar mendore etj.

Dhe, a do të thotë që në mënyrë të tërthortë, ato po amnistohen? Nëse amnistohen, le të thuhet, por jo kështu me marifet. Ose vrasja e foshnjave i kontribuaua normalizimit të raporteve ndëretnike! Çka ka lidhje kjo metodë? Ose, ta zëmë, abuzimet e shumta me Doganat. Ne përgjrohemi që do ta luftojmë korrupsionin etj., por me këtë, ne e amnistojmë korrupsionin që është bërë në Dogana më shumë se gjithkund tjetër. Dhe, ç'është e vërteta pa kufizime etnike etj. Cili është mesazhi që japim? Jo veç me këtë, por me gjithë këtë vister të veprave që i amnistojmë. Nuk besoj që mund të japim mesazh për sundimin e ligjit, për luftën kundër krimit, por mund të jetë e kundërta. I druaj kësaj.

Prandaj, për të mos e zgjatur, jam që ta përgatitim amnistinë, ta dëshmojmë shpirtmadhësinë, përkushtimin tonë për pajtim, për normalizim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

**AFRIM KASOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës,

Zëvendëskryeministri na foli këtu për ata të cilët nuk preken nga amnistia, duke u përpjekur të na qartësojë se gjoja i ka marrë masat që korrupsioni, vrasjet, e lëndimet trupore nuk do të falen. Mirëpo, megjithatë, unë do të doja t'i rendis se cilat vepra penale do të falen dhe atë do të filloj nga neni 3.

Kushtet për dhënien e amnistisë nga vuajtja e dënimit: të gjithë kryerësit e veprave penale në vijim, të kryera deri më 20 qershor 2013, përfshirë edhe personat kundër të cilëve akoma nuk është ngritur aktakuzë, apo kundër të cilëve nuk ka filluar ndjekja penale, personat të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji gjenden në mbajtje të dënimit me burgim në Republikën e Kosovës, apo ende nuk e kanë filluar mbajtjen e dënimit me burgim, ose për mbajtjen e atij dënimi janë transferuar jashtë Republikës së Kosovës, e të cilët me vendim të formës së prerë janë dënuar për vepra penale, të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës, për këto vepra penale lirohen 20% nga ekzekutimi i dënimit të shqiptuar me burgim:

Vrasja e kryer në gjendje të afektit mendor, vrasja nga pakujdesia, vrasja e foshnjave gjatë lindjes, lëndimi i lehtë trupor, pjesëmarrja në rrahje, shtrëngimi, kanosja, keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrave, cenimi i paprekshmërisë së banesave, kontrollimi i kundërligjshëm, parandalimi ose pengimi i tubimit publik, parandalimi i ushtrimit të së drejtës për shfrytëzim të mjeteve juridike, parandalimi i shtypjes ose i shpërndarjes së materialeve të shtypura, cenimi i të drejtave nga marrëdhëniet e punës, cenimi i të drejtave të punësisimit apo papunësisë, cenimi i të drejtave të punëtorëve në pjesëmarrjen në qeverisje, cenimi i të drejtave nga sigurimi social, rrezikimi i sigurisë në punë, fyerja, shpifja, zbulimi i rrethanave personale dhe familjare, vjedhja, kontraktimi i përfitimit joproporcional, prodhimi, shitja dhe vënia në qarkullim e materialeve të dëmshme për mjekimin e shtazëve, dhënia e ndihmës veterinarë në mënyrë të pandërgjegjshme, mosrespektimi i urdhrave për luftimin e sëmundjeve të shtazëve dhe bimëve, gjuetia e kundërligjshme, shitja ose nxjerrja jashtë Kosovës e trofeve të kafshëve të egra, peshkimi

i kundërligjshëm, mosevitimi i rrezikut, mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësitë e trafikut publik, keqpërdorimi i sinjaleve të komunikacionit, lajmërimet e rrejshme, shkelja e fshehtësisë së procedurës, rebelimi i personave të privuar nga liria, mundësimi i kundërligjshëm i ushtrimit të profesionit, aktivitetit ose detyrës, mospjesëmarrja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm, heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave, marrja ose asgjësimi i vulave zyrtare ose i shkresave zyrtare, asgjësimi ose fshehja e materialit arkivor, prezantimi i rremë, ushtrimi arbitrar i të drejtave, mosrespektimi i kushteve të lejeve për mbajtjen e autorizuar të armëve, keqpërdorimi i shenjave të rrezikut dhe të fatkeqësive, dhënia e kundërligjshme e ndihmës juridike.

Veprat penale të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës lidhur me Rregulloret e UNMIK-ut për ligjin në fuqi të Kosovës në vijim parashihen të amnistohen edhe këto: vrasja e çastit, vrasja nga pakujdesia, vjedhja, vjedhja e veprës, e shpërdorimit ose e mashtrimit të imët, kontraktimi i përfitimit pasuror joproporcional, mosmënjanimi i rrezikut, rrezikimi i komunikacionit, veprat e rënda kundër sigurisë së komunikacionit, legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë, vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, vrasja nga pakujdesia, vrasja e foshnjave gjatë lindjes, kanosja, ngacmimi, sulmi, lëndimi i lehtë trupor, pjesëmarrja në rrahje, shtrëngimi, keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve, kontrollimi i kundërligjshëm, cenimi i të drejtave të marrëdhënieve të punës, cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë.

Në nenin 5, kushtet për dhënien e amnistisë, nga ndjekja penale dhe vuajtja e plotë e dënimit, të nderuar qytetarë, parashihen të amnistohen me këtë projektligj: lirohen plotësisht nga ndjekja penale apo vuajtja e plotë e dënimit kryerësit e veprave të mëposhtme penale: sulmi kundër rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me kryerjen e një vepre tjetër penale për të cilën nuk është dhënë amnisti, kryengritja e armatosur, rrezikimi i tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, rrezikimi i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike, spiunazhi, bashkimi për veprimtari kundërkushtetuese, kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare, si i vijës kufitare, nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, zjarrvënia, mbajtja në pronësi të kontrollit në posedim të paautorizuar të armëve, moslejimi i veprave penale apo kryerësve të veprave, dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave, thirrja për rezistencë, përveç në rastet kur kryerja e kësaj vepre penale ka rezultuar me kryerjen e një vepre tjetër penale.

Lirohen nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit e kryerësit të këtyre veprave penale në vijim, të cilat janë kryer me qëllim të kryerjes së veprës penale thirrja për rezistencë, kanosja e kandidatit, parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar, keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, tregtia e ndaluar, shmangia e tatimit, kontrabanda e mallrave, shmangiet nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore, asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike, rrezikimi i trafikut publik me veprime ose mjete të rrezikshme, falsifikimi i dokumenteve, rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve, pengimi i

personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, përveç rasteve kur kryerja e kësaj veprë penale ka rezultuar me lëndim të rëndë trupor, ose vdekje. Po ashtu, në kuadër të kësaj amnistie janë futur edhe dispozitat penale të Kodit Doganor dhe të akcizës së Kosovës. Dhe, për fund, një katastrofë: veprat penale, të parapara me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, gazeta zyrtare nr. 44 e datës tetor 1976, cenimi i tërësisë territoriale, spiunazhi, nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar, apo etnik.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Gjykuar mbi këto dispozita juridike, nëse ky projektligj kalon në këtë mënyrë tregon qartë se të gjitha ato struktura kriminale, që deri më tani kanë përfituar nga kjo veprimtari do të amnistohen në aspektin politik dhe juridik. Kështu, me këtë projektligj, për herë të parë në historinë juridike të penalitetit, po ofrohet një zgjidhje bizare, ku dhunohet viktima dhe shpërblehet agresori. Në këtë mënyrë, tashmë, ata që janë mbi ligjin dhe jashtë tij, pikërisht këta për shkak të fuqisë politike që e kanë krijuar dhe sidomos ajo që parashihet në nenin 5, nga kjo gjendje e jashtëligjshme po amnistohen, kurse pjesa tjetër e shoqërisë, që e përbën shumicën e saj, e që jeton në përputhje me ndërgjegjen morale dhe rregullat ligjore dhunohet padrejtësisht.

Miratimi i këtij projektligji sipas kësaj logjike e instalon pikërisht sistemin e krimit dhe mosdënimit, prandaj esenca e këtij projektligji është edhe politike, sepse e kemi një pushtet politik, i cili në saje të këtij projektligji nuk kërkon që ta mbrojë shoqërinë nga krimi, por që fatkeqësisht kërkon ta mbrojë krimin nga nevojat e shoqërisë për drejtësi. Prandaj, edhe logjikisht, kritika jonë është e vërtetë se është edhe politike, e jo vetëm juridike, sepse në të vërtetë, politika e krimit sot e sundon shoqërinë kosovare. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Vataj e ka fjalën.

**RAMË VATAJ:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ligji për amnistinë është një ligj që e kanë zbatuar të gjitha shtetet që kanë dalë nga periudha të një konflikti që ka kaluar, prandaj ky nuk është risi. Ndërsa e kuptoj edhe rëndësinë e këtij ligji në kontekstin politik, pasi ky i kontribuon, apo do të jetë në funksion të normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, shtetit të Kosovës dhe atij të Serbisë, dhe integritit të veriut të Kosovës.

Unë nuk do t'i përsëris fjalët, të cilat i kanë thënë edhe kolegët e mi. Me shumicën e diskutimeve edhe dakordohem dhe në të vërtetë po të shikohet, ka nene shumë të pakuptimta, që nuk janë në funksion të të gjitha atyre që kontribuojnë në normalizimin e marrëdhënieve apo integritit të veriut të Kosovës. Unë mendoj se në këtë formë qysh është formuluar ky ligj nuk i kontribuon zhvillimit të shtetit ligjor të Kosovës. Ky ligj në këtë formë i inkurajon kriminelët dhe krimin e organizuar.

Prandaj, mendoj që duhet të rregullohet, apo pas votimit në parim për herë të parë duhet të ndryshohet, e unë do ta prek vetëm një segment në të cilën mendoj që ia vlen ta amandamentojmë. Unë do ta inicioj që do ta amandamentoj një nen, i cili ka të bëjë me atë që ligji duhet ta përcaktojë periudhën kohore për të cilën vlen. Nuk mund të thuhet që i amnistion të gjithë personat, apo të gjitha ato ngjarje që kanë ndodhur para 20 qershorit 2013. Duhet të specifikohet se a vlen ky ligj prej viteve '90-ta e këndeje, sepse e dimë në çfarë periudhe ka kaluar Kosova në ato lëvizjet që kanë ndodhur dhe burgosjet e vrasjet e ndryshme, që janë pjesë e lëvizjes për Kosovën Republikë, apo për çlirimin e Kosovës nga dhuna e shtetit serb.

Ose a vlen vetëm prej qershorit '99, kur është çliruar Kosova, apo vlen vetëm prej periudhës të vitit 2008, kur Kosova është pavarësuar, dhe për të cilat struktura, për të cilat krime apo individë vlen ky ligj.

Unë e kam një rast konkret që duhet të rregullohet një amendament për ato kategori të njerëzve që kanë qenë në dy taborë të kundërt. Nuk mund të pajtohem që të amnistohen ata njerëz që kanë bërë krime gjatë kohës së luftës dhe pastaj të dënohen ata që kanë qenë kundër këtij krimi, të dënohen njerëzit që e kanë mbrojtur popullin dhe vendin e vet prej këtyre kriminelëve.

Ka akuza që njerëzit janë dënuar, për shembull, sipas Kodit Penal të ish-Jugosllavisë apo me kallëzime, apo duke përdorur dëshmitarë, inspektorë të sigurimit serb, sepse është grushtuar gjatë kohës së luftës dhe njerëzit dënohen me disa vjet, ndërsa duhet të amnistohen njerëzit që kanë bërë krime të rënda dhe vazhdojnë të bëjnë krime ndaj shtetit të Kosovës.

Prandaj, nëse ligji vlen për kriminelët, apo për ato struktura kriminale që kanë qenë në veri të Kosovës, ky ligj duhet t'i amnistojë, në të vërtetë nuk ka kuptim të thuhet amnisti për luftëtarët e lirisë, por ne po shohim që ata, ose po burgosen, ose ka aktakuza ndaj tyre, ose janë dënuar me një dëshmi të një inspektori serb, që edhe për fat është zënë gjatë kohës së luftës dhe ka shpëtuar, e tash ai përdoret si dëshmitar për ta dënuar një luftëtar të lirisë.

Prandaj, në këso raste duhet të ketë përjashtime. Nuk mund disa që kanë dëmtuar vazhdimisht vendin tonë, Kosovën, e që edhe pas konfliktit kanë vazhduar tash e 14 vjet, me një fjalë goje ose me një ligj kësisoj të amnistohen, ndërsa të dënohen të tjerët që kanë qenë karshi të keqes, në mbrojtje të së keqes, kjo nuk ka kuptim për mua. Unë mendoj që duhet t'i specifikojmë edhe këta. Nuk ka kuptim edhe të thuhet që duhet të amnistohen, por këta nuk duhet të dënohen këta njerëz që kanë kontribuar në çlirimin e Kosovës dhe kanë qenë pas vitit '99 si kontribuues të ndërtimit të shtetit të Kosovës, ndërsa ata që kanë dhunuar, që tash e 14 vjet kanë bërë krime edhe gjatë kohës së luftës, me një fjalë goje të amnistohen.

Prandaj, unë do të jem në funksion të asaj që tash në parim, unë në këtë lexim do ta votoj, por me qëllim që të amandamentohen dhe të mos bëhen këso diskriminimesh për njerëzit që kanë qenë në dy taborë të kundërt, njëri e ka luftuar të mirën, e tjetri të keqen, dhe tash



ata që janë gjithmonë në rrënim të vlerave të shtetit të Kosovës, në rrënim të gjithë asaj që ka investuar komuniteti ndërkombëtar në Kosovë të amnistohen, ndërsa njerëzit tjerë të lihen si të them të bëhen fajtorë dhe të dënohen, të vuajnë, të mos i gëzojnë frytet për të cilat kanë derdhur gjak. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës, Tri kategori politike janë mbi ligjin në Kosovën e pasluftës. Të parët janë burokratët ndërkombëtarë dhe forcat e trupat e armatosura ndërkombëtare. Kategoria e dytë janë strukturat ilegale armiqësore e kriminale të Serbisë dhe kategoria e tretë janë protagonistët e aferës “Pronto” dhe anëtarët e tjerë të klanit kriminal të tyre.

Këto tri kategori janë marrë vesh për t’i falur krimet e shumta kundër Kosovës, kundër Republikës së shtetit të Kosovës, kundër popullit të Kosovës, kundër të drejtave, pasurisë dhe interesave të qytetarëve të Kosovës. Marrëveshja Thaçi-Daçiq është bërë në Bruksel. Baronsha Eshton e ka lehtësuar edhe këtë marrëveshje, që sërish është marrëveshje Thaçi-Daçiq, sepse është pjesë e planit të zbatimit të asaj marrëveshje 15-pikëshe. Kjo e dëshmon se marrëveshja me Serbinë zbatohet duke ia falur Serbisë të kaluarën dhe të tashmen e saj armiqësore e kriminale në Kosovë.

Nuk mund të jetë ndryshe, sepse shefi i MUP-it dhe UDB-së në Kosovë është pikërisht Daçiqi, i cili nuk është vetëm kryeministër, por edhe ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Atëherë, çfarë janë këto marrëveshje në Bruksel që po quhen herë “të pajtimit”, herë “normalizimit”, pa qenë asnjëra prej këtyre. Këto marrëveshje janë marrëveshje ndërmjet kriminelëve të luftës në Beograd dhe kriminelëve të paqes në Prishtinë. Kriminelët e luftës në Beograd dhe kriminelët e paqes në Prishtinë janë marrë vesh që t’i falin strukturat kriminale të Serbisë në Kosovë. Aq të shumta e sistematike janë krimet e strukturave të Serbisë, aq të thella e të qëllimshme janë ato, sa ky nuk mund të jetë Projektligj për amnisti, por është Projektligj për amnezi.

E vetmja rrugë qysh këto krime mund të falen, është duke u harruar ato. Pra, sot Qeveria po na fton që Kuvendi i Kosovës ta miratojë një ligj për harresën. Një ligj që do ta imponojë harresën, ta bëjë harresën detyrë e obligim. Pra, nuk bëhet fjalë për Projektligj për amnisti, por për projektligj për amnezi. Meqenëse Serbia as nuk po na kërkon falje, as s’po na paguan dëmshpërblim, e as nuk po zmbreset nga apetitet e saj, Qeveria është marrë vesh që ne t’i harrojmë me ligj krimet e strukturave të Serbisë në Kosovë.

Ky ligj për harresë nuk sjell ligjësi, por tashmë paraqet ligësi, ligësinë më të paskrupullt të kësaj Qeverie. Nga ministri i Drejtësisë dëgjova dy simptoma të sigurta të shtet-rrënimit të Kosovës. E para, ai flet qysh nuk do të ketë falje, atëherë kur kemi rëndime të rënda trupore, ose vdekje, dhe mundohet të na ngushëllojë me këtë. Pra, e vetmja pikë ku mbahet mos-amnistia është shkalla e pasojës fizike, duke shpërfillur qëllimin e motivin kriminal, duke shpërfillur veprimin kriminal. Kjo nuk është as drejtësi, e as humanizëm, por dorëzim.

Dhe, simptoma e dytë e shtet-rrënimit në Kosovë ishte shprehja e ministrit të Drejtësisë ‘nuk bëhet kiameti’. Atëherë kur tha se nuk bëhet kiameti, nëse ne ua japim amnistinë, sepse historikisht kanë dhënë edhe mbretërit e të tjerët. Pse ne duhet të matemi karshi kiametit? Ç’është kjo gjuhë e ministrit Kuçi që na e zbulon një qenie apokaliptike? “S’bëhet kiameti”, tha ai. Nëse s’kemi kiamet, qenka mirë. Pse ne në kuadër të shtet-ndërtimit, zhvillimit, duhet të matemi karshi kiametit? Kjo tregon që ne duhet të jemi të kënaqur sipas këtij ministri që s’u bë kiameti, e s’bëhet kiameti, që nëse nuk ka kiamet mirë është. Madje shumë mirë është. Pikërisht kjo prirje që shtiret se po na ruan nga kiameti dhe se mungesa e kiametit është garancia e mirëqenies dhe e drejtësisë, paraqet rrugëtimin e sigurt drejt kiametit.

Duke thënë “s’bëhet kiameti”, ministri i Drejtësisë po na e vërteton që s’bëhet fjalë për shtetndërtim, por për shtet-rrënim, me ç’rast na mbetet të shpresojmë se rrënimi i shtetit s’do të na shkojë deri bash në fund, aty ku na pret kiameti. E për fund, me siguri që të gjithë kollaj e marrin me mend se janë të shumtë pjesëtarët e strukturave kriminale-armiqësore të Serbisë që kanë bërë edhe krime të luftës, por edhe krime të pasluftës. Duke ua falur krimet e pasluftës zvogëlohen tepër shumë gjasat që ata ndonjëherë të ndëshkohen për krimet e luftës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Musliu e ka fjalën.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot po flasim për ligjin më të përfolur në këtë legjislaturë, të përballur me presion mediatik e qytetarë, të përballur me kërcënime prej më të ndryshmeve. Jemi të vetëdijshëm për detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi si deputetë të Parlamentit të Kosovës.

Për njoftim të opinionit të gjerë, ne si deputetë, për ditë të tëra jemi terrorizuar nga sms të sponsoruar nga njerëz, të cilët problemet mendojnë t’i zgjidhin nëpërmjet këtyre metodave dhe unë sot i bëj me dije ato lëvizje, të cilat i kanë publikuar numrat tanë në rrjete sociale, që e kanë shkelur rëndë ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kjo me ligj është e dënueshme.

Të nderuar deputetë,

Ligji për amnistinë si tërësi i ka përparësitë e veta kur kemi të bëjmë me integrimin e veriut të Kosovës, ashtu siç ka edhe mangësitë kur bëhet fjalë për faljen e një numri të madh të veprave penale. Andaj, konsideroj që ky ligj duhet të shqyrtohet nga grupi punues dhe komisioni përkatës dhe të plotësohet me propozimet e deputetëve që mendojnë që kontribuojnë që ky ligj të jetë sa më i pranueshëm.

Meqë sot me këtë ligj po amnistojmë struktura apo grupe kriminale, të cilat plotë 14 vjet luftuan kundër NATO-s, UNMIK-ut, EULEX-it dhe kundër institucioneve të Kosovës, në këtë ligj nuk e kemi asnjë të...

*(Pengesa teknike në incizim)*

...Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët nga bashkëpunëtorët e armikut janë duke u akuzuar edhe sot edhe sot 14 vjet pas luftës...

**KRYESUESI:** Zotërinj deputetë, uluni në vendet tuaja! Zoti Krasniqi! Uluni në vendet tuaja.

**GANIMETE MUSLIU:** ...Andaj, si deputete e këtij Kuvendi, gjithmonë duke përkrahur edhe atë çka e tha kolegu ynë më herët, zoti Ramë Vataj, konsideroj se në këtë ligj duhet të futet edhe një amendament, i cili do t'i amnistonte të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës...

**KRYESUESI:** Zoti Pajaziti, ulu në vendin tënd! Uluni! Vazhdoni ju!

**GANIMETE MUSLIU:** ...Si deputete e këtij Kuvendi, konsideroj se me këtë ligj duhet të futet edhe një amendament, i cili do t'i amnistonte të gjithë ish-ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët edhe sot akuzohen, gjykohen dhe dënohen vetëm në bazë të supozimeve, që gjoja ia paskan dhënë dikujt ndonjë shqelm apo shuplakë dhe për këto vepra ata sot quhen edhe "kriminel të luftës".

Ne vazhdimisht po flasim për humanitet dhe me këtë po e arsyetojmë domosdoshmërinë e këtij ligji, prandaj unë konsideroj se s'ka humanitet më të madh se të luftosh për çlirimin e vendit dhe lirinë e popullit tënd. Kërkesën time për këtë amendament e mbështes edhe në arsyetimin që gjoja në vitet e tranzicionit, qytetarët nuk kanë qenë sa duhet të njoftuar me rregulloret dhe udhëzimet administrative në fuqi, të nxjerra nga UNMIK-u dhe institucionet ndërkombëtare, kur dihet që pikërisht mbi bazën e atyre rregulloreve dhe udhëzimeve administrative po dënohen këta ish-ushtarë dhe po denigrohet e po poshtërohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe, fundi i fundit, nëse këta individë, për të cilët po kërkohet të amnistohen, s'i kanë kuptuar rregulloret dhe normat ligjore në kohë paqeje, si është e mundur të kërkohet nga ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që në kohë lufte, gjenocidi e tmerri t'i përmbahen në përpikëri, shkronjë për shkronjë, rregullave që ndoshta shumë prej nesh deri në atë kohë nuk e kemi pasur rastin as të dëgjojmë për to.

Të nderuar, për fund, duke i mbështetur të gjitha kërkesat e arsyeshme dhe konstruktive të kolegëve të mi dhe propozimet për ndryshime, e mbështes në parim këtë projektligj për ta dhënë kontributin tim në leximin e dytë, por theksoj edhe një herë që nuk guxojmë si deputetë të këtij Kuvendi të lejojmë që amnistia të aplikohet me standarde të dyfishta në Kosovë.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

**VISAR YMERI:** Faleminderit kryesues!

U tha shumë për Ligjin për amnistinë, unë po dua të flas më shumë për mënyrën se si ka ardhur ky ligj këtu natyrisht, edhe për politikën prapa këtij ligji, se u përmend se është ligj politik, por para se të filloj ta mbaj këtë fjalë timen për ligjin, vetëm desha t'ia

përkujtoj deputetes që foli para meje, se numrat që i kemi publikuar, i kemi publikuar në Lëvizja “Vetëvendosje”. Ajo tha ‘atyre lëvizjeve’. Nuk është ‘atyre lëvizjeve’, është një lëvizje, Lëvizja “Vetëvendosje”, dhe ata numra janë të publikuar në ueb-faqen e Kuvendit. Nuk është kurrfarë shkelje e privatësisë, madje-madje mua më brengos shumë se si një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës terrorizohet nga qytetarët e vet dhe se si një deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës i pengon pse numri i tij është në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, pra do që numrin ta ketë të fshehtë. Do të fshihet nga qytetarët. Deputetja, e cila njëkohësisht vendos t’i gjuajë me këpuce deputetët e tjerë në sallën e Kuvendit.

Çështja e dytë, e njëjta deputete tha që duhet ta futim një nen këtu që t’i amnistojmë ushtarët e UÇK-së. Nga çka? A konsideron kjo që ushtarët e UÇK-së paskan kryer krime për të cilat duhet të amnistohen, apo çfarë thotë? Dhe pse do t’i barazojë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me strukturat ilegale të Serbisë këtu? Pra, t’i fusë në të njëjtin ligj për t’i amnistuar të dyja palët. Ky është absurd dhe besoj që kjo deputete do t’i thërrasë mendjes dhe ta tërheqë këtë fjalë të dëmshme, që e tha.

U përmend këtu nga disa deputetë që duhet të kuptohet konteksti i ligjit, apo jo? Dhe ta diskutojmë ligjin në kontekstin në të cilin po ndodh. Dhe pikërisht të njëjtit deputetë pastaj e dekonstualizuan ligjin duke folur për diçka tjetër. Pra, kontestin e ligjit e dimë të gjithë. Ky ligj ka ardhur këtu si rrjedhojë e marrëveshjes që Hashim Thaçi e ka bërë me Ivica Daçiçin. Midis tjerash janë diskutuar edhe çështje tjera, por është diskutuar edhe ligji për të cilin po flasim, me tekstin dhe nenet, me të cilat na ka ardhur. Të mos e harrojmë këtë gjë. Në këtu jemi duke e votuar një ligj, për të cilin paraprakisht është dakorduar Ivica Daçiç, Qeveria e tij dhe strukturat e tij.

Çështja tjetër, që u përmend disa herë se amnistia është humane. Pra, edhe zëvendëskryeministri Kuçi tha që është amnisti humane t’u jepet kriminelëve amnisti, t’i amnistojmë nga krimet e kështu me radhë, dhe pastaj u tha që amnistia ndodh në secilin vend pas konfliktit, apo jo? Kështu e përmendi edhe zoti Kuçi, e pastaj pyetja ime për të, madje edhe njëllor shqetësimi që e kisha ngrehur për këtë çështje është se si nuk na ka treguar Qeveria e Kosovës e Kosovës që jemi në luftë me Serbinë deri më 20 qershor 2013. Pra, të gjithë kanë thënë se lufta ka përfunduar në qershor të vitit 1999, e tash zëvendëskryeministri na e shpërfaqti të vërtetën, tha menjëherë pas konfliktit, pra pas luftës, po i amnistojnë të gjitha krimet që janë kryer deri në 20 qershor të vitit 2013, që nënkupton që paskemi qenë në luftë me Serbinë deri në këtë moment. Apo jo zotëri Kuçi? Pra, pse nuk keni treguar që jemi në luftë?

Edhe në rast të këtyre amnistive që po përmenden, pra kur amnistohet një grup, i cili është organizuar për të bërë rezistencë, për ta kundërshtuar një rend të caktuar kushtetues dhe një rend të caktuar ligjor, edhe në aso raste amnistohet, në rastin më të keq, ose në rastin më të mirë, quajeni si të doni, pjesëmarrja në atë grup, po amnistohet individi për shkak se ka qenë pjesëtarë i një strukture, e cila e ka bërë këtë rezistencë. Por, nuk amnistohen të gjitha krimet që janë kryer në emër të kësaj rezistence, siç po ndodhë me këtë ligj që e kemi në këtu.

Pra, shmangiet nga tatimi, kontrabanda, haraçi, këto janë krime ordinere. Këto krime nuk kemi nevojë t'ia amnistojmë askujt, apo jo? Edhe në këtë kontest politik për të cilin po flisni ju, e që po e pranoni me kaq vullnet dhe në mënyrë kaq jokritike, edhe në këtë shmangie, këto amnisti për këto krime ordinere bëhen absurd dhe të pakuptimta, sepse më tregoni në çfarë rezistence bëhet për një çështje politike, për një kauzë politike nëpërmjet haraçit? Çfarë rezistence bëhet nëpërmjet kontrabandës? Çfarë rezistence bëhet nëpërmjet shmangies të tatimeve dhe tjera? Këto janë përfitime të paligjshme financiare. Pastaj, çfarë rezistence është bërë nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve? Çfarë rezistence po na bëhet nëpërmjet pengimit të kandidatit, pengimit të votës, e kështu me radhë?

Po këto janë krime ordinere, me të cilat do të përfitojnë të gjithë ata kriminelë, në veri dhe në jug, dhe të cilët e kanë dëmtuar tash e 14 vjet Kosovën, shtetin e Kosovës, Buxhetin e Kosovës dhe çdo gjë që bie përbrenda një logjike të rendit kushtetues dhe të rendit republikan këtu, brenda Kosovës.

Dhe, natyrisht, si çdo në këtë marrëveshje, edhe ky Ligj për amnistinë tashmë ka filluar të zbatohet pa u miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dhe, e dini kush është i amnistuari i parë në Kosovë? Është Nenad Gjuriqi. Pra, kontrabandisti dhe pjesëtari i policisë së Milosheviqit. Përveç se që ka fituar amnisti, është emëruar komandant rajonal policie.

Pra, në këtë pikë dhe me atë çfarë po ndodh me këtë ligj, nuk mendoj se është e mjaftueshme të thuhet se po amnistohet krimi. Kjo është e pamjaftueshme për shkak se çfarë po ndodh, në fakt, është që po kriminalizohet shteti dhe po përmbysset rendi juridik për shkak se po i vihet në shërbim krimi dhe kriminelit, në mënyrë që të vazhdojë tutje me krimin edhe me aktivitetin e vet kriminal.

Pra, si mund të vendosen rendi dhe ligji duke e amnistuar krimin dhe duke e kriminalizuar shtetin, pra duke e institucionalizuar shkeljen e rendit dhe shkeljen e ligjit.

Qëllimet e këtij ligji që u proklamua këtu publikisht, në fakt janë të kundërta me veprimet e këtij ligji, sepse pikërisht e kundërta po ndodh, po shpërblehet dhe po institucionalizohet shkelja e rendit, shkelja e ligjit, shkelja e shtetit të Kosovës e të sovranitetit dhe e integritetit territorial të Kosovës. Dhe, kjo, kur ta kemi parasysh në kontestin për të cilin po flas, e i cili është konteksti i vetëm politik tash në Kosovë, pra konteksti i Kosovës së marrëveshjes, atëherë në fakt po amnistohet Serbia në ndërhyrjen e saj për shkak se po i legalizohet ndërhyrja dhe, në anën tjetër, po i garantohet mosndjekja penale e ndërhyrjes edhe e aktorëve që kanë ndërhyrë në Kosovë, në mënyrë të jashtëligjshme, në mënyrë kriminale, në mënyrë vrasëse dhe në mënyrë shkatërruese për shtetin e Kosovës.

Po ashtu, u përmend nga disa deputetë, si të opozitës, ashtu si pozitës, se do ta votojnë ligjin, me kusht që ky të amendamentohet. Edhe kjo është një këngë, kisha thënë, që e kemi dëgjuar disa herë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe nga Qeveria, edhe nga deputetët e Kuvendit, që ta votojmë një ligj e pastaj e amendamentojmë, dhe

asnjëherë pastaj amendamenti nuk ka ecur. Pra, nuk është hera e parë që zoti Hajredin Kuçi na thotë që jam i hapur për amendamentim. E ka thënë të njëjtën gjë edhe për Ligjin për konfiskimin e pasurisë, i cili nuk është amendamentuar mbase në asnjë pikë. Na kanë thënë kjo Qeveri se jemi të hapur për ta amendamentuar edhe Ligjin për miniera dhe minerale me një amendament që ata vetë e kanë sjellë kur është rishikuar ky ligj dhe të vetmin pastaj nuk e kanë votuar.

Pra, po ju them deputetëve të opozitës, mblidheni mendjen, sepse po e votuat herën e parë, nuk do ta amendamenti herën e dytë, dhe nuk është hera e parë që po i hani fjalët. Përpara u është dashur nga një muaj për t'i hëngër fjalët, tash së fundi po e shohim se po i hani brenda ditës. Edhe këto fjalë unë shumë qartë po e shoh që do t'i hani brenda dy javëve. Pra, nuk do ta amendamenti këtë projektligj dhe do ta pranoni kështu siç është edhe në të ardhmen, për shkak se tashmë e keni dëshmuar që me ju manipulohet dhe luhet si të dojë Qeveria dhe si të duan të tjerët.

Rrjedhimisht, nëse vërtet e keni ndërmend për ta ndryshuar këtë ligj, mos e votoni tash në lexim të parë. Po e votuat në lexim të parë, nuk do ta ndryshoni ligjin dhe do të bëheni bashkëpjesëmarrës në këtë amnisti të krimit. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Për replikë është lajmëruar zonja Musliu.

**GANIMETE MUSLIU:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sa u përket numrave të publikuar nga lëvizjet, e përsëris, sepse është edhe një në lëvizje si motër e “Vetëvendosjes”, që është “Ngrite zërin edhe ti”, e cila dje i ka publikuar numrat e të gjithë 84 deputetëve në rrjetet sociale në Facebook dhe, e dyta, sa i përket këpucës time, unë dua t'i them zotërisë që unë do të sillem konform sjelljeve tua dhe të kolegëve tu.

Përderisa ju nuk e respektoni ligjin, nuk e respektoni rendin publik, nuk i respektoni institucionet e Kosovës, do ta merrni atë që ju e meritoni. Më vjen mirë që për një javë rresht kam arritur t'ua tërheq vëmendjen nga veriu i Kosovës, nga bashkimi kombëtar, nga të gjitha vlerat tjera kombëtare dhe nacionale që ju i quani dhe jeni marrë pikërisht veç me këpucën time. Për këtë ndihem shumë mirë dhe komod dhe, e fundit fare, sa i përket Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk dua të ta jap rastin të replikoj, sepse ju nuk jeni i denjë të flisni dhe t'i mbron vlerat e saj.

**KRYESES:** Zonja Brovina e ka fjalën!

**FLORA BROVINA:** Përshëndetje, kryesues!

Përshëndetje kolege dhe kolegë,

Projektligji për amnistinë nuk është në ligj i domosdoshëm dhe obligativ për integritet evropiane. Çështja e amnistisë është çështje e brendshme e një shteti dhe nuk është e thënë të ndodhë me ligj. Atë mund ta sjellë edhe Presidentja me akt të veçantë ku Qeveria, përkatësisht Kryeministri, pa e obliguar Kuvendin që të votojë dhe ta marrë përgjegjësinë për këtë. Kështu ndodhë në disa vende dhe nuk është pra e rregulluar me ligj.

Nëse amnistia duhet të ndodhë për shkak të integritit të serbëve në veri, e të cilët për kaq vite me radhë nuk e pranuan realitetin dhe e kundërshtuan atë me dhunë, kryen edhe vepra penale dhe të dhunshme ndaj shtetit të Kosovës dhe Kosova tani e merr për obligim ta garantojë sigurinë, amnistinë, pra me shpërblim për integrimin e tyre.

Jam për këtë ligj, jam për integrimin e tyre dhe për integrimin territorial të Kosovës, por ky ligj, ky projektligj i amnistisë tenton më shumë, rehabilitimin e shumë veprave penale që cenojnë ligjet e nxjerra nga ky parlament, si për shembull vjedhjet, keqpërdorimet, kërcënimet, shantazhimin e tjera, të përfshira në nenin 3. Me këtë cenohet siguria e qytetarëve dhe pengohet zbatimi i ligjeve tona dhe harrohet amnistia e atyre që vërtet e presin amnistinë.

Do të përmend disa shembuj, ndoshta edhe për ta tërhequr vërejtjen tuaj tani më, pak a shumë, të humbur. Para dy javësh, dikush guxoj që në shtëpinë time për të dhjetën herë me radhë gjatë këtyre 12 vjetëve pas përfundimit të luftës, ta cenojë integritetin tim familjar, duke hyrë dhe duke plaçkitur gjëra shumë me vlerë. Unë edhe e zura vjedhësin, por çka nëse amnistia e liron? Me këtë desha të tregoj se të gjithë jemi të cenuar nga personat që do të lirohen nga amnistia. Edhe prindërit e mi vuajtën shumë gjatë në burgjet e ndryshme të ish-Jugosllavisë në kohën e Rankoviqit, në Burgun e Nishit, në Goli-Otok dhe u liruan pas vuajtjes së gjatë nga amnistia që ndodhi në kohën pas përfundimit të Rankoviqit dhe regjimit të tij.

Jam përfituese e një amnistie që Serbia, pas një shtypjeje shumë të gjatë ndërkombëtare, më liroi mua dhe pastaj i liroi edhe të zënët tjerë robër para 13 vjetëve, dhe kjo është një diçka shumë e zakonshme në përfundim të luftërave. Por, është abnormale pse një shtet që i shkakton luftërat të guxon t'i marrë qytetarët e shtetit tjetër ose qytetarët tjerë dhe t'i dënojë me vite të tëra, t'i dhunojë dhe t'i maltretojë aq gjatë, dhe nga kjo nuk pëson asgjë. As nuk u dënua Serbia, as nuk u pendua Serbia, as nuk iu tërhoq vërejtja dhe ajo vazhdon të shantazhojë.

Tani, 13 vjet pas, në Serbi, pas nënshkrimit të marrëveshjes në Bruksel, edhe më tutje vazhdon diskutimi pse u lirova unë, kush e solli amnistinë në Serbi, pse u liruan të tjerët dhe gjëra të tilla. Unë nuk isha e dënuar 13 vjet. Unë isha vetëm 12 vjet dhe lirimim tim kurrë nuk e kam kërkuar me amnisti nga armiku.

E kuptoj amnistinë nën presionin ndërkombëtar. Pyes: A do të ndodhë amnistia edhe për pjesëtarët e UÇK-së, që tani gati më shumë se 10 vjet ndodhen me vendime të papërfunduara dhe të padëshmuara si duhet, ndodhen në burgjet e Kosovës. Madje, në mesin e tyre edhe raste të rënda me sindromën postraumatik, si shkak i përjetimit të luftës. Unë si humaniste nuk mund ta kuptoj këtë. Dhe, pse ndiçen çlirimtarët, e jo kriminelët? A vlejnë konventat ndërkombëtare vetëm për çlirimtarët, ose për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo ato nuk vlejnë për bashkëpunëtorët e shërbimit të Serbisë? Ato nuk vlejnë për ata që kryen krime në Kosovë.

Pse nuk u dënua asnjëri nga kryerësit e dhunës seksuale të grave, fëmijëve dhe burrave në Kosovë, edhe pse dihen dhe njihen. As nuk u dënuan ata që kryen krime dhe masakra në

Burgun e Dubravës, masakrën në Therandë, Gjakovë, Drenicë, e gjithandej. A mund të ndodhë pajtimi ndërmjet nesh pa u dënuar ata që i vranë, që i masakruan qytetarët e Kosovës, ose të gjallë i sollën në Serbi dhe ndoshta edhe i zhdukën në furra.

Pse nuk u bë në Serbi amnistia, pas ngritjes së akuzave gati për të gjithë pjesëtarët e udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ata ende rrezikohen të burgosen kur i kalojnë kufijtë. U përmendën parimet në dialog. Pyes: Në parime, a vlen edhe reciprociteti? Dhe, kur është fjala për reciprocitetin, pyes: A vlen reciprociteti edhe për shqiptarët e Kosovës Lindore, për Preshevën, Bujanocin, Medvegjën, kur dihet se në burgjet e Serbisë edhe sot mbahen qytetarët shqiptarë për shkak se e deshën lirinë, demokracinë, komunikimin dhe integrimin nacional.

Kemi thënë në këtë Parlament se ne jemi zëri i tyre. Kur dhe si jemi zëri i tyre? Në këtë projektligj kam vërejtje dhe vërejtjet e mia do t'i paraqes me shkrim, duke shpresuar se do të pësoj ndryshim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! I fundit është nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.

**SABRI HAMITI:** Zoti kryesues!

Zoti Kryeministër,

Ministra,

Deputetë, kolegë,

Deputetë dhe deputete,

Edhe qytetarë të Kosovës, nëse na shihni në këtë moment, kjo varet prej RTK-së.

Unë kam dy dokumente përpara këtu, në bazë të të cilave ne punojmë. Një është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që në nenin 70, te mandati i deputetit thotë: Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.

Neni 10 i Rregullores së Kuvendit e ka betimin e famshëm që e kanë bërë të gjithë deputetët që janë këtu, i cili thotë: “Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem dhe me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe ta përfaqësoj me dinjitet popullin; do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj; do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale, integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të të drejtave të njeriut në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”.

Unë e di që ju i dini të gjitha këto, por është momenti që edhe të përsëriten se nuk është keq që të vërtetat nganjëherë edhe të përsëriten, ngase harrohen.

Tash, kohëve të fundit ne kemi pasur votime me 2/3, qofshin të marrëveshjeve, qofshin të ligjeve, siç e kemi sot, dhe unë në bisedimet e mia rreth kësaj çështjeje, unë nuk kam ndërruar qëndrim. Edhe sot vazhdoj të them qysh kam thënë herën tjetër: Kujdes, mos u ngutni të bëni votime me fuqi kushtetuese. Pse? Për shkak se edhe pa e pasur ndërmend, pa e pasur në ndërgjegje, në vetëdije, që po bëni votim që e prek Kushtetutën, ju e bëni në



mënyrë të pastudiuar. Thirrja vlen edhe sot. Çdo votim i tillë me 2/3-tat që prek Kushtetutën, në të vërtetë është votim kushtetues dhe është shumë më mirë që të thuhet direkt, kur bëjmë votime të tilla, 'zonja dhe zotërinj, këto janë çështje që e prekin Kushtetutën' dhe të bëjmë procedurë për ndryshime kushtetuese.

Ky ligj, që e kemi sot në shqyrtim për amnistinë është shumë problematik. U pa nga të gjithë diskutuesit për dy arsye: një, të gjithë thonë se është i keq dhe duhet të përmirësohet shumë, bile ekspertët e përdorin atë termin e famshëm 'substancial', por nëse duhet të bëhen shumë ndryshime substanciale, domethënë ka defekt substancial, ndërsa deputetët tjerë e kontestojnë në mënyra të ndryshme që duhet të ndryshohet dhe të plotësohet në mënyrë që të votohet në lexim të dytë. Unë po them që, nëse votohet në lexim të parë me 2/3, leximi i dytë është, ju shiheni vetë çka do të ndreqni, sepse atëherë asnjë gërmë nuk do të mund ta ndërroni pa një konsensus të përgjithshëm. Kaq!

Sepse kjo puna e votimeve me fuqi kushtetuese është problematike. Kjo ka ndodhur edhe me votimin e marrëveshjes së parë për normalizim. Është votuar një herë më duket me 89 vota, që është përtej 2/3-tave, pastaj, për çudi, nuk di pse juridikisht është kërkuar, apo ka qenë një vetëprovokim i Kuvendit po them, nuk di si ta quaj ndryshe, juridik, që të votohet edhe një herë dhe i ka marrë nja 4-5vota më pak. Në rregull, ka kaluar pak, por pse i njëjti dokument, me të njëjtat germa, me të njëjtat presje, votohet në Kuvend dy herë me 2/3-tat. Unë këto nuk i di. Po them, nuk është mirë që të përsëriten këto probleme edhe një herë.

Ndërsa ligji që e kemi përpara, thashë se ka edhe interpretime, edhe këtu u panë, të dyanshme. A është ky ligj që ka funksion vetëm normalizimin me Serbinë, duke i amnistuar strukturat kundërshtuese të pavarësisë së Kosovës me të gjitha mjetet e tyre në veri të Kosovës, që i bie serbët e veriut të Kosovës, apo është instrument, i cili në mënyrë indirekte lakon raportet e Kosovës dhe të Serbisë pas një lufte, jo konflikt. Ka pasur luftë këtu. Se nëse ka heronj, nëse ka epikë e poepë çlirimtare, aty ka luftë. Nuk ka konflikt. Pra, a po i ridimensionon ky ligj, pa i deklaruar, raportet e dy vendeve që e kanë bërë një luftë dhe po duan të kalojnë në raport paqeje?

Kjo u shtrua si pikëpyetje, por nuk u artikulua kështu, por me elemente po. Dhe, e dyta, në anën tjetër, a po mundohet në të njëjtën kohë ta krijojë një paqëtim të Kosovës nëpërmjet një regjistri të pakontrolluar të amnistimeve të krimeve? Edhe kjo mbetet në pikëpyetje. Pra, nuk është puna e diferencimit që po thuhet këtu 'nuk dua të diferencoj nacione etni e krahina'. Vetvetiu, gama që po nxjerr ligje dhe diskutimi i tij, po i nxjerr në fushë këto dy probleme. Unë mendoj që nëse duhet të përpunohet kaq shumë ky ligj, e deputetët po thonë që duhet, atëherë nuk është mirë ngutja e kalimit sot, nëse nuk është ndonjë farë, diç që nuk e përballon askush, unë nuk di cila është ajo, nën një.

Nën dy, kini kujdes deputetë, e ka sjellë Qeveria, veç mos harroni që problemi i amnistisë i është brendashkruar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ligjin, çfarë ta bëjmë, ne ose ju, njësoj është - të gjithë, ai është ligj që bëhet për amnisti, të cilin e bën Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nuk e bën as Kryeministri, as ministri i Drejtësisë, as Kryetarja e Shtetit. Kthjellojeni në mendje që kjo është kjo, dhe çfarëdo që të bëni, ju e bëni.

Unë për vete nuk mund të jap votë për një ligj, i cili e amnistion an block krimin, edhe krimin individual, edhe krimin e organizuar. Le të jetë ai me ngjyrën e kujt do qoftë. Nuk mundem. Të tjerët le t'i këqyrin punët e veta. Unë nuk mund dhe kur po e them këtë, e kam parasysh edhe mandatin, edhe zgjedhësit, ata që më kanë votuar dhe të cilëve u jam drejtuar në të gjitha legjislaturat e Republikës së parë dhe Republikës së dytë të Kosovës dhe m'i kanë dhënë ato vota. Unë i respektoj shumë. Kur kam konkurruar, unë kam mbajtur edhe fjalime me zgjedhës, por edhe i kam pasur parasysh këto dy përkufizime detyrash që i lexova në fillim, dhe unë, nëse nuk jam i zoti ta përçoj, nuk po flas këtu si individ, por si përfaqësues, interesin e zgjedhësve të mi dhe të qytetarëve të Kosovës, dhe të shtetit të Kosovës, që dikush ka qejf t'i thotë shtet, e dikush republikë, të cilin e kanë proklamuar prej fillimeve tash e 25 vjet të pavarur demokratik, atëherë unë jam i gatshëm t'u jap llogari zgjedhësve të mi, qoftë sot, qoftë herët tjera, duke mos u kërkuar mandat.

Sepse, kini kujdes, është problem i madh kjo puna e dyfishimit kush po amnistohet. Nuk është problem nëse janë dy rrafshet, a po kërkon të amnistohen ata me të cilët ka luftuar liberatori Adem Jashari, apo po amnistohet liberatori Adem Jashari? A po amnistohen ata që kanë bërë tentim ta vrasin disa herë Ibrahim Rugovën, apo demokrati Ibrahim Rugova? Unë nuk po përmend emra tajerë. Pikëpyetja është shumë e madhe. Është e paqartë.

Unë kërkoj sqarim, kërkoj kthjellim. Unë kërkoj që mos ngutje, në mënyrë që të bëhet votimi, por të bëhet arsyeshëm. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Radhën e ka Qeveria, në qoftë se e dëshiron fjalën dikush në emrin e saj. Zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, Kuçi, e keni fjalën.

**ZËVENDËSKREMINISTRI HAJREDIN KUÇI:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit, Kryeministër, të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë, Më lejoni të theksoj që debati i sotëm a ka pasur një ndikim jashtëzakonisht sqarues, edhe për mua, besoj edhe për ju, dhe për opinionin publik. Unë i falënderoj të gjithë që kanë marrë pjesë në debat, dhe në veçanti do të thosha për mënyrën e debatimit që sot i ka përngjarë mënyrës më të mirë parlamentare, pa marrë parasysh që mund të kemi pasur debate dhe mendime të ndryshme për të njëjtat çështje.

Në veçanti më lejoni t'i falënderoj ata të cilët u angazhuan që t'i japin sqarim përmbajtjes së këtij projektligji, ngase shpeshherë kemi qenë të motivuar dhe të ndikuar, jo nga përmbajtja e projektligjit, sa nga titujt e ndonjë gazete, që ka mundur të jetë eventuale.

Asnjëherë, as sot, as në përmbajtjen e ligjit nuk është thënë dhe nuk është menduar për vepra që njerëzit mund t'i supozojnë këto, por është menduar dhe duhet ta pranojmë një fakt për dy kategori, po i quaj. Kategoria e parë që e ka me nenin 5 dhe unë e vërejtja një unitet të theksuar, ka të bëjë me veriun e Kosovës. Ka të bëjë me kundërshtimin e rendit kushtetues dhe rezistencës që është bërë në atë pjesë dhe për veprat që kanë derivuar nga këto qëllime. Dhe, unë e vërejtja një unitet më të lartë nga të gjitha grupet parlamentare,

me ndonjë përjashtim nga “Vetëvendosja”, edhe pse nga kjo lëvizje pati një pajtueshmëri aty-këtu.

Në anën tjetër, e vërejta po ashtu një jounitet ose një kundërshtim për nenin 3 dhe përmbajtjen e këtij neni, dhe unë besoj ky perceptim që është dhënë nga Kuvendi i Kosovës dhe besoj fjalimi im edhe në fillim, ishte se neni 3 është i diskutueshëm, është i debatueshëm, mund të shkojë dhe do të shkojë në Komisionin për Legjislacion. Komisioni mund ta amendamentojë, mund t’i heqë disa vepra, mund t’i fusë disa vepra, mund ta heqë krejt.

Unë dhe Qeveria në këtë pikëpamje jemi shumë neutralë, domethënë nuk e kemi asnjë problem që ju të vendosni ndryshe. Në nenin 5, me përjashtim të asaj që është negociuar në Bruksel, edhe ajo është çështje për debatim, por asnjëherë, po e them prapë, për debate të tilla nuk u menduar që krimet e rënda e format tjera, edhe ajo që u përmend në nenin 3, nuk është thënë të amnistohen të gjithë, por pjesëshëm, 20%. Do të thotë, të mos mendohet pas këtij votimi kështu. Po ashtu, sipas sqarimit që e dha nënkryetari i Kuvendit, ky ligj do t’i ketë dy lexime. Unë do të jem i gatshëm të marr pjesë në Komisionin për Legjislacion, do të jem të gatshëm, e përmendi profesor Hamiti, është e vërtetë që votimi me 2/3, por edhe votimi i dytë është me 2/3. Kjo nënkupton se nëse nuk ka konsensus, ligji nuk hyn në fuqi. Nuk mund të jetë ligji në fuqi pa e kaluar edhe leximin e dytë dhe pa u ndryshuar ai ligj. Unë ju premtoj publikisht që neni 3 do të jetë i debatueshëm, do të jetë i negociueshëm, do të jetë i ndryshueshëm dhe unë mendoj që këtu duhet të marrë pjesë dhe përgjegjësi secili.

Sa u përket çështjeve tjera, si ministër i Drejtësisë, por edhe si njeri që ka marrë pjesë në dialogun në raport me Serbinë, vitin e fundit duhet ta them një përparim, në kuptimin politik për gjithë ne. Përparimi është që ne jemi pajtuar duket që ta bëjmë një lëshim për hir të integritetit të minoritetit serb, për hir të integritetit të asaj pjese të territorit tonë, dhe po duket që jemi pajtuar që obligimet që kemi marrë nga marrëveshja, shumica dërmuese është e gatshme t’i realizojë dhe unë besoj që kjo është për përgëzim. Sa i përket nenit 3, është çështje e brendshme, çështje jona që mund ta debatojmë.

Edhe një herë, ju falënderoj për debatin, për sugjerimet, për vërejtjet dhe po e them vetëm me një porosi: Ky është vendi ku njerëzit mund ta bëjnë debatin, mund ta japin përparësinë e tyre për mendim dhe po ashtu ftoj që debati, përparësia e mendimit duhet të jetë gjithmonë edhe me ndikime politike, por natyrisht edhe humane dhe të tjera. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Konstatoj që diskutimi është shteruar.

Të nderuara zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Ju lus që të votojmë për praninë. Sipas njoftimit, sipas numërimit fizik, në sallë janë 100 deputetë.

Votojmë për praninë tani! Disa nuk kanë votuar, megjithatë ne e hedhim në votim. Sipas votimit elektronikë, në sallë janë 91 deputetë. Këta që kanë votuar për prani janë 91

deputetë, ndërsa në sallë janë 100 deputetë. Sipas Rregullores, projektligji duhet t'i marrë 80 vota për t'u miratuar. Në qoftë se nuk i merr, nuk miratohet.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Sipas votimit, për janë 70 vota, 21 kundër dhe 2 abstenime, prandaj projektligji nuk miratohet.

*(Duartrokitje)*

E kemi edhe një pikë të rendit të ditës:

#### **6. Rekomandimi i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për procedimin e Projektligjit për transplantimin e organeve**

Ministri i Shëndetësisë, zoti Ferid Agani, në bazë të nenit 56, pika 5 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar tërheqjen e Projektligjit për transplantimin e organeve nga procedura parlamentare.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të kërkesës së sponsoruesit, në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2013, e ka ndërprerë punën për shqyrtimin e Projektligjit për transplantimin e organeve.

Kërkoj nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të miratohet kërkesa e sponsoruesit për tërheqjen nga procedura parlamentare e Projektligjit për transplantimin e organeve.

Votojmë me një votim formal. Kush është për? Kundër, a ka? Nuk ka kundër. Me shumicë votash miratohet tërheqja e ligjit. Faleminderit!

Konstatoj që seanca përfundoi. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*